

MANUAL I AKTEVE PROCEDURALE PËR GJYKIMET ADMINISTRATIVE



TIRANË, GUSHT 2016



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Bashkautore: Elda Vrioni, Marsida Xhaferllari

Përgatiti për botim: Iris Petrela
Departamenti i Ligjit dhe i të Drejtave të Njeriut
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Të gjitha mendimet e shprehura në këtë botim janë të autoreve dhe jo domosdoshmërisht shprehin pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

ISBN: 978-92-9235-273-8

MANUAL I AKTEVE PROCEDURALE PËR GJYKIMET ADMINISTRATIVE

PËRMBAJTJA:

LISTA E SHKURTIMEVE	7		
HYRJE	8		
I. AKTET PROCEDURALE NË TË DYJA SHKALLËT E GJYKIMIT	10		
1. Aktet e ndihmësit ligjor	11		
2. Aktet procedurale mbi juridiksionin	12		
3. Aktet procedurale mbi kompetencën	16		
3.1 Aktet e kompetencës lëndore	16		
3.2 Aktet e kompetencës funksionale	19		
3.3 Aktet e kompetencës tokësore	20		
3.4 Aktet mbi përbërjen e gjykatës	22		
II. AKTET PROCEDURALE NË GJYKIMIN NË SHKALLË TË PARË	24		
1. Padia si akt procedural në gjykimin administrativ	25		
1.1 Elementet e nevojshme të kërkesëpadisë sipas K.Pr.Civile	25		
1.2 Elementet e posaçme të kërkesëpadisë sipas LGJA	26		
1.3 Elementet e nevojshme të kërkesëpadisë jashtë përmbajtjes së saj si akt	27		
1.3.1 Aktet e nevojshme në shoqërim të padisë (provat)	27		
1.3.2 Tarifa e ngritjes së padisë	28		
1.4 Afati si kusht formal për depozitimin e kërkesëpadisë dhe llogaritja e tij	30		
2. Aktet procedurale shoqëruesë të kërkesëpadisë	31		
2.1 Deklarata për njoftim me telefon dhe adresë elektronike	31		
2.2 Kërkesa për akt ekspertimi	32		
2.3 Kërkesa për thirrje të dëshmitarëve	33		
3. Aktet procedurale në veprimet përgatitore dhe në seancën përgatitore	34		
3.1 Aktet e disponuara nga gjykata	34		
3.1.1 Aktet e njoftimit në gjykimin administrativ	36		
3.1.2 Vendimi i gjykatës për plotësimin e të metave të padisë	37		
3.1.3 Vendimi i gjykatës për kthimin e padisë dhe të akteve të saj shoqëruese	37		
3.1.4 Vendimi për caktim të ekspertit dhe detyrave të tij	38		
3.1.5 Deklarata për betimin e ekspertit, jashtë seancës gjyqësore	39		
3.1.6 Procesverbali i veprimeve përgatitore	39		
3.1.7 Urdhri i gjyqtarit për caktimin e seancës gjyqësore	40		
3.2 Aktet e palëve ndërgjyqëse	41		
3.2.1 Prapësimet e palës së paditur dhe të personit të tretë	42		
3.2.2 Aktet e Avokaturës së Shtetit	42		
3.2.3 Akti i ekspertimit	43		
3.2.4 Provat e paraqitura nga i padituri dhe personi i tretë	45		
4. Kërkesat procedurale të palëve gjatë seancës gjyqësore	45		
4.1 Kërkesa për ndryshim të objektit të padisë	48		
4.2 Kërkesa për rregullim të ndërgjyqësisë	50		
4.3 Kërkesa për shtyrje të gjyimit	52		
4.4 Kërkesa për përfaqësim me avokat apo për zëvendësimin e tij	54		
4.5 Kërkesa për mospranim të padisë	55		
4.6 Kërkesa për pezullim të gjyimit	56		
4.7 Kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi apo nga e drejta e padisë	57		
4.8 Kërkesa për sigurim të padisë	59		
5. Aktet e gjykatës në seancë gjyqësore	62		
5.1 Procesverbali gjyqësor	62		
5.2 Vendimi përfundimtar	64		
III. AKTET PROCEDURALE NË GJYKIMIN NË APEL	72		
1. Aktet e ankimit	73		
1.1 Ankimi i zakonshëm	73		
1.2 Koncepti i ankimit	73		
1.3 Efektet e ankimit	74		
1.4 Afatet e paraqitjes së ankimit	76		
1.5 Subjektet që ushtrojnë ankimin	77		
2. Forma e kërkesës ankimore dhe elementët e saj	77		
3. Vendi i paraqitjes së ankimit	79		
3.1 Kundërankimi në Gjykatën e Apelit	80		
3.2 Ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit	81		
4. Aktet e gjyimit në Gjykatën Administrative të Apelit	83		
4.1 Urdhri për caktimin e seancës	83		
4.2 Parashtrimet me shkrim të palëve	84		
4.3 Relacioni i kryesuesit të trupit gjykues (neni 49 pika 2)	85		
4.4 Procesverbali i dhomës së këshillimit	86		
4.5 Vendimi në dhomë këshillimi	87		
4.6 Aktet për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore	88		
5. Kërkesëpatria kundër aktit normativ	88		
IV. KËSHILLA PRAKTIKE MBI HARTIMIN E AKTEVE PROCEDURALE	94		
SHTOJCË - MODELE TË AKTEVE PROCEDURALE	98		

LISTA E SHKURTIMEVE

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AMTP	Akti i marrjes së tokës në pronësi
DAT	Drejtoria e Apelimit Tatimor
DRSSH	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore
DRTTM	Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj
ENCJ	Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
IMT	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit
ISHMP	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KM	Këshilli i Ministrave
K.Civil	Kodi Civil
K.Penal	Kodi Penal
K.Pr.Administrative	Kodi i Procedurave Administrative
K.Pr.Civile	Kodi i Procedurës Civile
K.Pr.Penale	Kodi i Procedurës Penale
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
LGJA	Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar
MD	Ministria e Drejtësisë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
ZQRPP	Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

HYRJJE

Ky Manual përmban disa njohuri bazë mbi aktet procedurale të gjyimit administrativ për t'i shërbyer praktikantëve të së drejtës në punën e tyre të përditshme. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në të drejtën administrative, sidomos në Ligjin nr. 49/2012 ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (këtu e në vijim i referuar si LGJA).

Gjykatat administrative u prezantuan për herë të parë me ligj në vitin 2012. Reforma ligjore synoi të reformonte procedurat gjyqësore të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve administrative në drejtim të shpejtësisë dhe cilësisë përmes ngritjes së një sistemi gjyqësor autonom të specializuar me gjyqtarë administrativë. Në zbatim të LGJA dhe në mbështetje të Dekretit nr. 8349, datë 14.10.2013, të Presidentit të Republikës “Për fillimin e funksionimit të gjykata administrative”, më datë 4 nëntor 2013 filloi funksionimi i gjykatave administrative. Si rrjedhojë, praktika gjyqësore e tyre është ende në fillimet e veta, që dëshmon, ndër të tjera, nevojën për të harmonizuar aktet procedurale në funksion të sigurimit të një jurisprudence të qëndrueshme prej saj.

Aktet procedurale të trajtuara në këtë Manual i referohen aktit, si koncept i sjelljes njerëzore të vullnetshme dhe të materializuar në një formë të përcaktuar nga ligji, në funksion të ecurisë së procesit gjyqësor administrativ. Në shërbim të këtij funksioni dhe për të lehtësuar përdorimin e këtij Manuali, aktet procedurale janë trajtuar në rrjedhë kronologjike sipas gjyimit administrativ, për të filluar me aktet që përpilohen në të dyja shkallët e gjyimit, me aktet e gjyimit në shkallë të parë dhe për të përfunduar me aktet e gjyimit në shkallë të dytë. Në vend të mbylljes, jepen disa këshilla praktike për shkrimin ligjor, të nevojshme për hartimin e akteve procedurale. Për të lehtësuar punën në praktikë, në Aneksin e Manualit gjenden mbi 20 modele aktesh procedurale, që përgatiten nga palët apo nga gjykata.

Si konsideratë e përgjithshme për aktet procedurale duhet evidentuar se LGJA nuk lejon që akti të hartohet nga cilido subjekt dhe se akti duhet të hartohet në një model të caktuar, në drejtim të formës, kohës dhe të vendit. Përmbushja e aktit procedural nga subjekti kompetent përbën atë që doktrina e quan legjitimitet të aktit dhe si të tilla ato kategorizohen në:

1. Akte të gjykatës (akte të gjyqtarit, të trupit gjykues, të ndihmësit ligjor dhe të sekretarisë gjyqësore) dhe
2. Akte të palëve ndërgjyqëse.

Palët ndërgjyqëse dhe gjykata, në përmbushjen e akteve procedurale të gjyimit administrativ, pa asnjë dyshim duhet të frymëzohen prej parimeve të gjyimit administrativ të sanksionuara në nenin 3 të LGJA. Parimet që lidhen drejtpërdrejt me aktet procedurale janë parimi i procesit të rregullt gjyqësor dhe sidomos aspekti i tij për zhvillimin e gjyimit të shpejtë dhe brenda afateve të arsyeshme, si dhe parimi i gjyimit verbal dhe i gjyimit mbi dokumente.

Konkretisht, parimi i procesit të rregullt gjyqësor, i njohur si e drejtë themelore e individit nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së lidhet me aktet procedurale në disa aspekte, siç janë barazia e armëve, kontradiktoriteti gjer tek aspekti i arsytimit të vendimit gjyqësor. Ky parim kërkon që të gjitha gjykatat në çdo nivel të kujdesen për respektimin e tij në procedurat që ato zhvillojnë, deri tek Gjykata e Lartë. Po ashtu, ai kërkon që një gjykatë më e lartë të riparojë të metat e gjykatës më të ulët, por nga ana tjetër, gjyqtari i një shkalle më të ulët që procedon në gjykim nuk mund të veprojë me mentalitetin që gjykata e shkallës më të lartë ka mundësinë për të korrigjuar gabimet e tij. Procesi i rregullt ligjor shoqërohet në procesin gjyqësor administrativ me një prej aspekteve të tij të rëndësishme “zhvillimin e gjyimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme”. Ky aspekt i veçantë i procesit të rregullt vendos dy detyra në përmbushjen e akteve procedurale: nga njëra anë afati duhet përdorur efektivisht, duke mos pritur ditën e fundit të tij, por sa më shpejt të jetë e mundur. Nga ana tjetër, përdorimi i afateve duhet të jetë i arsyeshëm në raport me natyrën e veprimit që kërkohet të kryhet për të mos dëmtuar cilësinë e drejtësisë dhe sidomos të drejtën e palëve për t'u mbrojtur efektivisht. Pozicioni i palëve në gjykim ndaj afateve të shpejta mbrohet pikërisht nga aspektet e tjera të procesit të rregullt ligjor.

Gjykimi verbal dhe shkresor është një parim tjetër i vendosur në nenin 3 të LGJA, sipas të cilit, shqyrtimi gjyqësor zhvillohet ose gojarisht në seancë gjyqësore me praninë e palëve, ose mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi. Dhoma e këshillimit është një procedurë e veçantë gjykimi administrativ, e thjeshtuar dhe që synon mbi të gjitha, ekonominë gjyqësore. Në këtë rast, gjykimi zhvillohet pa praninë dhe shpjegimet verbale të palëve. Çdo palë pretendimet apo prapësimet e veta, së bashku me provat përkatëse, i paraqet me shkrim pranë gjykatës, duke u njohur në përfundim mbi vendimin e marrë. Zbatimi i parimit të gjyimit mbi bazë dokumentesh lidhet edhe me rregullin tjetër të veçantë në procedurën e gjyimit administrativ, sipas të cilit mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjyimit.

Manuali nuk është shterues në njohuritë që prezanton dhe as detyrues në përdorimin e tij. Ai synon të jetë një instrument fillestar në duart e praktikantëve, me qëllim rritjen e informacionit në të drejtën procedurale administrative. Nëse ky Manual do t'i shërbejë sadopak saktësisë dhe uniformitetit të mëtejshëm të akteve procedurale, atëherë, kjo është një vlerë e shtuar e tij.

1

AKTET PROCEDURALE NË TË DYJA SHKALLËT E GJYKIMIT

Disa prej akteve procedurale janë të tilla që përshkojnë të gjithë procesin gjyqësor dhe aplikohen në të dyja shkallët e gjyqimit. Është fjala për aktet e ndihmësit ligjor, si dhe për aktet mbi juridiksionin, kompetencën dhe përbërjen e trupit gjykues.

1. Aktet e ndihmësit ligjor

LGJA ka pranuar në mënyrë të shprehur figurën e ndihmësit ligjor të gjyqtarit, duke përcaktuar edhe marrëdhënien midis tyre (neni 6). Numri i ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë përcaktohet nga Ministri i Drejtësisë, por në çdo rast numri i tyre nuk mund të jetë më i vogël se gjysma e numrit të gjyqtarëve të asaj gjykate. Në kohën e hartimit të këtij Manuali¹, në 7 gjykatat administrative janë emëruar 28 ndihmësa ligjorë gjithsej (1 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, 1 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, 1 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, 2 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, 2 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, 8 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe 13 në Gjykatën Administrative të Apelit (Tiranë).

Me ndryshimet e LGJA, të miratuara nga Kuvendi më 31.07.2014, janë shtuar 5 nene për statusin e ndihmësit në drejtim të emërimit të tyre në detyrë, të regjimit disiplinor të tyre dhe të pagës. Ndhmësi ligjor është konsideruar si pjesë e shërbimit administrativ civil në gjykatë. Ndhmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin përkatës lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim. Ai përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykim, madje edhe projekt-vendimin përfundimtar, duke u kujdesur për respektimin e elementëve formale të akteve procedurale. Në këtë drejtim, standardet dhe modelet e këtyre akteve që përgatiten nga ndihmësi janë të njëjta me aktet e gjyqtarit apo të trupit gjykues. Është e vërtetë që ligji nuk cakton afate për përmbushjen e projekt-akteve procedurale nga ndihmësi ligjor, megjithatë nuk duhet harruar që këto projekt-akte kanë funksion ndihmës të akteve të gjyqtarit. Kjo nënkupton që, në përgatitjen e këtyre projekt-akteve, ndihmësi duhet të udhëhiqet nga afatet e akteve procedurale, duke llogaritur kohën që i duhet gjyqtarit për të analizuar dhe sipas rastit, konfirmuar apo ndryshuar projekt-aktin e përgatitur nga ndihmësi. Për këtë qëllim, është e nevojshme që vetë gjyqtari të orientojë dhe kur është rasti, edhe të urdhërojë caktimin e një afati për përpilimin e projekt-aktit procedural nga ndihmësi. Sa i takon vlerës ligjore të projekt-aktit, duhet thënë se cilësia e tij nuk prek drejtpërdrejt cilësinë e aktit procedural, për shkak të natyrës ndihmëse që ai ka. Në këtë pikëpamje, të metat e projekt-aktit procedural të përgatitur nga ndihmësi ligjor mund dhe duhet të ndreqen nga gjyqtari. Rrjedhimisht, të metat e projekt-aktit procedural lidhen me cilësinë e performancës së ndihmësit ligjor dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë në vlerësimin e punës së tij, gjer në përgjegjësinë e tij disiplinore nëse këto të meta kryhen me neglizhencë të rëndë apo me dashje prej tij.

Nga ana tjetër, me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit **opinionet me shkrim** për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material, që lidhen me gjykimin. Këto kërkime janë një ndihmë e shtuar për gjyqtarin, veçanërisht në drejtim të zhvillimeve të reja të

¹ Ky Manual u përfundua në korrik 2016.

doktrinës dhe të jurisprudencës. Nga analiza e këtyre funksioneve, vërehet se ndihmësit ligjorë kanë të drejtë të kryejnë paraprakisht dhe në ndihmë të gjyqtarit të gjitha veprimet intelektuale dhe fizike që duhet të kryejë gjyqtari, sipas udhëzimeve dhe kërkesave të këtij të fundit.

Ligji nuk vendos kritere formale për hartimin e opinionit të ndihmësit ligjor dhe për rrjedhojë, ndihmësi duhet të kujdeset që opinionin e tij të ketë një strukturë të qartë në varësi të temës, mbi të cilën është zhvilluar kërkimi. Sigurisht, që në këto raste bëhet fjalë për kërkime me natyrë ligjore, por identifikimi i saktë i fakteve të mosmarrëveshjes lehtëson kërkimin.

Një model i mirë opinionit kërkon që ai të përfshijë:

1. temën, mbi të cilën është zhvilluar kërkimi;
2. burimet e konsultuara për kërkimin e kryer;
3. analizën ligjore mbi të dhënat e nxjerra nga kërkimi;
4. rekomandime apo përfundime mbi temën.

Struktura e opinionit është e lidhur ngushtë me temën e kërkimit, e cila mund t'i referohet një koncepti doktrinar apo zhvillimit të jurisprudencës mbi një koncept të caktuar. Në rastin e *konceptit doktrinar*, është e këshillueshme që opinionin të përmbajë si burime konsultuese zhvillime të doktrinës së brendshme shqiptare, por edhe zhvillime të doktrinës bashkëkohore që lidhen me konceptin konkret, duke cituar me saktësi tekstet e konsultuara. Në rastin e *zhvillimit të jurisprudencës* është e këshillueshme që për temën e caktuar të jepen të dhëna nëse çështja në fjalë ka një jurisprudencë të qëndrueshme apo jo. Është shumë e rëndësishme që vendimet gjyqësore të konsultuara të jenë përfundimtare dhe të jenë të ngjashme nga pikëpamja e faktit. Në këtë rast, është e mjaftueshme të citohen me referencë vendimet gjyqësore që japin konkluzionin e jurisprudencës konstante. Nëse çështja në fjalë nuk ka një jurisprudencë konstante duhet të përshkruhen në opinion ndryshimet midis vendimeve gjyqësore të konsultuara, si dhe ecuria kronologjike e tyre. Në përfundim të opinionit, ndihmësi mund të japë edhe rekomandimet e tij për temën që kërkohet. Nuk përjashtohet mundësia e dhënies së rekomandimeve alternative, duke shpjeguar avantazhet e secilës alternative. Një model orientues për hartimin e opinionit ligjor jepet në Aneksin e këtij Manuali.

2. Aktet procedurale mbi juridiksionin

Juridiksioni gjyqësor është pushteti që i jepet gjykatës për të marrë në shqyrtim një mosmarrëveshje, për të verifikuar faktet e saj në ballafaqim me ligjin dhe për të dhënë me vendim zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Juridiksioni gjyqësor është një çështje e pastër ligjore, madje e ngritur në standard kushtetues. Gjykata Kushtetuese tashmë ka një jurisprudencë të qëndrueshme, që e trajton juridiksionin si komponent kyç të procesit të rregullt ligjor – aksesit në gjykatë (qasjes në gjykatë) dhe të drejtës për t'u dëgjuar çështja nga një gjykatë e krijuar me ligj. E drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë sanksionohet si një prej të drejtave themelore në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNj-së.

Çështja e juridiksionit gjyqësor hap diskutime të gjera pikërisht në procesin gjyqësor administrativ, ku detyrë e gjykatës, me kërkesë të palëve ose me nismë të saj është gjetja e kufirit midis juridiksionit gjyqësor dhe juridiksionit administrativ, duke respektuar funksionin kushtetues dhe themelor të gjykatës për të dhënë drejtësi (neni 135 i Kushtetutës). Nuk është aspak e rastit që neni 1 i K.Pr.Civile parashikon si parim themelor të gjyqimit mbi mosmarrëveshjet civile dhe administrative "Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsytim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë". Nga ana tjetër, sipas ligjeve procedurale gjyqësore, juridiksioni paraqitet si një prej çështjeve më të rëndësishme me natyrë të pastër ligjore, që duhet të vlerësohet nga gjykata:

- » së pari, me nismën e vetë gjykatës në çdo fazë dhe shkallë të gjyqimit;
- » së dyti, ankimi mbi vendimet gjyqësore që shqyrtojnë juridiksionin shqyrtohet drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë dhe ky kapërcim procedural thekson jo vetëm rëndësinë e këtij instituti, por njëherazi edhe natyrën e pastër ligjore të tij;
- » së treti, pasaktësia në vlerësimin e juridiksionit prek në thelb rezultatin e çështjes me vendim për rigjykimin e çështjes apo për pushimin e gjyqimit të saj.

Në drejtim të juridiksionit, LGJA në nenin 9 konfigurron tre akte procedurale që përmbushen në gjykimin në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë:

1. kërkesa e palëve për kundërshtimin e juridiksionit gjyqësor;
2. vendimi gjyqësor për mospranimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe
3. vendimi gjyqësor për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

Kërkesa për kundërshtimin e juridiksionit gjyqësor është një akt procedural i palëve ndërgjyqëse, i cili si rregull paraqitet nga një palë e ndryshme nga ajo paditëse. Kjo kërkesë mund të paraqitet në çdo fazë të gjyqimit, që përfshin edhe atë të veprimeve përgatitore, si dhe në çdo shkallë të gjyqimit, që përfshin edhe gjykimin në Gjykatën e Lartë. Kjo nënkupton se paraqitja e kësaj kërkesë nuk ka afat dhe në çdo kohë të paraqitjes së saj, gjykata që shqyrton çështjen është e detyruar ta shqyrtojë dhe të vendosë mbi të. Një kërkesë e tillë paraqitet pranë gjykatës, ku ndodhet çështja për gjykim. LGJA nuk vendos asnjë kriter për formën e një kërkesë të tillë dhe rrjedhimisht, kjo kërkesë mund të paraqitet verbalisht në seancë gjyqësore, duke u dokumentuar në procesverbalin gjyqësor ose me shkrim. Një kërkesë e tillë, duhet të referojë në nenin 9 të LGJA-së në pikëpamje të vënies në lëvizje të gjykatës, por edhe ligjin specifik që tregon se çështja është me natyrë administrative, zgjidhja e së cilës nuk i takon pushtetit gjyqësor. Praktika gjyqësore e deritanishme tregon si shembull mbizotërues të kundërshtimit të juridiksionit gjyqësor rastin kur paditësi nuk ka shteruar ankimin në rrugë administrative, që në fakt është kusht formal i pranimit të padisë. Megjithatë, nuk kanë munguar as rastet e kërkesave për shqyrtimin e akteve politike, të akteve të sigurisë kombëtare apo të akteve të ruajtjes së rendit publik, pra, veprimtari që ndonëse ushtrohet nga organi publik, nuk është veprimtari administrative e tij.

Në diskutimin mbi kërkesat për juridiksionin, është e rëndësishme të saktësohet një dallim midis gjykit civil dhe atij administrativ, ku tek ky i fundit gjykata administrative ka juridiksion të shqyrtojë padinë për pavlefshmëri absolute të aktit administrativ. Gjykata e Lartë për këtë lloj konflikti ka arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se:

“

“Një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm për shkak të shkeljes thelbësore të ligjeve nuk e ka fuqinë juridike të një akti administrativ të vlefshëm dhe objektivist nuk konsiderohet që të ketë ekzistuar për asnjë çast. Pavlefshmëria absolute e aktit është një gjendje e tillë, ku ka mungesë të plotë veprimi juridik nga akti. Akti, qysh në momentin e nxjerrjes së tij, nuk krijon dhe as nuk mund të krijojë pasojat juridike për të cilat është nxjerrë. Një akt i tillë nuk ka fuqi detyruese ndaj personave, apo subjekteve, të cilëve iu drejtohet dhe si rrjedhojë këta ose çdo organ tjetër mund të refuzojnë drejtpërdrejt plotësimin e detyrimeve, apo urdhërimeve që rrjedhin nga akti, pa qenë nevoja që për pavlefshmërinë e tij të shprehet patjetër ndonjë organ shtetëror. Duke qenë i tillë në asnjë rast kur kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ nuk mund të kërkohet respektim dhe ndjekje e rrugës administrative përpara se ky lloj kërkimi t’i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor. Gjykata, me kërkesë të palës së interesuar, ose edhe kryesisht gjatë gjykit, ka tagrin t’ia nënshtrojë këto akte hetimit gjyqësor dhe në rast se konstaton që këto akte janë absolutisht të pavlefshme, i shfuqizon ato dhe rregullon pasojat që kanë ardhur prej zbatimit të tyre. Gjykata vetëm konstaton pavlefshmërinë e aktit, pasi në kuptimin ligjor akti nuk mund të ketë ekzistuar asnjëherë juridikisht, prandaj nuk justifikohet shpallja e pavlefshmërisë. Kjo është dhe arsyeja se përse paditësi me një kërkim të tillë mund t’i drejtohet direkt juridiksionit gjyqësor”.

”

Vendimi gjyqësor mbi juridiksionin është akt procedural i gjykatës, i cili mund të paraprihet nga projekt-akti i hartuar nga ndihmësi ligjor. Ky lloj akti mund ta marrë shtysën e tij nga kërkesa e palëve ndërgjyqëse, por mund të nxirret edhe me nismë të gjykatës. Edhe për këtë lloj akti procedural, LGJA në nenin 9 nuk vendos kufizim në kohë, pra, ai mund të nxirret në çdo fazë të gjykit dhe në çdo shkallë të tij, nga gjykata që po shqyrton çështjen. Në rastin, kur gjykata disponon nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, me këtë lloj vendimi i jepet fund procesit gjyqësor dhe njëherazi urdhërohet dërgimi i akteve organit shtetëror kompetent. Ndërsa kur gjykata refuzon kërkesën e palëve ndërgjyqëse për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, ky lloj akti procedural përfshihet në kategorinë e vendimeve të ndërmjetme. Është e rëndësishme që konkluzioni i gjykatës mbi juridiksionin të jetë i bazuar në prova nëse lidhet me çështje fakti, që nënkupton edhe kryerjen e një hetimi gjyqësor për këtë qëllim – një rast i tillë është fakti se paditësi nuk ka ezauruar ankimin në rrugë administrative.

2 Ky qëndrim është praktikë konstante e Gjykatës së Lartë dhe për ilustrim shih vendimin nr. 00-2014-541(152), datë 23.01.2014 të Kolegjit Administrativ.

Në çdo rast, vendimi gjyqësor për juridiksionin duhet të jetë i arsyetuar. Për elementet minimale që duhet të përmbajë arsyetimi i vendimit gjyqësor, vlejshëm shpjegimet e dhëna tek vendimet gjyqësore. Vendimi për juridiksionin është i ankimeshëm drejtpërdrejt në Gjykatën e Lartë dhe paraqitja e ankimit pezullon gjykimin e filluar, me përjashtim të veprimeve të ngutshme. Duke iu referuar rasteve të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë, konstatohet se ka pasur raste, që gjykata ka refuzuar kërkesën për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe megjithëse vendimi është ankimuar ajo ka vazhduar gjykimin e çështjes. Kjo praktikë është vlerësuar e gabuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar, ndër të tjera se se, vendimi në lidhje me juridiksionin, që nga pikëpamja formale procedurale përbën një vendim të ndërmjetëm (kur gjykata vendos mospranimin e kërkesës së palës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor) dhe një vendim jo përfundimtar (kur gjykata vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor) duhet të jetë i arsyetuar me akt të veçantë (i zbardhur) në përputhje me kërkesat e nenit 310 të K.Pr.Civile³.

Nevoja për arsyetimin e plotë të vendimit mbi kërkesën e palëve për juridiksionin është theksuar edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë⁴, i cili është shprehur:

“

“Arsyetimi i vendimeve gjyqësore për juridiksion dhe i të gjithë vendimeve të tjera ndaj të cilave ushtrohet ankimi i veçantë, është një element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj. Në vështrim të neneve 6, 59 dhe 310 të K.Pr.Civile reflektuar edhe në ligjin nr.49/2012 (nenet 9, 64) është detyrë e gjykatës që të shprehet më vendim të arsyetuar në lidhje me disponimin e juridiksionit duke parashtruar faktet dhe rrethanat si dhe të parashtrrojë arsyet ligjore të nxjerrjes ose jo të çështjes jashtë juridiksionit. Në një vendim i tillë, gjykata ka detyrimin të parashtrrojë rrethanat e faktit që çmohen të vërtetuara në lidhje me disponimin për juridiksionin, si dhe arsyet ligjore të nxjerrjes ose jo të çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, kryesisht apo mbi kërkesën e palës.

Në këtë këndvështrim, vendimi gjyqësor që disponon mbi juridiksionin është një moment i rëndësishëm procedural për procesin në tërësi, për të garantuar të drejtat themelore të individit për t’iu drejtuar gjykatës dhe për t’u dëgjuar prej saj për themelin e kërkimit. Duke konsideruar rëndësinë e këtij momenti procedural në garantimin e të drejtave të individit për një proces të rregullt ligjor, është parashikuar ushtrimi i ankimit të veçantë në Gjykatën e Lartë, pa qenë e nevoja e ankimit në Gjykatën e Apelit”.

”

Nëse gjykata gabon në nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, situata ndreqet vetëm me ankimin e veçantë të palëve. Në këtë rast, Gjykata e Lartë urdhëron vazhdimin e gjykit nga e njëjta gjykatë në pikëpamje të shkallës dhe të përbërjes.

3 Shih vendimin nr.715 (59), datë 20.02.2014 i Kolegjit Civil por me vlerë në gjykimin administrativ, jo vetëm për shkak të analogjisë në procedurë, por edhe sepse pretendimet e të paditurit lidheshin me veprimtarinë e ZVRPP-së

4 Shih vendimin nr. 00-2014-848, datë 04.03.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Aktet procedurale mbi kompetencën

Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, sikundër edhe në vende të tjera, është i organizuar në struktura të ndryshme, duke ndjekur kriteret e fushës së mosmarrëveshjeve, nivelet e shqyrtimit të mosmarrëveshjes apo territorin. Ky organizim strukturor bën të domosdoshëm vendosjen e rregullave për individualizimin e gjyqtarit, brenda juridiksionit gjyqësor për të shpërndarë gjykimin e çështjeve në mënyrë korrekte. Këto rregulla nuk janë gjë tjetër veçse rregullat e kompetencës. Kompetenca mund të përkufizohet si mjeti që kufizon hapësirën e juridiksionit gjyqësor, e cila përcakton hapësirën brenda të cilës një gjyqtar është i detyruar të procedojë. Kompetencat sigurojnë mbi të gjitha shmangien e situatave që një çështje të merret në shqyrtim nga shumë gjyqtarë apo gjykata në mënyrë të njëkohshme. Motivet për ndarjen e kompetencave në kategori të ndryshme janë të ndryshme, si prezumimet për aftësi më të larta apo më të ulëta tekniko-profesionale të gjyqtarit, vlerësimet mbi oportunitetin e shpërndarjes së juridiksionit gjyqësor, madje edhe lehtësimi i procesit të marrjes së provave apo lehtësimi i pozitës/aksesit të individit që paraqitet në gjykatë.

Në këndvështrimin e diskutimit mbi kompetencën, aktet procedurale konfigurohen sipas llojeve të saj: (1) akte për kompetencën lëndore; (2) akte për kompetencën funksionale; (3) akte për kompetencën tokësore; dhe (4) akte për përbërjen e gjykatës.

3.1 Aktet e kompetencës lëndore

Krijimi i gjykatave administrative me përcaktimin në ligj të lëndës në shqyrtim të saj i dha rëndësi domethënëse çështjes së kompetencës lëndore të gjyqimit, për shkak të parimit të gjyqimit të çështjes nga gjykata e krijuar me ligj, element integral për një proces të rregullt ligjor. Ndërsa më parë gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative shqyrtohej nga seksioni administrativ pranë disa gjykatave civile, me kuadër ligjor procedural vetëm disa dispozita në K.Pr.Civile⁵, LGJA përcaktoi krijimin e gjykatave të posaçme dhe fushën e veprimtarisë së tyre sipas nenit 7 të tij.

Kompetenca lëndore (neni 7 i LGJA) përbën në thelb një kufizim të ushtrimit të pushtetit juridiksional, të vendosur ndaj gjyqtarit në shkallë të parë, duke marrë për bazë llojin e mosmarrëveshjes. Identifikimi i kompetencës lëndore ka të bëjë me detyrën e gjyqtarit administrativ për të verifikuar paraprakisht nëse mosmarrëveshja, që i është paraqitur për shqyrtim lidhet me listën e përcaktuar shprehimisht në nenin 7 dhe të përcaktuar negativisht, përmes ndalimit, në nenin 8. Konkretisht bëhet fjalë për mosmarrëveshjet administrative që lindin nga veprimtaria administrative e organit publik, e formalizuar ose jo në një akt administrativ, por pa munguar edhe rasti i mosmarrëveshjes së kompetencave midis vetë organeve publike. Gjithashtu, përfshihen në kompetencën lëndore të gjykatave administrative edhe rastet e mosmarrëveshjeve në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike, si dhe mosmarrëveshjet që lidhen me kundravajtjet administrative me heqje lirie deri në 30 ditë.

5 Shih nenet 324 deri 333 të K.Pr.Civile

Krahas këtij kuadri ligjor, duhet mbajtur në konsideratë edhe zhvillimi i jurisprudencës përmes vendimeve unifikuese, që lidhen me çështjet e kompetencës lëndore. Konkretisht, Kolegjet e Bashkuara kanë dhënë disa vendime: p.sh. vendimi nr. 3, datë 06.12.2013⁶, vendimi nr. 4, datë 10.12.2013⁷, apo vendimi nr. 3, datë 28.04.2014⁸.

Në këtë kontekst ligjor, aktet procedurale që lidhen me kompetencën lëndore marrin spunto nga rastet e defektit në kompetencë. Këto lloj rastesh përcaktohen nga neni 13 i LGJA. Është e rëndësishme të theksohet se kur një gjykatë procedon pa pasur kompetencë lëndore, procesi quhet i pavlefshëm dhe për këtë shkak, gjykata më e lartë e prish vendimin e dhënë dhe urdhëron rigjykimin e çështjes.

Mungesa e kompetencës ngrihet në dy mënyra. Vetë palët mund ta paraqesin një kërkesë të tillë dhe në këtë rast formohet akti procedural - **kërkesë për shpalljen e moskompetencës lëndore**. Ligji nuk vendos kritere për elementët formalë të kësaj kërkesë. Rrjedhimisht, kjo kërkesë mund të parashtrohet verbalisht, duke u dokumentuar në procesverbalin gjyqësor ose mund të depozitohet me shkrim. Në praktikë, kërkesat për deklarimin e mungesës së kompetencës lëndore përpara gjykatës administrative të shkallës së parë, paraqiten me shkrim dhe shqyrtohen nga gjykata edhe në mungesë të palëve. Në rastin e hartimit të kësaj kërkesë me shkrim është e rekomandueshme që kërkesa të përmbajë kohën e paraqitjes së kërkesës dhe atributet e çështjes gjyqësore ku paraqitet, faktin, i cili mbështet pretendimin për mungesën e kompetencës lëndore, duke treguar edhe provat që e mbështesin një fakt të tillë nëse është e nevojshme, ligjin e zbatueshëm dhe kërkimin e palës. Sigurisht, që kërkesa duhet të tregojë pa të meta edhe palën ndërgjyqëse, që e paraqet dhe të nënshkruhet rregullisht prej saj apo përfaqësuesit. Kundërshtimi i kompetencës lëndore mund të ngrihet nga palët në çdo fazë (veprime paraprake apo gjykim) dhe shkallë të gjyqimit. Si rregull, rastet më të zakonshme të këtyre kërkesave në praktikën gjyqësore lidhen me pretendimet e ngritura para gjykatës nga organi publik i paditur apo Avokatura e Shtetit, pasi paditësi ka vlerësuar që në fillim kompetencën në lëndë, për shkak se ai vetë ka depozituar padinë. Një model i kërkesës për kundërshtimin e kompetencës lëndore jepet në Aneksin e këtij Manuali.

6 Me këtë vendim unifikues Kolegjet e Bashkuara përcaktuan se gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me LGJA, janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjyqimit.

7 Me këtë vendim unifikues, Kolegjet e Bashkuara morën në shqyrtim situatën kur një padi, kishte disa kërkitime të bashkuara me natyrë të ndryshme, civile dhe administrative, duke konkluduar se *'Kur në objektin e gjyqimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile'*. Zgjidhja e dhënë me këtë vendim u rishikua me vendimin pasues unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 3/2014.

8 Në këtë rast, Kolegjet e Bashkuara orientojnë gjykatat që nëse në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative, gjykata që po shqyrton padinë nuk mund të shqyrtojë këtë kërkitim të të paditurit për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të gjykatës që po shqyrton padinë. Konkretisht, Kolegjet e Bashkuara, vendosën dy përfundime unifikuese: *"1. Çështjet në të cilat gjatë gjyqimit është paraqitur një kundërpadi, e cila ka natyrë të ndryshme nga ajo e padisë (respektivisht administrative ose civile), në rast se kundërpadia është paraqitur në gjykatë para datës 04.11.2013, do të vazhdojnë të gjykojnë në gjykatën kompetente për shqyrtimin e padisë, si në gjykimin në shkallë të parë, gjykatë të apelit, apo Gjykatë të Lartë; dhe 2. Çështjet të cilat në objektin e tyre kanë disa kërkitime si të natyrës civile dhe administrative, kërkitime të cilat janë paraqitur përpara datës 04.11.2013, do të vazhdojnë të gjykojnë nga gjykata ku ato janë paraqitur"*.

Në fillim të funksionimit të gjykatave administrative, praktika gjyqësore e vitit 2014 ka qenë shumë e pasur me rastet e shpalljes së mungesës së kompetencës lëndore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat dërguan një numër shumë të lartë çështjesh për gjykim pranë gjykatave administrative. Në këtë situatë, pati raste që palët ndërgjyqëse të procesit gjyqësor të filluar në gjykatën e juridiksionit të zakonshëm sipas rregullave të K.Pr.Civile, ushtruan ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë kundër vendimit gjyqësor për shpalljen e mungesës së kompetencës lëndore duke përdorur si bazë ligjore nenin 62 të K.Pr. Civile. Këto raste u morën në shqyrtim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili krijoi praktikën⁹ për pushimin e gjykimit të këtyre çështjeve në Gjykatën e Lartë, me arsyetimin e përmbledhur se *“ankimi i veçantë i paraqitur është ushtruar kundër një vendimi ndaj të cilit nuk mund të bëhet ankim i veçantë nga palët në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë investohet vetëm atëherë kur gjykatat kanë mosmarrëveshje për kompetencën. Nuk mund të paraqitet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë në lidhje me kompetencën për vendime që iu përkasin çështjeve me natyrë administrative, për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur moskompetencën dhe ka urdhëruar dërgimin e akteve në gjykatën administrative kompetente”*. Në këtë mënyrë, Kolegji Administrativ interpretoi nenin 13 pika 3 të LGJA, sikur ai i referohet natyrës së mosmarrëveshjes dhe jo gjykatës që ka dhënë vendimin e moskompetencës.

Mënyra e dytë për konstatimin e mungesës së kompetencës lëndore është vënia në lëvizje e gjykatës kryesisht për vlerësimin e saj. Në të dyja rastet, pra kur gjykata me kërkesë të palëve ose kryesisht konstaton mungesën e kompetencës, atëherë ajo jep vendim të ndërmjetëm për shpalljen e moskompetencës, duke treguar shkakun e moskompetencës dhe duke urdhëruar dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Ky akt procedural mund të paraprihet nga projekt-vendimi i hartuar nga ndihmësi ligjor. Edhe për këtë lloj akti procedural, LGJA në nenin 13 nuk vendos kufizim në kohë, pra, ai mund të nxirret në çdo fazë të gjykimit dhe në çdo shkallë të tij, nga gjykata që po shqyrton çështjen, duke përfshirë edhe fazën e shpalljes së vendimit përfundimtar. Në rastin, kur gjykata disponon mungesën e kompetencës, me këtë lloj vendimi i jepet fund procedurës së gjykimit administrativ, por fillon procesi gjyqësor me natyrë tjetër, si rregull, gjykimi civil. Për këtë shkak, gjykata disponon në dispozitivin e këtij vendimi dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Ndërsa kur gjykata refuzon kërkesën e palëve ndërgjyqëse për shpalljen e moskompetencës, ky lloj akti procedural përfshihet në kategorinë e vendimeve të ndërmjetme, brenda procesit gjyqësor që zhvillohet nga e njëjta gjykatë në një shkallë të caktuar.

Në çdo rast, vendimi gjyqësor për kompetencën lëndore duhet të jetë i arsyetuar. Për elementet minimale, që duhet të përmbajë arsyetimi i vendimit gjyqësor, vlejshëm shpjegimet e dhëna tek vendimet gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar dhe rregull në këtë rast synon të zbatojë parimin e gjykimit të shpejtë administrativ. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për vendimin që rrëzon kërkesën e palëve për kundërshtimin e kompetencës së gjykatës për çdo shkak.

⁹ Shih vendimet nr. 00-2014-557, datë 11.03.2014, nr. 00-2014-560, datë 04.03.2014, nr. 00-2014-683, datë 11.03.2014 të Kolegjit Administrativ.

Dy akte të tjera procedurale, që lidhen me kompetencën lëndore, janë ato që lindin në rastin e mosmarrëveshjes së kompetencave. Neni 13 i LGJA e përkufizon mosmarrëveshjen e kompetencave, si situatën ku dy ose më shumë gjykata, në të njëjtën kohë, marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën çështje administrative. Në këtë rast, gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, ngre çështjen e mosmarrëveshjes me vendim të arsyetuar, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj. Kjo nënkupton, që palët kanë të drejtë të paraqesin një kërkesë të tillë për ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës pranë gjykatës pritëse. Po ashtu, edhe gjykata pritëse e akteve nga një gjykatë që e ka shpallur moskompetencën, harton vendimin e ndërmjetëm për ngritjen e mosmarrëveshjes, që i drejtohet dhe vë në lëvizje Gjykatën e Lartë. Në dispozitivin e këtij vendimi, gjykata që ka ngritur mosmarrëveshjen urdhëron edhe njoftimin e menjëhershëm të gjykatës dërguese të akteve. Vendimi për ngritjen e mosmarrëveshjes, së bashku me aktet, i dërgohet Gjykatës së Lartë brenda 5 ditëve.

3.2 Aktet e kompetencës funksionale

Kompetenca funksionale përfshin të drejtën e gjykatës në linjë vertikale, të dhënë me ligj, për të shqyrtuar dhe dhënë vendim të vlefshëm mbi një çështje, që i paraqitet me kërkesë të subjekteve të parashikuara nga ligji. Me fjalë të tjera, kompetenca funksionale ndan kufijtë e shqyrtimit të një çështjeje midis gjykatës së nivelit të parë dhe asaj të nivelit të dytë administrativ.

Sipas pikës 1 të nenit 10 të LGJA, gjykata administrative e shkallës së parë ka në kompetencën e saj funksionale shqyrtimin e mosmarrëveshjeve mbi aktet administrative individuale dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik; mbi ndërhyrjen e paligjshme ose mosveprimin e organit publik, mbi konfliktin e kompetencave midis organeve administrative, mbi marrëdhëniet e punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike, mbi kundravajtjet administrative, të dënueshme heqje lirie deri në 30 ditë dhe mbi zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 20 ditë me dënim me gjobë. Mosmarrëveshjet që lindin nga aktet nënligjore normative janë të përjashtuara shprehimisht nga kompetenca funksionale e gjykatës administrative e shkallës së parë.

Gjykata Administrative e Apelit ka në kompetencë të saj funksionale dy grupe çështjesh me natyrë të ndryshme¹⁰. Grupi i parë përfshin ankimet ndaj vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe në këtë rast funksioni i saj është rishikues, pasi i gjykon këto çështje në shkallë të dytë. Grupi i dytë i çështjeve përfshin rastet e juridiksionit fillestar të Gjykatës Administrative e Apelit dhe në këtë grup përfshihen mosmarrëveshjet mbi aktet nënligjore normative dhe raste të tjera të parashikuara me ligj. Tek këto të fundit përfshihen edhe gjykimi në shkallë të parë i kërkesave të veçanta, të cilat ligji i lejon të paraqiten në çdo shkallë të gjykimit (kërkesat për sigurim padie apo kërkesat për kundërshtimin e juridiksionit gjyqësor).

¹⁰ Shih nenin 10, pika 2 të LGJA

Kompetenca funksionale paraqet të njëjtën rëndësi si ajo lëndore, në drejtim të vlefshmërisë së procesit. Rrjedhimisht, edhe aktet procedurale që konfigurohen në rastin e diskutimit të kompetencës funksionale, ndjekin të njëjtin regjim juridik, për kohën e hartimit të tyre dhe fuqinë juridike të tyre. Këto akte janë të njëjta me ato të kompetencës lëndore:

1. kërkesë e palëve për kundërshtimin e kompetencës funksionale;
2. vendim gjyqësor mbi kompetencën funksionale;
3. kërkesë e palëve për ngritjen e mosmarrëveshjes për kompetencë funksionale dhe
4. vendim gjyqësor për ngritjen e mosmarrëveshjes për kompetencë funksionale.

Rrjedhimisht, shpjegimet e dhëna për aktet e kompetencës lëndore janë të vlefshme edhe në këtë rast.

3.3 Aktet e kompetencës tokësore

Kompetenca tokësore bazohet midis raportit që krijohet midis hapësirës territoriale ku është kryer veprimtaria administrative, që kundërshtohet me hapësirën territoriale ku ushtron detyrën gjyqtari administrativ. Kompetenca tokësore synon të lehtësojë zhvillimin e procesit gjyqësor, duke vendosur kufij horizontalë midis gjykatave të të njëjtës shkallë. Vlerësimi i kompetencës tokësore kryhet nga gjykata, pasi ajo është siguruar që çështja bën pjesë në kompetencën lëndore të saj. Me organizimin aktual të sistemit të gjykatave administrative, meqë ka vetëm 1 Gjykatë Administrative të Apelit, kompetenca tokësore i përket vetëm 6 gjykatave administrative të shkallës së parë.

Rregullat e kompetencës tokësore gjenden në nenin 11 të LGJA, ku në pikën 1 është përcaktuar se paditë kundër veprimit administrativ (aktit administrativ individual, kontratës administrative dhe veprimit tjetër administrativ) shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin. Ndërsa padia për aktin nënligjor normativ paraqitet në Gjykatën e vetme të Apelit në Tiranë, e cila e gjykon atë në shkallë të parë. Kur akti administrativ është ndryshuar nga organi administrativ më i lartë, atëherë padia ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë. Për pasojë, nëse akti administrativ nuk është ndryshuar, vlen rregulli paraardhës.

Paditë për marrëdhëniet e punësimit shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij¹¹. Ky rregull mbulon edhe rastet kur punëmarrësi ushtron një detyrë, e cila i kërkon të lëvizë në territor (për ilustrim janë veprimtaritë inspektuese).

Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm, që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës

së parë, që përfshin territorin në të cilin ndodhet sendi ose pjesa më e madhe e tij¹². Ndërsa paditë për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, përveç sa është parashikuar në këtë ligj, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin ku paditësi ka banimin ose vendqëndrimin. Këtu është e qartë që merret në mbrojtje pozita vulnerabël e këtyre individëve, e cila prezumohet për shkak të natyrës së kërimit të tyre.

Neni 11 në pikën 5 ka rregulluar situatën se kur kompetenca tokësore nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, atëherë kompetente është gjykata, në territorin e së cilës ka qendrën organi publik i paditur. Kjo normë ka karakter shpëtues, për të shmangur rastet që mund të krijojnë pamundësi të gjykimit të çështjes, por duhet vënë re se në këtë rast rregulli është plotësues.

Neni 13 i LGJA disiplinon edhe çështjet e defektit në kompetencë tokësore, por me ndryshimin se kjo lloj kompetence nuk prek rregullsinë e procesit të zhvilluar. Arsyeja në këtë rast lidhet pikërisht me thelbin e kësaj kompetence, që synon të lehtësojë zhvillimin e procesit gjyqësor, që nënkupton se nga pikëpamja e territorit, gjyqtarët individualë kompetentë në lëndë dhe në shkallë nuk kanë ndryshim nga njëri-tjetri. Për rrjedhojë, kompetenca tokësore kundërshtohet vetëm me kërkesë të palëve, derisa nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor i provave, pra, nga paraqitja e padisë deri në marrjen e vendimit të ndërmjetëm për fillimin e shqyrtimit të provave në seancë gjyqësore. Edhe në këtë rast, LGJA nuk vendos kritere formale për paraqitjen e kërkesës për kundërshtimin e kompetencës tokësore, që do të thotë se kërkesa mund të paraqitet verbalisht dhe dokumentohet në procesverbalin gjyqësor ose mund të paraqitet me shkrim dhe të depozitohet në gjykatë. Në praktikë, kërkesat për deklarimin e mungesës së kompetencës tokësore përpara gjykatës administrative të shkallës së parë, paraqiten me shkrim dhe shqyrtohen nga gjykata edhe në mungesë të palëve. Në rastin e hartimit të kësaj kërkesë me shkrim rekomandohet që kërkesa të përmbajë të dhënat e çështjes gjyqësore ku paraqitet fakti i cili mbështet pretendimin për mungesën e kompetencës tokësore, duke treguar edhe provat që e mbështesin një fakt të tillë nëse është e nevojshme, ligjin e zbatueshëm dhe kërkimin e palës. Sigurisht, që kërkesa duhet të tregojë pa të meta edhe palën gjyqësore, që e paraqet dhe të nënshkruhet rregullisht prej saj apo përfaqësuesit. Element shumë i rëndësishëm i kësaj kërkesë me shkrim është koha e depozitimit të saj në gjykatë: përpara vendimit të shqyrtimit të provave në seancë gjyqësore, pasi në të kundërt, një kërkim i tillë bie në dekadencë.

Nëse gjykata me kërkesë të palëve konstaton mungesën e kompetencës, atëherë ajo jep vendim të ndërmjetëm, duke treguar shkakun e moskompetencës dhe duke urdhëruar dërgimin e akteve gjykatës kompetente nga pikëpamja tokësore. Ky akt procedural mund të paraprihet nga projekt-vendimi i hartuar nga ndihmësi ligjor. Ky lloj vendimi jepet nga koha e paraqitjes së padisë në gjykatë gjer pa filluar me vendim shqyrtimi i provave në seancë gjyqësore. Në rastin kur gjykata disponon mungesën e kompetencës, me këtë lloj vendimi i jepet fund procedurës së gjykimit administrativ, por fillon procesi gjyqësor me natyrë tjetër, si rregull, gjykimi civil. Për këtë shkak,

¹¹ Shih nenin 11, pika 2 të LGJA

¹² Shih nenin 11, pika 3 të LGJA

gjykata disponon në dispozitivin e këtij vendimi dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Ndërsa kur gjykata refuzon kërkesën e palëve ndërgjyqëse për shpalljen e moskompetencës, ky lloj akti procedural përfshihet në kategorinë e vendimeve të ndërmjetme, brenda të njëjtit proces gjyqësor që zhvillohet në të njëjtën shkallë gjykimi.

Në çdo rast, vendimi gjyqësor për kompetencën tokësore duhet të jetë i arsyetuar. Për elementet minimale, që duhet të përmbajë arsyetimi i vendimit gjyqësor, vlejné shpjegimet e dhëna tek vendimet gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar dhe rregull në këtë rast synon të zbatojë parimin e gjyqimit të shpejtë administrativ. E njëjta gjë, mund të thuhet edhe për vendimin që rrëzon kërkesën e palëve për kundërshtimin e kompetencës së gjykatës.

Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali, jepet një model i kërkesës së palës së paditur për deklarimin e mungesës së kompetencës tokësore të shqyrtimit të padisë, sipas elementeve të nevojshme për t'u trajtuar në përmbajtje të tipologjisë së kërkesës.

3.4 Aktet mbi përbërjen e gjykatës

Neni 12 i LGJA vendos rregulla mbi formimin e trupit gjykues, në funksion të përshejtimit të gjyqimit të çështjes nga njëra anë, paralelisht me cilësinë e vendimmarrjes në anën tjetër. Përcaktimi i numrit të gjyqtarëve varet nga shkalla e gjyqimit dhe lloji i çështjes që gjykohet, ku gjykata më e lartë në shkallë gjykon me një numër më të lartë gjyqtarësh sesa gjykata më e ulët. Po ashtu, çështjet e karakterit procedural shqyrtohen nga një numër më i vogël gjyqtarësh se sa çështjet e themelit.

Në gjykimin në shkallë të parë çështjet gjyqësore shqyrtohen nga 1 gjyqtar me dy përjashtime. Përjashtimi i parë lidhet me mosmarrëveshjet që lidhen me kontratat administrative publike për shkak të karakterit kompleks të tyre dhe vlerës së interesit publik të prezumuar të tyre. Përjashtimi i dytë lidhet me kërkesat për dënimet administrative deri në 30 ditë heqje lirie apo zëvendësimin e tyre, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me lirinë e lëvizjes së individit, që përbën të drejtën themelore bazë të individit, pa të cilën ai nuk mund të ushtrojë lirisht të drejtat e tjera. Në këto dy raste përjashtimore, gjykata administrative vepron me trup gjykues të formuar nga 3 gjyqtarë. Me këtë rregullim mbi përbërjen e trupit gjykues ka një zhvendosje të theksit të rëndësisë së mosmarrëveshjes, duke mos e lidhur më me vlerën financiare të padisë. Gjykimi administrativ i jep tashmë peshë nivelit të ndërlikimit të argumentit juridik në raport me vlerën financiare të mosmarrëveshjes.

Në Gjykatën Administrative të Apelit shqyrtimi i çështjeve bëhet si rregull, me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë, me përjashtim të shqyrtimit gjyqësor mbi aktin nënligjor normativ, që bëhet me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Ky rregull e merr arsyen e tij tek nevoja për të pasur një vendimmarrje më cilësore. Këto lloj çështjesh kërkojnë një analizë më të kujdesshme

të interesit publik në raport me të drejtat individuale të shtetasve, që është një tregues i nivelit të ndërlikimit të çështjes. Shqyrtimi i ankimeve ndaj vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe i çështjeve të tjera që gjykohen në shkallë të parë prej saj, bëhet me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

Me përbërjen e gjykatës, jo në numër por në cilësi individuale, lidhen edhe kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit konkret nga një gjykim apo heqja dorë e vetë gjyqtarit nga gjykimi, në përmbushje të standardit kushtetues të gjykatës së paanshme. LGJA nuk shprehet në mënyrë të veçantë për kushtet për të qenë gjyqtar në një gjykim administrativ, për shkaqet dhe procedurën e largimit të një gjyqtari nga një gjykim administrativ. Për rrjedhojë, lidhur me përjashtimin e gjyqtarit apo heqjen dorë të tij, vlejné rregullat e neneve 71 e vijues të K.Pr.Civile në zbatim të nenit 1 pika 2 të LGJA. Megjithatë, për lehtësi praktike, Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit në gjykimin administrativ.

2

AKTET PROCEDURALE NË GJYKIMIN NË SHKALLË TË PARË

1. Padia si akt procedural në gjykimin administrativ

Akti që vë në lëvizje gjykimin administrativ është padia, kuptimi i së cilës jepet nga neni 31, paragrafi i parë i K.Pr.Civile, si e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Ndërsa thelbi i padisë është e drejta për akses në gjykatë mbi një të drejtë/interes të ligjshëm të cenuar, materializimi i saj bëhet nëpërmjet aktit shkresor të kërkesë padisë, i cili duhet të përmbajë elementet e nevojshme të kërkuara nga ligji për identifikimin e saktë të natyrës së mosmarrëveshjes që shtrohet për diskutim para gjykatës. Neni 153 i K.Pr.Civile përcakton se *“Gjykimi i një çështje në gjykatë, fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim”*.

Për qëllime saktësie, duhet theksuar se termi “padi” i referohet të drejtës subjektive (me natyrë procedurale), që gëzojnë subjekti që vë në lëvizje gjykimin administrativ dhe që shndërrohet në palë paditëse. Pra, në këtë kuptim bëhet fjalë për një të drejtë me natyrë materiale. Ky koncept është i ndryshëm nga ai i “kërkesëpadisë”, që i referohet dokumentit me të gjitha ekstremitetet formale ligjore. Në punën e përditshme ndodh rëndom që praktikantët e së drejtës, kërkesëpadisë i referohen me termin padi. Për qëllime të këtij Manuali është e rëndësishme të bëhet një diferencë e tillë, jo vetëm për saktësi profesionale, por edhe për të lehtësuar edhe kuptimin e shkeljeve eventuale dhe pasojave që vijnë prej këtyre shkeljeve.

Në këtë pjesë të Manualit jepen njohuri mbi:

1. elementet e nevojshme të kërkesëpadisë sipas K.Pr.Civile;
2. elementet e posaçme të kërkesëpadisë sipas LGJA;
3. elementet e nevojshëm të kërkesëpadisë jashtë përmbajtjes së saj dhe
4. afatit si kusht formal për depozitimin e kërkesëpadisë, duke përfshirë edhe mënyrat e llogaritjes së tij sipas situatave të paraqitjes së kërkesë padisë.

1.1 Elementët e nevojshëm të kërkesëpadisë sipas K.Pr.Civile

LGJA, në nenin 21, pika 1 të tij parashikon se padia lidhur me një mosmarrëveshje administrative, duhet të plotësojë kërkesat e neneve 154 e 156 të K.Pr.Civile. Në referim të këtyre dispozitave, kërkesëpadia hartohet në tri pjesë përbërëse të saj.

Pjesa hyrëse në të cilën duhet të gjejnë pasqyrim: (1) identiteti i subjekteve që përfshihen në proces sipas pozicionimit procedural që i jep paditësi dhe adresa e saktë e tyre; (2) objekti i padisë, që përbëhet nga një apo disa kërkitime të lidhura midis tyre; (3) baza ligjore e cila përbën tërësinë e dispozitave të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete; dhe (4) gjykata përpara së cilës paraqitet kërkesëpadia.

Të dhënat mbi subjektet procedurale (paditës, i paditur, person i tretë) janë të mjaftueshme për identifikimin e tyre, për aq sa ligji i kërkon, pa qenë e nevojshme pasqyrimi i të gjithë përbërësve

të gjendjes civile (p.sh. amësia, gjendja civile, apo arsimi përkatës)¹³. Kjo për faktin se të dhënat në kërkesëpadi i shërbejnë identifikimit të subjektit që ngre mosmarrëveshjen dhe identifikimit të adresës së banimit apo vendqëndrimit të tij, për qëllime të njoftimit nga gjykata.

Në funksion të argumentit të mësipërm, ka shumë rëndësi që kërkesëpadi të shoqërohet me një kopje të letërnjoftimit të paditësit person fizik ose me një ekstrakt i QKB-së kur paditësi është person juridik tregtar.

Pjesa shpjeguese në të cilën duhet të gjejnë pasqyrim: (1) faktet dhe rrethanat që lidhen me mosmarrëveshjen, në kronologji kohore të ndodhjes së tyre; (2) referimi në provat që shoqërojnë kërkesëpadinë, e në çdo rast në ato që konsiderohen kryesore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (dokumente apo mjete të tjera provuese); si dhe (3) gërshetimi i pretendimeve të subjektit me parashikimet ligjore ku ato gjejnë mbështetje.

Pjesa përmblylëse në të cilën pala paditëse duhet të artikulojë në sinkron me objektin e padisë, natyrën e kërkimeve të pretenduara nga gjykata, nënshkrimin e tij dhe datën e hartimit të padisë. Kërkesëpadi mund të hartohet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit paditës (avokati, përfaqësuesi i autorizuar i personit juridik, kujdestari apo prindi nëse paditësi është i mitur), i cili nënshkruan aktin e kërkesëpadiës mbi legjitimitimin nga ligji apo akti i përfaqësimit¹⁴. Për këtë arsye, neni 156 i K.Pr.Civile, kërkon që bashkë me kërkesëpadinë të paraqitet edhe prokura, në rast se ajo paraqitet në emër të paditësit nga përfaqësuesi i tij (shkronja “a” e dispozitës). Të metat e kërkesëpadiës, që vënë në dyshim legjitimitetin e paditësit (mungesa e nënshkrimit, nënshkrimi nga një person tjetër i paautorizuar apo mungesa e konfirmimit të përfaqësuesit, kur paditësi nuk ka zotësi të plotë për të vepruar), shkaktojnë pavlefshmëri të saj dhe të gjykimit, nëse ato nuk janë vlerësuar dhe riparuar gjatë gjykimit.

1.2 Elementët e posaçëm të kërkesëpadiës sipas LGJA

Neni 21 i LGJA, ka parashikuar disa elemente formale të kërkesëpadiës tej atyre që jepen nga neni 154 i K.Pr.Civile për qëllime garantuese të njoftimit efektiv të subjektit paditës. Pika 1 e kësaj dispozite kërkon:

1 Të treguarit saktë të adresës së paditësit të përfaqësuesit, në të cilën duhet t'i dërgohen nga gjykata njoftimet dhe aktet

Ky rregullim përforcues mbi rëndësinë e adresës së saktë, ku paditësi/përfaqësuesi kontaktohet, lidhet me garancitë për ecurinë e gjykimit administrativ pa vonesa nga mosrealizimi i njoftimeve, pasi gjykimi administrativ bazohet në parimin e procesit të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta e të arsyeshme¹⁵.

¹³ Neni 154 i K.Pr.Civile parashikon se: “Kërkesëpadi shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë.....emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë”.

¹⁴ Shih nenin 72 të K.Civil dhe nenin 96 të K.Pr.Civile

¹⁵ Shih nenin 3, pika 1 të ligjit 49/2012

Në funksion të këtij parimi, pika 5 e nenit 21 të LGJA, shprehet se: “Paditësi, për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës, numrit të telefonit dhe adresës elektronike të tij ose të përfaqësuesit, detyrohet të njoftojë gjykatën”. Ky përcaktim detyruet e vendos paditësin që e shkel atë në pozita të papranueshmërisë së pretendimeve për pavlefshmërinë e njoftimit në adresën e mëparshme.

2 Mënyrat alternative të njoftimit të paditësit

Paditësi në kërkesëpadi duhet të tregojë saktë një numër telefoni të tij ose të përfaqësuesit, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, një adresë elektronike të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike. Në interpretim jo vetëm literal të dispozitës, kontakti telefonik dhe nëpërmjet adresës elektronike, i kërkon paditësit për të mundësuar njoftimin e tij edhe në këto mënyra si garanci për marrjen dijeni, por në kushtet kur personat nuk janë të detyruar të kenë të tilla mjete kontakti, paraqet rëndësi fakti që, nëse paditësi zgjedh t'i japë ato, duhet t'i shoqërojë me deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike.

Në pjesën shpjeguese të kërkesëpadiës, paditësi, është i detyruar të identifikojë saktë veprimin ose mosveprimin administrativ që kundërshton për të sqaruar gjykatën për atë pjesë të veprimtarisë administrative të organit publik të paditur, të cilës i atribuohet paligjshmëria e pretenduar dhe që fokuson objektin e shqyrtimit gjyqësor. Për ilustrim, nëse paditësi është ngarkuar me një detyrim fiskal, veprimi administrativ që kundërshtohet është akti administrativ që ka përcaktuar detyrimin (njoftim vlerësimi i organit tatimor ku paditësi është regjistruar si tatimpagues, apo vendimi i dënimit me gjobë i organit inspektues për fushën e veprimtarisë së ushtruar nga paditësi), nëse paditësi pretendon se nga mosveprimet e organit publik atij i është shkaktuar dëm, mosveprimi administrativ është sjellja e munguar e autoritetit publik, pasojë e së cilës është dëmi jashtëkontraktor etj.

1.3 Elementët e nevojshëm të kërkesëpadiës jashtë përmbajtjes së saj si akt

1.3.1 Aktet e nevojshme në shoqërim të padisë (provat)

Kërkesëpadi është e shqyrtueshme kur ajo është e plotë në elementet e saj formale dhe shoqërohet nga aktet provuese që në kohën e depozitimit të saj. Ky rregull është i përgjithshëm për gjykimin civil sipas parashikimit në nenin 156/b të K.Pr.Civile¹⁶, i lidhur me përcaktimin parimor në nenin 12 të K.Pr.Civile¹⁷, për shkak se në konfliktet e natyrës private (civile), barra e provës i takon pretenduesit¹⁸.

¹⁶ Bashkë me kërkesëpadinë duhet të paraqiten...

b) kopje të kërkesëpadiës dhe të akteve provuese, në numër sa janë të paditurit, si dhe për rastin e parashikuar nga neni 197 i K.Civil.

¹⁷ Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj.

¹⁸ Nenet 231 dhe 267/1 të K.Pr.Civile

Në gjykimin administrativ, mbizotëron rregullimi sipas ligjit specifik, LGJA, i cili në nenin 21, pika 2 të tij përcakton shprehimisht se: *“Paditësi, përveç aktit administrativ që kundërshton, nuk ka detyrim t’i bashkëlidhë padisë akte provuese, por, nëse i paraqet ato, duhet të paraqesë edhe kopje të tyre për të paditurin”*. Duke qenë se objekti i gjyimit administrativ është paligjshmëria e pretenduar e organit publik në kuadër të ushtrimit prej tij të veprimtarisë administrative, barra e provës për bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të veprimeve të kryera prej organit publik i takon këtij të fundit¹⁹.

Për shkak të barrës së provës tek organi publik, paditësi ka të drejtë të investojë gjykatën duke paraqitur vetëm aktin administrativ që kundërshton, por mosparaqitja e këtij të fundit e lë padinë me të meta.

Vlen të sqarohet në këtë aspekt të analizës së kërkesëpadisë se përcaktimi i mësipërm nuk është kategorik, në kuptimin që paditësi të justifikohet të mos paraqesë asnjë provë shkresore në gjykatë. Barra e provës bie mbi organin publik që ky i fundit të provojë ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet dhe jo të provuarit e fakteve të ndodhura.

SHEMBULL: Nëse paditësi është liruar nga detyra në një sektor të shërbimit publik, i takon punëdhënësit të paraqesë prova që justifikojnë ligjërisht veprimin e lirit nga detyra (të provuarit mbi sjelljen e ligjshme të punëdhënësit), por nëse paditësi pretendon se marrëdhënia e punës ka zgjatur 8 vjet, (të provuarit mbi faktet) detyrimi për paraqitjen e librezës së punës, apo vërtetimit që provon vjetërsinë në shërbim, i takon paditësit.

Gjithashtu, neni 35, pikat 1 dhe 3 të LGJA parashikojnë se barra e provës i bie organit publik kur veprimi administrativ është nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, në të kundërt ky i fundit ka detyrimin të provojë faktet, në të cilat bazon pretendimin e tij.

SHEMBULL: Nëse ndaj paditësit është ushtruar kontroll mbi cilësinë e karburantit të tregtuar nga ISHTI dhe ka një vendim dënimi me gjobë, barra e provës i takon organit publik, por nëse paditësi ka kërkuar shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit dhe kjo është refuzuar, barra e provës për paligjshmërinë e vendimarrjes të organit publik i takon paditësit.

1.3.2 Tarifa e ngritjes së padisë

Çështja e tarifës gjyqësore është marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese e lidhur me procesin e rregullt ligjor në drejtim të aksesit në drejtësi²⁰. Kjo Gjykatë ka arsyetuar se duhet dalluar koncepti i taksës, si një detyrim financiar që duhet paguar nga të gjithë individët, nga ai i tarifës së shërbimit, që në rastin konkret është një detyrim financiar, i cili paguhet në këmbim të një shërbimi në fushën gjyqësore. Gjykata Kushtetuese ka evidentuar se edhe GJEDNJ, asnjëherë nuk e ka përjashtuar mundësinë që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë një kufizim financiar

19 Shih nenin 3, pika 3 dhe nenin 35 të LGJA

20 Shih vendimin nr. 7 datë 27.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese

në të drejtën e aksesit në gjykatë. Megjithatë, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm që zë e drejta e aksesit në një shoqëri demokratike, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin në një mënyrë apo shkallë që dëmton thelbin e kësaj të drejte²¹. Në disa çështje konkrete, në lidhje me pagesën paraprake të tarifave gjyqësore, GJEDNJ-ja ka marrë parasysh mundësinë financiare të aplikantit për të paguar tarifën dhe fazën e procesit gjyqësor në të cilin është vendosur ky kufizim, si faktorë materialë për të përcaktuar nëse aplikanti e ka gëzuar të drejtën e aksesit²². Sipas Gjykatës Kushtetuese, çdo individ që i drejtohet me padi gjykatës është i detyruar të parapaguajë taksën mbi aktet²³, e cila caktohet mbi bazën e vlerës së padisë. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se gjyqtari i zakonshëm nuk pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e kësaj tarife, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. Gjyqtari i zakonshëm ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural për ngritjen e padisë dhe për të bërë përjashtimet rast pas rasti, në mënyrë që të mos pengojë realizimin e të drejtës së aksesit në gjykatë. Sipas dispozitave procedurale civile, në rastet e përjashtimit të individit nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, ku përfshihet edhe taksa mbi aktet, këto shpenzime përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit²⁴. Nga ana tjetër, ligji nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, ka përcaktuar një organ shtetëror kolegjal, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, detyra kryesore e të cilit është t’u ofrojë ndihmë juridike kategorive të caktuara të individëve, duke kryer shpenzimet përkatëse²⁵. Në këtë rast, tarifa gjyqësore nuk pengon aksesin në drejtësi, pasi i takon gjyqtarit të hetojë, mbi bazën e dokumentacionit provues të pamundësisë ekonomike të paraqitur nga paditësi dhe të vlerësojë, duke iu referuar legjislacionit procedural civil dhe rregullimeve ligjore përkatëse, nëse është rasti për përjashtimin e paditësit nga pagesa e tarifës për shërbime gjyqësore.

Tarifa si element i kërkesëpadisë përcaktohet në varësi të objektit të padisë dhe përfaqëson pagimin ndaj shërbimit gjyqësor që i ofrohet personave fizikë dhe juridikë.²⁶

SHEMBULL: Nëse objekti i padisë është shfuqizimi i një akti administrativ (vendim për revokim të lejes për aktivitet minerar) tarifa për gjykim është në masën fikse 3.000 lekë, ndërsa nëse objekti i padisë është shpërbim dëmi jashtëkontraktor, tarifa për gjykim është në masën 1% të vlerës së dëmit të pretenduar, nëse kjo vlerë kalon shumë 300.000 lekë.

Sipas pikës 3 të Udhëzimit nr. 33/2014, tarifat paguhet në momentin e kryerjes së veprimeve dhe bëhen me anën e pullës për tarifat fikse ose me mandat-arkëtim për ato raste kur, kjo tarifë sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur udhëzimit, është shprehur në përqindje.

21 Shih Kreuz kundër Polonisë, 19 qershor 2001, perifraxim

22 Shih Kreuz kundër Polonisë, nr. 28249/95, § 58-67, ECHR 2001 VI; Weissman dhe të tjerët kundër Rumanisë, nr. 63.945 / 00, § 33-43, ECHR 2006 VII (ekstrakte), Adnan Özdemir kundër Turqisë; vendimi i datës 20 maj 2010.

23 ose “tarifën për shërbime gjyqësore”, sipas udhëzimit të përbashkët të MD dhe MF.

24 Shih nenin 105/b K.Pr.Civile

25 Shih nenin 10 dhe 14 të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”

26 Tarifa përcaktohet sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe të Drejtësisë nr. 33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë dhe Noterisë”, Shtojca nr. 1, pika 8 e të cilit përcakton masën e tarifës në lekë dhe në përqindje.

Një model mbi mënyrën e hartimit të kërkesëpadsisë dhe të elementeve të nevojshme të saj, gjendet në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali.

1.4 Afati si kusht formal për depozitimin e kërkesëpadsisë dhe llogaritja e tij

E drejta e ushtrimit të padsisë, në gjykimin administrativ, kushtëzohet në afat për paraqitjen e kërkesëpadsisë në gjykatë, rregullimin e përgjithshëm për të cilin e bën neni 18 i LGJA, pika 1 e të cilit thotë se padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Fillimi i afatit varet nga rregullimi sipas ligjit të posaçëm i shterimit të ankimit administrativ apo nga sjellja e organit publik të paditur.

Disa prej situatave të përcaktuara në nenin 18 të LGJA dhe që hasen në më të shumtën e rasteve të praktikës gjyqësore, referohen si më poshtë:

1 afati i paraqitjes së padsisë fillon nga data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epior, që ka shqyrtuar ankimin administrativ. Për ilustrim, afati i padsisë kundër vendimit të dënimeve administrative të Degëve Rajonale të ISHMP-ve fillon nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit të Ankimit pranë ISHMP në Ministrinë e Mjedisit.

2 afati i paraqitjes së padsisë fillon nga data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë. Për ilustrim, padia kundër vendimit për prishje të objektit ndërtimor nga IMT, njësi vendore pranë Bashkisë së Tiranës, fillon nga data e njoftimit të vendimit.

3 afati i paraqitjes së padsisë fillon nga data e njoftimit, data e marrjes së dijenisë për ndërhyrjen e paligjshme të organit publik mbi të drejtat dhe interesat ligjorë të subjektit. Për ilustrim, padia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga shpronësimi në fakt, fillon nga koha e identifikimit të veprimit të paligjshëm të organit publik që kryen veprimin etj.

Theksojmë se afati 45 ditor zbatohet kur ligji i posaçëm nuk parashikon ndonjë afat tjetër.

SHEMBULL: Afati për paraqitjen e padsisë në gjykatë të autoritetit rajonal tatimor ndaj Drejtorisë së Apelit Tatimor është brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për vendimin e kësaj Drejtorie²⁷. Po kështu, afati për paraqitjen e padsisë në gjykatë ndaj vendimit të IKMT-së është brenda 10 ditëve nga marrja dijeni për të²⁸.

²⁷ Ligji nr. 9920/2008, neni 109, pika 3: "Administrata tatimore, e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendrike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim."

²⁸ Ligji nr.9780 datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar me ligjin 183/2014, neni 14: "Kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtpërdrejt në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit."

Afati i paraqitjes së padsisë është kusht formal i saj, mosrespektimi i të cilit passjell vendimin e gjykatës për mospranimin e padsisë sipas nenit 39, pika 2 të LGJA²⁹, pra, nëse padia paraqitet jashtë afatit, gjykata merr vendim të natyrës jopërfundimtare, pasi nuk i hyn shqyrtimit në themel të saj. Mos mbajtja parasysh e rëndësisë të afatit të paraqitjes së padsisë dhe si rrjedhojë paraqitja e padsisë me vonesë përpara gjykatës i kushton paditësit vetë aksesin në gjykatë.

2. Aktet procedurale shoqëruese të kërkesëpadsisë

Si akte që shoqërojnë kërkesëpadsinë, vlejné të përmenden: (1) Deklarata për njoftim me telefon dhe adresë elektronike; (2) Kërkesa për akt ekspertimi; dhe (3) Kërkesa për thirrje të dëshmitarëve.

2.1 Deklarata për njoftim me telefon dhe adresë elektronike

Njoftimi është një mjet procedural, që synon të realizojë nga njëra anë të drejtën e personit për të marrë dijeni mbi një veprim procedural që është kryer apo do të kryhet nga gjykata. Në këtë pikëpamje, LGJA përmban garanci të mjaftueshme që personi, i cili konsiderohet ligjërish i njoftuar, të ketë marrë në dorëzim në fakt aktin përkatës. Nga ana tjetër, rregullat e njoftimit synojné që askush të mos pengojë procedurat, duke iu shmangur njoftimit apo duke mohuar njoftimin e kryer. Në diskutimin e çështjes së njoftimeve duhet vënë re se meqë gjykimi administrativ përbëhet nga një tërësi veprimesh procedurale, që fillon nga paraqitja e çështjes në gjykatë deri në ekzekutimin e të drejtës së fituar gjyqësisht, njoftimi zë vend në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit. Ligji nr. 49/2012 referon tek K.Pr.Civile për mjetet dhe mënyrat e njoftimit, përveçse kur vetë ky ligj parashikon ndryshe³⁰. Rastet e ndryshme të njoftimit në gjykimin administrativ janë:

- a. Njoftimet me telefon;
- b. Njoftimet elektronike.

Këto dy forma janë përjashtimore dhe zbatohen kur gjykata e çmon të dobishme dhe gjithmonë nëse palët kanë dhënë pëlqimin paraprakisht.

Nuk duhet harruar që gjykimi administrativ ka natyrë të ngutshme dhe për qëllime të realizimit të tij në afate të shpejta kohore është parashikuar mënyra e njoftimit me telefon ose nëpërmjet adresës elektronike, e cila konsiderohet e konfirmuar kur paditësi paraqet në shoqërim të padsisë, deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike. Për të theksuar rëndësinë e këtyre formave të njoftimit, ligji ka vendosur që vullneti i paditësit të shprehet me një deklaratë të veçantë mbi këtë fakt, e cila shoqëron padinë. Njoftimet urdhërohen nga gjykata, por gjithnjë ekzekutohen nga sekretaria gjyqësore, që nënkupton se ky është një akt procedural që përmbushet nga stafi administrativ në

²⁹ Gjikata vendos mospranimin e padsisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Ky vendim jepet derisa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave.

³⁰ *Shih* nenin 1, pika 2 dhe nenin 22 të LGJA

gjykatë, por vlerësohet për vlefshmërinë ligjore të tij prej gjyqtarit. Në rastin e njoftimit me telefon, sekretarja gjyqësore duhet të ndjekë përcaktimet specifike të dhëna në nenin 22 të LGJA nëpërmjet telefonit të gjykatës, të përcaktuar për këtë qëllim me urdhër të kancelarit të gjykatës.

Është e rëndësishme të vihet re se pas ngritjes së padisë, paditësi ka detyrimin të njoftojë gjykatën për ndryshimet e mundshme të të dhënave të tij për njoftim. Shkelja e këtij detyrimi shoqërohet me humbjen e të drejtës për të kërkuar pavlefshmërinë e njoftimit për shkak të ndryshimit të të dhënave për njoftim, pra, në një rast të tillë, gjykata vendos mospranimin e kërkesës së tij, pavarësisht fazës apo shkallës së gjykimit të ngritjes së kësaj kërkesë. Rregullat e detyrimit të paraqitjes së të dhënave për njoftim dhe të ndryshimit të tyre vlejné edhe për përfaqësuesin, nëse paditësi ka zgjedhur një të tillë.

Rregullat e njoftimit synojné të përmbushin disa kërkesa të domosdoshme për efektivitetin e procesit gjyqësor. Krahas marrjes dijeni të subjektit për veprimin gjyqësor që është kryer apo do të kryhet, duhet siguruar edhe shpejtësia e procedimit, por pa dëmtuar standardet e procesit të rregullt ligjor të trajtuara tashmë gjerësisht prej jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Kështu, në një sërë vendimesh³¹, ku është shqyrtuar rregullshmëria e procesit, është theksuar se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e individit.

Nëse ndodh që kontakti telefonik apo adresa elektronike të jenë shënuar në përmbajtje të kërkesëpadisë, por të pa shoqëruara me deklaratën e posaçme të pranimit të njoftimit, gjykata mund t'i përdorë këto mënyra për praktikitet të njoftimeve, por nëse subjekti paditës nuk paraqitet, njoftimi nuk konsiderohet i përmbushur për mungesë të dokumentit që i ligjëron këto forma njoftuese. Rregulla më të hollësishme për njoftimin elektronik përcaktohen nga Urdhri i Ministrisë të Drejtësisë nr. 642, datë 07.11.2013 "Për mënyrën e njoftimit elektronik të akteve gjyqësore në gjykimin administrativ".

Një model i deklaratës për pranimin e njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike, si dhe një model i procesverbalit që pasqyron njoftimin e paditësit me telefon, jepen në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali.

2.2 Kërkesa për akt ekspertimi

Provat e nevojshme në gjykimin administrativ "mblidhen" në fazën e veprimeve përgatitore, dhe kur çështja nuk mund të zgjidhet pa njohuri të posaçme në një fushë të caktuar (gjeodezi, inxhinieri ndërtimi, vlerësim pasurie të paluajtshme, dëm shëndetësor, kontabilitet etj.), gjykata vijon me vendim të ndërmjetëm për kryerjen e ekspertimit në veprime të natyrës përgatitore, brenda 7 ditëve nga paraqitja e padisë.

³¹ Shih vendimet nr. 5/2013, nr. 26/2012, nr. 26/2012, 45/2011, nr. 30/2012 dhe nr. 35/2013 të Gjykatës Kushtetuese

Në këtë vendim të ndërmjetëm, gjykata përcakton fushën e ekspertimit, ekspertin nga lista e gjykatës, detyrat përkatëse, si dhe afatin e kryerjes së ekspertimit, i cili, si rregull, nuk mund të jetë më i gjatë se 20 ditë³².

Për t'i paraprirë një akti ekspertimi vetëm mbi vlerësimin e gjykatës, pala paditëse ka detyrimin që, nëse vlerëson se çështja ka nevojë për ekspertizë duhet të paraqesë listën me ekspertët që kërkon të merren, adresat e kontaktit, si dhe detyrat konkrete që vlerëson se duhet të shtrohen për zgjidhje. Kjo e drejtë parashikohet nga neni 227 i K.Pr.Civile³³, dispozitat e të cilit plotësojnë dispozitat e LGJA, për sa kohë nuk bien ndesh me to.

Një model i kërkesës për thirrje të ekspertit/ekspertëve jepet në Shtojcën e këtij Manuali.

2.3 Kërkesa për thirrje të dëshmitarëve

Gjykimi administrativ është në parim gjykim mbi aktet, i cili sipas nenit 3, pika 4 të LGJA, në varësi të natyrës së çështjes, i referohet të dy formave të gjykimit:

1. shqyrtimi i çështjes gojarisht në seancë gjyqësore;
2. shqyrtimi i çështjes mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi.

Kur natyra e çështjes dhe gjendja e provave lejojnë marrjen e provës me dëshmitarë (provë, e cila për shkak të natyrës së saj kërkohet zakonisht nga paditësi), ky i fundit, sipas nenit 21, pika 4 të LGJA është i detyruar të paraqesë në shoqërim të kërkesëpadisë, listën e personave që kërkon të thirren në gjykim si dëshmitarë, duke përcaktuar saktë edhe adresën e tyre.

Dëshmia është provë që merret gjatë hetimit gjyqësor të çështjes, por pikërisht për të organizuar marrjen e provave në veprime përgatitore, paditësi ka detyrimin që, nëse i kërkon gjykatës të marrë dhe vlerësojë "thëniet e dëshmitarëve" si provë, të garantojë thirrjen e tyre nëpërmjet informacionit që kërkohet të jepet nga dispozita e sipërcituar³⁴.

Gjithsesi, vlen të theksohet se dëshmia si provë rregullohet nga dispozitat e Kreut VII të Titullit II të K.Pr.Civile, sipas të cilave pranimi i lejimit të provës me dëshmitarë duhet të plotësojë një nga rrethanat e nenit 233 të të njëjtit Kod, gjithnjë brenda rregullit të përgjithshëm të vendosur nga neni 231 i tij, i cili thotë: "Prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë".

Po kështu, procedura gjyqësore e marrjes së dëshmisë, i nënshtrohet përcaktimeve të neneve 235 deri 245 të K.Pr.Civile, siç ndodh edhe në gjykimin e zakonshëm civil (rregullat e dëgjimit të dëshmitarit, procedura e betimit, radha e pyetjes).

³² Shih nenin 25/c të ligjit 49/2012

³³ Gjykata, pasi merr edhe mendimin e palëve, i cakton ekspertit çështjet për të cilat duhet të merret mendimi i tij.

³⁴ Neni 21, pika 4 e ligjit 49/2012 përcakton: "Paditësi është i detyruar të paraqesë listën e personave, që kërkon të thirren në gjykim, me cilësinë e ekspertit apo të dëshmitarit, duke përcaktuar saktë edhe adresën e tyre".

Verifikimi i situatave ndaluese për pyetjen si dëshmitar³⁵ është në përgjegjësinë e gjykatës që shqyrton çështjen dhe jo të paditësit që e kërkon atë, e për shkak se përmbushet në fazën e hetimit gjyqësor, gjykata nuk justifikohet të mos vijojë me njoftimin e shtetasve që paditësi kërkon të dëshmojnë.

Një model i kërkesës së paditësit për thirrje të dëshmitarëve jepet në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali.

3. Aktet procedurale në veprime përgatitore dhe në seancën përgatitore

LGJA i kushton 19 rregulla shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë të përmbledhura në nenet 20-38 të Kreut V të emërtuar “Shqyrtimi gjyqësor në shkallë të parë”. Procesi në shkallë të parë është i formuar në dy faza: (1) veprimet paraprake; dhe (2) gjykimi. Faza e parë e veprimeve paraprake apo përgatitore i shërben të dytës dhe të dyja së bashku janë në funksion të një vendimmarrje të shpejtë dhe të drejtë.

Veprimet përgatitore (neni 25 i LGJA) janë faza e parë e gjykimit administrativ dhe janë me rëndësi vendimtare për suksesin e gjykimit. Ato janë tërësisht në funksion të përgatitjes së gjyqtarit me pretendimet dhe provat e paditësit, me prapësimet e mundshme dhe provat e të paditurit për identifikimin e fakteve të errëta dhe që kërkojnë njohuri të posaçme nga fusha të veçanta, si dhe për çdo çështje tjetër të nevojshme, të cilat kërkojnë veprime të parashikuara nga neni 158/a të K.Pr.Civile, për aq sa ato janë të pajtueshme me nenet e LGJA-së. Në këtë fazë të procesit gjyqësor janë dy kategori aktesh procedurale: (1) aktet e disponuara nga gjykata; dhe (2) aktet procedurale të akteve ndërgjyqëse.

3.1 Aktet e disponuara nga gjykata

Ligji specifik mbi gjykimin administrativ, parashikon kryerjen e veprimeve përgatitore nga gjyqtari të cilit i është caktuar çështja me short, brenda brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, qëllimi i të cilave është të verifikojë dhe zgjidhë çështjet procedurale që pengojnë ecurinë e procesit, përpara sesa të vijohet me caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.

Veprimet përgatitore të para kryhen nga gjyqtari dhe dokumentohen në procesverbalin e veprimeve përgatitore, që përpilohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhen prej tij dhe gjyqtarit kryesues. Ndër veprimet e para të verifikueshme më të rëndësishmet janë:

- » verifikimi i të metave të padisë dhe nëse ka të tilla, lënien kohë palës paditëse për t'i plotësuar ato³⁶;
- » njoftimi ndaj palës/palëve të paditur/paditura, personit të tretë dhe Avokaturës së

35 Shih nenin 235 të K.Pr.Civile

36 Neni 25, pika 1, shkronja “a” e ligjit 49/2012

Shtetit i padisë dhe i akteve shoqëruese, duke i lënë afat për paraqitjen e prapësimeve dhe provave³⁷;

- » vendimi për kryerjen e ekspertimit dhe modalitetet përkatëse mbi detyrat e nevojshme dhe administrimin e deklaratës së ekspertit³⁸;
- » çdo veprim tjetër, i cili parashikohet nga neni 158/a i K.Pr.Civile, për aq sa pajtohet me nenet e LGJA.

SHEMBULL: Në veprimet e para përgatitore, të cilat dokumentohen në procesverbalin e mbajtur brenda 7 ditëve nga paraqitja e padisë, gjykata mund të disponojë mbi masën e sigurimit të padisë, e cila sipas nenit 28 të LGJA, duhet shqyrtuar brenda 5 ditëve nga paraqitja e padisë dhe në raste të ngutshme edhe pa njoftuar palët. Po kështu, në veprime përgatitore gjykata mund të disponojë kryesisht mbi moskompetencën lëndore të gjykimit të mosmarrëveshjes, pa qenë e nevojshme të kryhen veprime të mëtejshme për njoftimin e palëve.

Nëse përmbajtja e padisë dhe gjendja e provave mjaftojnë për sqarimin e natyrës së mosmarrëveshjes, gjykata, pas përfundimit të veprimeve përgatitore pa praninë e palëve, mund të vijojë me caktimin e seancës për gjykim dhe njoftimin e palëve për të.

Nëse padia është e ndërlikuar në tërësinë e kërkimeve të saj, provat e paraqitura nuk janë të mjaftueshme apo formalisht të rregullta, si dhe kur ekspertimi vlerësohet i nevojshëm, gjykata mund të vlerësojë të caktojë një seancë të natyrës përgatitore me pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse, seancë në të cilën kryhen të gjitha veprimet e tjera përgatitore.

Disa prej akteve procedurale më të rëndësishme, që nxirren në kuadër të kryerjes së veprimeve përgatitore janë:

1. Aktet e njoftimit të palëve;
2. Vendimi i gjykatës për plotësimin e të metave të padisë;
3. Vendimi i gjykatës për kthimin e padisë dhe të akteve të saj shoqëruese;
4. Vendimi për caktim të ekspertit dhe detyrave të tij;
5. Deklarata për betimin e ekspertit, që administrohet jashtë seancës gjyqësore;
6. Procesverbali i veprimeve përgatitore; dhe
7. Urdhri për caktim të seancës gjyqësore.

Secili nga këto akte i përket gjykatës (me përjashtim të deklaratës së ekspertit e prezantuar për shkak të administrimit të saj në veprime përgatitore). Në vijim, prezantohet në mënyrë të përmbledhur secili prej këtyre akteve, për të dhënë njohuri mbi thelbin e rëndësisë së aktit.

37 Neni 25, pika 1, shkronja “b” e ligjit 49/2012

38 Neni 25, pika 1, shkronja “c” e ligjit 49/2012

3.1.1 Aktet e njoftimit në gjykimin administrativ

Me paraqitjen dhe regjistrimin e kërkesëpadsisë, në gjykimin administrativ hasen dy lloj njoftimesh që urdhëron gjykata, të cilat përmbushen nga sekretaria gjyqësore. Bëhet fjalë për njoftimin e posaçëm për padinë dhe aktet e saj shoqëruese, si dhe për njoftimin për seancën e veprimeve përgatitore/gjyqësore.

Gjykimi administrativ parimisht mund të zhvillohet në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh shkresore, situatë në të cilën palët nuk dëgjohen, por gjykata vendos mbi të drejtën e pretenduar duke administruar padinë, prapësimet dhe provat shoqëruese të tyre. Për këtë qëllim, LGJA ka parashikuar në nenin 25, pika 1/b të tij, detyrimin e komunikimit të padisë dhe akteve të saj palës së paditur, duke i lënë deri në 10 ditë kohë nga data e marrjes së njoftimit, për depozitimin në sekretari të prapësimeve me shkrim, të akteve të plota shkresore, të listës së personave, që i padituri kërkon të thirren në gjykim, me cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit dhe adresat e tyre.

Afati 10 ditor maksimal disiplinon subjektin e paditur t'i bëjë me dije gjykatës qëndrimin e tij me shkrim, si dhe t'i paraqesë provat që justifikojnë kryerjen e veprimit administrativ që është objekt kundërshtimi gjyqësor dhe nëse ka pasur rrugë të ankimit administrativ, i padituri duhet të paraqesë edhe provat që justifikojnë shqyrtimin e ankimit administrativ (siç do të ishte depozitimi i kërkesës ankimore pranë organit më të lartë administrativ dhe provat e trajtuara përpara organit që shqyrton ankimin).

Ky përcaktim i shërben gjykimin në afate të shpejta dhe në garanci të përmbushjes së detyrimit të mësipërm, neni 26, pika 1 e LGJA parashikon shprehimisht:



“Me kërkesë me shkrim të motivuar të organit publik, të paraqitur brenda afatit të caktuar, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 25 të këtij ligji, gjykata i cakton atij një afat të dytë, që duhet të mbarojë jo më vonë se 5 ditë përpara datës së seancës gjyqësore. Në rast të mosparaqitjes së provave edhe brenda afatit të dytë të caktuar, shqyrtimi i çështjes vazhdon vetëm mbi aktet e paraqitura”.



Ky formulim penalizon organin publik si të paditur, i cili si rregull ka barrën e provës për ligjshmërinë e veprimit administrativ.

Duke u kthyer tek detyrimi i gjykatës për komunikimin e kërkesëpadsisë dhe akteve ndaj palës së paditur, ky i fundit, mund të bëhet në të njëjtin akt njoftimi për seancën e parë me prani të palëve (përgatitore apo gjyqësore), apo dhe në një akt të veçantë, i cili i paraprin njoftimit për seancën.

Bashkërisht apo jo me njoftimin për seancë, njoftimi për komunikimin e padisë dhe akteve ndaj

palës së paditur, duhet të përmbajë disa elemente që konfirmojnë realizimin me sukses të tij. Një model i këtij akti njoftimi jepet në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali.

Ndonëse dispozita formulohet e tillë (duke përcaktuar detyrimin për njoftim të padisë dhe akteve palës së paditur), nëse në gjykim është thirrur një/disa subjekt/e në cilësinë e personit të tretë, gjykata kryen të njëjtin komunikim, nisur nga përcaktimi i nenit 195, paragrafi i parë i K.Pr.Civile, i cili përcakton se personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejohen palëve, përveç atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë. Po kështu, Avokatura e Shtetit, sipas nenit 79/a të K.Pr.Civile³⁹, siguron aktet me urdhër të gjykatës, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim.

3.1.2 Vendimi i gjykatës për plotësimin e të metave të padisë

Disa nga të metat e vërejtura në aktin e kërkesëpadsisë, të hasura më shpesh në praktikën gjyqësore, të cilat kushtëzojnë veprimet procedurale për vëniën në lëvizje të saj janë:

- » mungesa e adresës së plotë dhe të saktë të palës së paditur/personit të tretë (veçanërisht kur me të tillë cilësi janë personat fizikë apo persona juridikë privatë);
- » mungesa e aktit administrativ që kundërshtohet gjyqësisht;
- » mosparapagimi i tarifës për paraqitjen e padisë.

Të metat e padisë konstatohen menjëherë nga gjykata, e cila disponon me vendim lënien kohë subjektit paditës për plotësimin e të metave, duke i listuar ato në përmbajtjen e vendimit të kësaj natyre dhe duke i lënë afat jo më shumë se 10 ditë. Ky vendim parashikohet nga neni 25, pika 1/a e LGJA në lidhje me nenet 154 dhe 156 të K.Pr.Civile. Një model i dispozitivit të vendimit gjyqësor të kësaj natyre jepet në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali.

Llogaritja e afatit të caktuar për plotësimin e të metave fillon me marrjen dijëni të subjektit, duke marrë në konsideratë mundësinë që paditësi edhe ditën e fundit të afatit mund t'i nisë aktet për plotësimin e të metave me shërbim postar, rrethanë, e cila do të zgjaste afatin e verifikimit, në eventualitetin që subjekti paditës ndodhet në një qytet të ndryshëm nga ai ku ka selinë gjykata administrative e shkallës së parë.

3.1.3 Vendimi i gjykatës për kthimin e padisë dhe të akteve të saj shoqëruese

Nëse brenda afatit të caktuar, pala paditëse nuk ka plotësuar të metat e gjetura të kërkesëpadsisë, vendimi i vetëm i mundshëm i gjykatës është kthimi i padisë dhe i akteve që i bashkëlidhen asaj. Ky përcaktim i dhënë nga neni 25, pika 1/a e LGJA është në harmoni me përcaktimin e paragrafëve

³⁹ Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim.

nga 3 deri 6 të nenit 154/a të K.Pr.Civile⁴⁰, në referim të të cilave paraqet rëndësi të theksohet se mosplotësimi njëkohësisht i të gjitha elementeve passjell kthimin e padisë. Afati i ankimit ndaj vendimit për kthimin e padisë dhe të akteve që e shoqërojnë atë është i veçantë, pra, 5 ditë nga e nesërmja e njoftimit. Një model i dispozitivit të vendimit gjyqësor të kësaj natyre jepet në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali.

3.1.4 Vendimi për caktim të ekspertit dhe detyrave të tij

Në gjykimin administrativ, ekspertimi është provë që krijohet në proces, ashtu si edhe në gjykimin e zakonshëm civil, por nëse në këtë të fundit procedura për ekspertimin fillon në fazën e hetimit gjyqësor, zakonisht pasi janë dëgjuar palët dhe janë paraqitur provat e tjera prej tyre, në gjykimin administrativ procedura e ekspertimit fillon me veprime përgatitore, me vendimin e gjyqtarit për të.

Vendimi i gjyqtarit për kryerjen e ekspertimit në një ose disa fusha të caktuara, nuk lidhet me faktin nëse pala paditëse e ka kërkuar atë, sikundër kërkesa e paditësit për ekspert nuk imponon gjykatën në caktimin e tij, nëse kjo nuk vlerësohet e nevojshme.

Në vendimin për kryerjen e ekspertimit, gjyqtari përcakton:

1. fushën e ekspertimit;
2. ekspertin nga lista e gjykatës;
3. detyrat përkatëse, si dhe
4. afatin e kryerjes së ekspertimit, i cili, si rregull, nuk mund të jetë më i gjatë se 20 ditë⁴¹.

Vendimi për kryerjen e ekspertimit i njoftohet menjëherë palëve dhe ekspertit. Palët brenda 3 ditëve nga njoftimi i vendimit, mund të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim në lidhje me paanshmërinë, njohuritë e posaçme të ekspertit në fushën përkatëse dhe të kërkojnë përjashtimin e tij, kur janë kushtet e përcaktuara në nenin 72 të K.Pr.Civile. Ky rregull, që i shërben identifikimit të shkaqeve të papajtueshmërisë, realizohet që në veprime përgatitore, që të mos vonohet procesi.

Akti i ekspertimit duhet të depozitohet nga eksperti në sekretarinë e gjykatës në afatin e caktuar nga gjykata. Palët kanë të drejtë të tërheqin kopje të aktit të paktën 3 ditë para datës së seancës gjyqësore.

Parashikimet e tjera që jep K.Pr.Civile janë të zbatueshme edhe nga gjykata administrative, sa kohë nuk bien ndesh me to. Për ilustrim, kryerja dhe vlerësimi i ekspertimit dhe përsëritja e ekspertimit, sipas neneve 228 dhe 229 të K.Pr.Civile zbatohen edhe në gjykimin administrativ.

⁴⁰ Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, kërkesëpadija quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera. Kundër vendimit të gjyqtarit të vetëm për kthimin e kërkesëpadiës mund të bëhet ankim i veçantë. Kur të metat e kërkesëpadiës janë plotësuar në afatin e caktuar, ajo quhet e regjistruar që nga dita që është regjistruar në gjykatë. Në këtë mënyrë vepron edhe kur të metat e kërkesëpadiës konstatohen gjatë gjykimin të çështjes.

⁴¹ Shih nenin 25, pika 1/c të LGJA

Në Shtojcën e këtij Manuali jepet një model i vendimit për kryerjen e ekspertimit, në pjesën që lidhet me kërkesat e nenit 25, pika 1/c të LGJA.

3.1.5 Deklarata për betimin e ekspertit, jashtë seancës gjyqësore

Ndryshe nga gjykimi civil ku betimi i ekspertit bëhet në proces përpara gjykatës sipas formulës së dhënë nga neni 226 i K.Pr.Civile⁴², në gjykimin e posaçëm administrativ, betimi administrohet në deklaratën personale për dijeninë e ekspertit për përgjegjësinë penale, në rast ekspertimi të rremë, në përmbajtje të së cilës pasqyrohet betimi se do të kryejë mirë e me nder detyrat që i janë besuar, me të vetmin qëllim që t'ia bëjë të ditur gjykatës të vërtetën.

Kjo deklaratë dorëzohet në gjykatë së bashku me aktin e ekspertimit. Forma dhe përmbajtja e deklaratës janë miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 685, datë 20.11.2013 "Për formën dhe përmbajtjen e deklaratës së ekspertit në procesin gjyqësor", botuar në Fletoren Zyrtare. Kjo mënyrë e sigurimit të betimit jashtë procesit gjyqësor, i shërben afateve optimale të ecures së gjykimin administrativ, ku puna e ekspertit fillon e pakushtëzuar me seancën në prani të palëve. Në Aneksin e këtij Manuali, jepet modeli i miratuar i deklaratës së ekspertit, i cili plotësohet në veprimet përgatitore në gjykimin administrativ.

3.1.6 Procesverbali i veprimeve përgatitore

Si rregull, veprimet përgatitore zhvillohen mbi bazë dokumentesh brenda 7 ditëve nga paraqitja e padisë, por gjykata nëse e çmon të arsyeshme zhvillon edhe seancë përgatitore në prani të palëve. Të gjitha këto veprime përgatitore apo seancë përgatitore, ku gjyqtari vendos me vendim të ndërmjetëm, dokumentohen me procesverbalin e veprimeve përgatitore, që përpilohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhen prej tij dhe gjyqtarit kryesues⁴³.

Procesverbali i veprimeve përgatitore, në pjesën hyrëse të tij, mban datën e hartimit, palët në proces dhe të dhënat mbi mosmarrëveshjen (numri dhe data e regjistrimit në regjistër themeltar), objektin dhe bazën ligjore të padisë, ndërsa në pjesën trajtuese të tij, pasqyron të gjitha veprimet që gjykata verifikon dhe vendos të kryejë siç janë:

- » informacionin nëse padia ka të meta;
- » vendimin për t'i njoftuar padinë dhe aktet palës së paditur, të tretit dhe Avokaturës së Shtetit, si dhe afatin në dispozicion të tyre për paraqitjen e prapësimeve dhe akteve;
- » datën e caktimit të seancës, e cila mund të jetë përgatitore apo direkt gjyqësore, duke u shprehur gjyqtari për format e njoftimit (për ilustrim nëse paditësi ka deklaratë për njoftim me telefon gjykata urdhëron kryerjen e njoftimit edhe në këtë mënyrë).

⁴² Gjukata përpara se eksperti të fillojë nga kryerja e detyrës, i kujton atij rëndësinë e funksioneve për të cilat është thirrur për t'i përmbushur dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë mirë e me nder detyrat që i janë besuar, me të vetmin qëllim që t'ia bëjë të ditur gjykatës të vërtetën.

⁴³ Shih nenin 25, pika 2 të LGJA

Procesverbali i seancës përgatitore, i cili mbahet nga gjykata pas kryerjes së veprimeve të para përgatitore, përveç pjesës hyrëse të tij, e cila pasqyron të njëjtat të dhëna si procesverbali i veprimeve përgatitore, në pjesën përshkruese të tij përmban:

- » palët pjesëmarrëse në gjykim, duke pasqyruar praninë ose jo të tyre, përfaqësimin, nëse ka të tillë dhe shkakun e mosparaqitjes nëse subjekti nuk është i pranishëm;
- » pasqyrimin e pretendimeve dhe provave të sjella nga secila palë;
- » nëse ka, pasqyrimin e çështjeve që kanë nevojë të sqarohen midis tyre (pyetje – përgjigje);
- » pasqyrimin e depozitimit të aktit të ekspertimit dhe vënien e tij në dispozicion palëve;
- » disponimin e gjykatës për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke përcaktuar kohën e seancës, njoftimin e anëtarëve të trupit gjykues nëse mosmarrëveshja gjykohet nga tre gjyqtarë, si dhe komunikimit ndaj palëve të pranishme dhe atyre në mungesë nëpërmjet fletëthirrjes, se kanë detyrimin procedural të paraqitjes së provave përpara seancës gjyqësore, në të kundërt ato nuk janë të pranueshme⁴⁴.

Procesverbali i seancës përgatitore në pjesën që pasqyron vendimin e ndërmjetëm të gjykatës për caktimin e seancës dhe njoftimet përkatëse duhet të jetë në harmoni të plotë me veprimet konkrete të realizuara për këto njoftime. Ky procesverbal në praktikë nuk i nënshtrohet rregullave të regjistrimit me mjetet audio, pasi Udhëzimi i Ministrisë të Drejtësisë nr. 353, datë 03.09.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore” përfshin në fushën e zbatimit të tij vetëm procesverbalet e seancës gjyqësore. Nga ana tjetër, duket që një faktor tjetër që ka ndikuar në këtë praktikë gjyqësore është edhe infrastruktura gjyqësore, e cila në gjendjen e tanishme nuk ofron salla të mjaftueshme gjyqësore dhe rrjedhimisht, seancat përgatitore zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, ku sistemi i regjistrimit audio nuk është i instaluar.

SHENBULL: Nëse mosmarrëveshja administrative midis palëve ka lindur nga marrëdhënia e punës, apo nga akti administrativ që vendos detyrim me gjobë, gjykata nëse vlerëson se të dhënat në padi dhe provat shoqëruese sqarojnë mosmarrëveshjen mund të vendosë caktimin direkt të seancës për gjykim, duke pasur mundësi ndërkaq pala e paditur të paraqesë prapësimet dhe provat e saj, të cilat depozitohen në gjykatë. Nëse mosmarrëveshja administrative midis palëve ka lindur nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor apo nga mospërbushja e detyrimeve nga një kontratë prokurimi publik, hetimi gjyqësor i të cilave kërkon akte ekspertimi, gjykata procedon me caktimin e seancës përgatitore duke njoftuar për këtë palët.

3.1.7 Urdhri i gjyqtarit për caktimin e seancës gjyqësore

Ky akt nxirret nga gjyqtari kryesues pasi finalizon veprimet përgatitore, qëllimi i të cilit është

⁴⁴ Sipas përcaktimit në urdhrin e gjykatës për caktimin e seancës të parashikuar në nenin 27 të LGJA.

urdhërimi i njoftimeve të nevojshme nga sekretari gjyqësor, për seancën gjyqësore. Nëse gjatë gjyimit administrativ, procedohet me më shumë sesa një seancë përgatitore, urdhri nxirret në të njëjtën datë me seancën e fundit. Në urdhër, sikundër në procesverbalin e veprimeve përgatitore pasqyrohet data e caktimit të seancës gjyqësore, e cila kufizohet brenda 15 ditëve të ardhshme. Meqënëse neni 27 i LGJA shprehet “*Afati për zhvillimin e seancës gjyqësore nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë*”, ky afat konsiderohet si kalendarik, dhe jo sipas ditëve të punës. Ai shtyhet vetëm nëse dita e fundit përkon me ditë pushimi për shkak të fundjavës apo festës zyrtare⁴⁵.

Neni 27, pika 2 e LGJA jep të gjitha elementet që duhet të pasqyrojë urdhri i gjyqtarit për caktimin të seancës gjyqësore, si më poshtë:

1. datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës gjyqësore;
2. palët dhe, sipas rastit, dëshmitarët dhe ekspertët e kërkuar nga palët, që duhet të marrin pjesë në seancë gjyqësore;
3. ekspertët e caktuar nga gjyqtari;
4. njoftimin dhe mënyrën e njoftimit të palëve dhe të personave, që duhet të marrin pjesë në seancë (me fletëthirrje me shërbim rekomandë, me shpallje publike apo edhe me telefon).

Rëndësi paraqet pika 3 e dispozitës së sipërcituar, e cila në fjalinë e parë të saj thotë: “*Njoftimi drejtuar palëve duhet të përmbajë paralajmërimin, që mosparaqitja e provave përpara seancës së parë gjyqësore shkakton mospranimin e tyre...*”. Ky paralajmërim u komunikon palëve sanksionimin e nenit 26, pika 1 të LGJA, fjalia e parë e të cilit përcakton se: “*Paraqitja e provave nga palët bëhet, në çdo rast, përpara seancës së parë gjyqësore*”. Nëse veprimet përgatitore do ta investonin gjykatën në më shumë se një seancë përgatitore, ky njoftim paralajmëruar u komunikohet palëve në çdo fletëthirrje.

Në gjykimin administrativ, paraqitja e provave lejohet deri sa nuk ka filluar gjykimi, me qëllim që palët të njihen reciprokisht me to. Si rregull, palës së paditur i komunikohet padia dhe aktet, dhe prapësimet dhe provat e sjella prej saj në kopje edhe për palën paditëse, i komunikohen kësaj të fundit në seancë përgatitore. Ky rregullim ligjor ka për qëllim ezaurimin e njohjes së palëve me aktet provuese, përpara sesa çështja të kalojë në seancë gjykimi, për të mos krijuar vonesa tek përfundimi i kësaj të fundit.

3.2 Aktet e palëve ndërgjyqëse

Në gjykimin administrativ, krahas akteve që paraqet paditësi, me të cilat vihet në lëvizje gjykimi administrativ, janë edhe një seri aktesh që paraqiten nga palët e tjera ndërgjyqëse, të cilat sigurojnë parimin e kontradiktoritetit në funksion të procesit të rregullt ligjor. Si akte të tilla përmenden:

⁴⁵ Neni 148 i K.Pr.Civile, paragrafi i fundit: “*Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit*”.

(1) Prapësimet e palës së paditur dhe të personit të tretë; (2) Aktet e Avokaturës së Shtetit, që përfshijnë pretendimet me shkrim apo relacionin për mospjesëmarrje në gjykim; (3) Akti i ekspertimit; dhe (4) Provat dhe kushtet e depozitimit të tyre në gjykimin administrativ nga pala e paditur dhe personi i tretë

3.2.1 Prapësimet e palës së paditur dhe të personit të tretë

Pala e paditur në gjykimin administrativ, e cila si rregull është organi publik që ka kryer veprimin/ mosveprimin administrativ që kundërshtohet, detyrohet të depozitojë prapësimet brenda afatit të caktuar në aktin njoftues të padisë dhe akteve të saj shoqëruese. Nëse kjo nuk ndodh në afat, mundësia që prapësimet të depozitohen edhe në seancë ekziston, por paditësi duhet të sqarojë se nuk ka pasur mundësinë të njihet paraprakisht me to. Ky rregull nuk konsiderohet detyrues kur palë e paditur është një person fizik apo juridik.

SHEMBULL: Në mosmarrëveshjet administrative me palë paditëse Prefekti i Qarkut me objekt “anullim⁴⁶ të aktit të marrjes së tokës në pronësi në emër të familjes bujqësore të shtetasit L.N.”, thirren si të paditur anëtarët e familjes bujqësore të cilët kanë përfitur AMTP-në nga Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshat, por cilësinë e të paditurit personat fizikë e marrin nga efektet e ligjit dhe jo nga ushtrimi i veprimtarisë administrative.

Po kështu, në mosmarrëveshjet administrative që kanë lindur nga shkaktimi i dëmit gjatë ushtrimit të marrëdhënies së punës, punëdhënësi organ publik ka të drejtë të padisë punëmarrësin me objekt të padisë “detyrimin për pagimin e dëmit ekonomik të shkaktuar nga shkelja e detyrimeve kontraktore”, siç mund të jetë rasti nga dëmtimi i një pajisje pune, apo shpenzimi në masë karburanti e pajustificuar me dokumente udhëtimi. Në të tilla raste, të paditurit nuk janë organe publike.

3.2.2 Aktet e Avokaturës së Shtetit

Avokatura e Shtetit merr pjesë në gjykimin administrativ, në mbrojtje të interesave financiare të shtetit, sipas situatës së parashikuar nga neni 5, shkronja “b” e ligjit nr. 10 118, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar⁴⁷.

Gjykata administrative e shkallës së parë në veprimet e para përgatitore, urdhëron në bazë të nenit 79/a të K.Pr.Civile komunikimin e akteve të çështjes ndaj avokaturës, sipas organizimit të Avokaturës së Shtetit në nivel vendor.

⁴⁶ Sipas artikullimit në nenin 10, pika 1 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar.

⁴⁷ Avokatura përfaqëson dhe mbron interesat pasurore të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje të veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t’ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës.

SHEMBULL: Në mosmarrëveshjet administrative ku palë e paditur është një organ specifik i administratës publike si Komisioni i Prokurimit Publik, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përgjegjësini e përfaqësimit e ka Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit. Nëse palë e paditur në gjykimin administrativ është një organ publik me kompetenca në fushën fiskale si autoritetet tatimore, doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, përgjegjësini e përfaqësimit e kanë avokatët e shtetit pranë Ministrisë së Financave. Në raste të tjera, kur paditen Ministrinë apo institucionet në varësi të tyre me kompetenca veprimi apo inspektimi në fushën përgjegjëse që mbulon ministria e linjës, avokati i shtetit që përfaqëson çështjen është ai që ka emërimin pranë ministrisë përkatëse. Për ilustrim, avokati i shtetit pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, përfaqëson interesat në mosmarrëveshjet, ku palë e paditur është Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Kur Avokatura e Shtetit ka rol aktiv, ajo depoziton sipas të njëjtave afate me palën e paditur prapësimet dhe provat, ndërsa nuk merr pjesë në çështje të veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Forma e përpilimit të akteve procedurale nga Avokatura e Shtetit ka një specifikë sepse janë të standardizuara për qëllime njehsimi, sipas rregullave të posaçme të miratuara nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit⁴⁸.

SHEMBULL: Avokatura e Shtetit nuk merr pjesë në mosmarrëveshje, të cilat lidhen me pretendime nga marrëdhënet e punës, apo mbi përfitimet nga sigurimet shoqërore. Gjithashtu, avokatura nuk merr pjesë kur interesat pasurore të shtetit (nëpërmjet organit publik të paditur) lidhen me detyrime monetare në vlerë më të ulët sesa 2 milionë lekë.

Në këto raste, Avokati i Shtetit sipas fushës që mbulon, i delegon të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës publike, me akt të posaçëm, i cili depozitohet në gjykatë dhe i transmetohet gjyqtarit që ndjek çështjen. Kur Avokatura e Shtetit delegon të drejtat për përfaqësim dhe mbrojtje, gjykata nuk ka më detyrimin e njoftimit të saj në çështjen objekt gjykimi.

3.2.3 Akti i ekspertimit

Akti i ekspertimit sipas fushës specifike përpilohet nga eksperti i caktuar nga gjykata dhe përbën një nga aktet që administrohen në veprimet përgatitore. Akti përmban përgjigjet e të gjitha detyrave të përcaktuara nga gjykata, shoqërohet nga tabela analitike (p.sh. kur ekspertimi është në fushën e kontabilitetit), apo nga paraqitje grafike (ekspertimi është në fushën e gjeodezisë), si dhe nga foto të marra nga verifikimi në terren, kur ky i fundit kërkohet nga natyra e ekspertimit.

Akti depozitohet brenda afatit të caktuar në gjykatë në aq kopje sa janë edhe palët ndërgjyqëse dhe

⁴⁸ Ligji nr. 10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit” në nenin 6, shkronja “d” i jep Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit kompetencën të miratojë rregulla të posaçme për unifikimin e praktikave të këshillimit, përfaqësimit dhe ndërmjetësimit, të ndjekura nga avokatët e shtetit.

për Avokaturën e Shtetit, si dhe shoqërohet nga fatura tatimore e shitjes që provon shpenzimet e parapaguara nga pala paditëse sipas rregullit të përgjithshëm të nenit 105 të K.Pr.Civile⁴⁹.

Palët kanë të drejtën të njihen me aktin e ekspertimit, duke tërhequr kopje të tij të paktën 3 ditë para datës së seancës gjyqësore, ndërsa debati mbi përmbajtjen e tij bëhet në fazën e hetimit gjyqësor mbi provat, sipas përcaktimeve të dhëna në pikat 4 dhe 5 të LGJA, si më poshtë:



“4. Eksperti i kërkuar nga palët paraqitet në seancë gjyqësore për të shpjeguar me gojë njohuritë e tij të posaçme për natyrën e mosmarrëveshjes. Për marrjen në pyetje të tij zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Civile për dëshmitarët. Vlera provuese e pohimeve të tij është e njëjtë me vlerën e thënieve të dëshmitarit. Ai i përgjigjet pyetjeve të bëra nga palët dhe gjykata. Për të ndihmuar kujtesën, eksperti mund të lexojë dokumentet e hartuara prej tij. Në raste të veçanta dhe të ndërlikuara, gjykata mund të vendosë që eksperti të paraqesë me shkrim shpjegimet e tij brenda 10 ditëve.

5. Eksperti i caktuar nga gjykata paraqitet në gjykim me aktin e përgatitur me shkrim, sipas detyrave të caktuara nga gjyqtari kryesues në veprimet përgatitore. Ai u përgjigjet me gojë pyetjeve të bëra nga palët dhe gjykata”.



LGJA, duke vendosur rregulla procedurale për pyetjen e ekspertëve të palëve në seancë gjyqësore, i barazon ata me pozitën e dëshmitarëve në gjykimin civil dhe shpjegimet e tij kanë të njëjtën vlerë me dëshminë. Nuk përjashtohet mundësia, që eksperti i palëve të ketë përgatitur akte me shkrim paraprakisht seancës gjyqësore, të cilat ai mund t'i lexojë në seancë për të ndihmuar kujtesën e tij. Gjithashtu, është parashikuar se në raste përjashtimore, të cilat janë të veçanta dhe të ndërlikuara, gjykata mund të lejojë që eksperti të paraqesë shpjegimet e tij me shkrim brenda një afati, jo më të gjatë se 10 ditë. E rëndësishme është të kuptohet që në gjykimin administrativ, marrja e kësaj prove nuk përbën akt ekspertimi, por është në fakt një dëshmi ekspertit e paraqitur nga një prej palëve.

Një pozicion tjetër procedural ka eksperti i caktuar nga gjykata, i cili paraqet aktin e përgatitur me shkrim, sipas detyrave të caktuara nga gjyqtari kryesues në veprimet përgatitore. Ai iu përgjigjet me gojë pyetjeve të bëra nga palët dhe gjykata. Si rregull, akti i ekspertimit dhe përgjigjet e dhëna prej ekspertit të gjykatës në seancë duhet të jenë shteruese për faktet e mosmarrëveshjes. Megjithatë, në raste të veçanta dhe të ndërlikuara, mund të kërkohej prej tij kohë për t'iu përgjigjur me shkrim pyetjeve të paraqitura, sidomos nga gjykata. Në këtë rast, do të procedohet me plotësimin e aktit të ekspertimit sipas rregullave të K.Pr.Civile, por duke mbajtur një balancë të përshtatshme edhe me detyrimin për të zbatuar parimin e gjykimit të shpejtë.

⁴⁹ Neni 105 i K.Pr.Civile, fjalia e parë përcakton: “Shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend parapaguhën nga pala që i ka kërkuar në shumën që ka caktuar gjykata”.

3.2.4 Provat e paraqitura nga i padituri dhe personi i tretë

Në gjykimin e posaçëm administrativ, paraqitja e provave kërkohej të bëhet përpara sesa të fillojë hetimi gjyqësor i çështjes. Paditësi prezumohet t'i paraqesë ato menjëherë me paraqitjen e padisë, origjinale apo të njehsuara me to për gjykatën dhe në kopje për palët e tjera⁵⁰, ndërsa pala e paditur duhet t'i paraqesë brenda afatit të caktuar nga gjykata, që është jo më shumë se 10 ditë nga marrja e njoftimit. Nëse nga pala e paditur ky afat nuk respektohet, neni 26, pika 1 e LGJA i jep një mundësi të dytë, të cilën organi publik e kërkon më kërkesë me shkrim të motivuar dhe nëse kjo nuk ndodh, shqyrtimi i çështjes vazhdon vetëm mbi aktet e paraqitura.

Sipas nenit 26, pika 1 fjalia e parë të LGJA, afati limit i paraqitjes së provave është në çdo rast, koha përpara seancës së parë gjyqësore. Nëse çështja hyn në gjykim, ky i fundit nuk shtyhet për paraqitje provash mbi kërkesë të palëve, me përjashtim të situatës kur gjykata vlerëson kryesisht për qëllime të hetimit të plotë e të domosdoshëm të çështjes t'i kerkojë ato sipas nenit 223 të K.Pr. Civile⁵¹.

Provat në gjykimin administrativ nuk janë të limituara në llojin e tyre, të tilla zakonisht janë aktet zyrtare, aktet noteriale, akti i ekspertimit, por mund të merren edhe prova të tjera si dëshmia, fotografitë apo pamjet filmike.

4. Kërkesat procedurale të palëve gjatë seancës gjyqësore

Palët ndërgjyqëse, në përputhje me interesat e tyre kundrejt mosmarrëveshjes, mund të depozitojnë kërkesa të natyrave të ndryshme, si rregull me shkrim, të cilat merren në shqyrtim nga gjykata pavarësisht nga koha e depozitimit të tyre, pra pavarësisht nëse paraqiten nëpërmjet palës/përfaqësuesit të saj në seancë apo depozitohen me shkrim pranë Zyrës së Protokollit të gjykatës nga ku regjistrohen dhe i përcillen gjyqtarit të çështjes për t'u relatuar në seancë. LGJA ka sanksionuar rregullin e zhvillimit të gjykimit në mungesë të palëve, nëpërmjet dy dispozitave të cilat u referohen fazave të ndryshme procedurale, si në veprime përgatitore⁵², si rrjedhojë, për palët në gjykimin e posaçëm administrativ parashikohet që nëse ata nuk paraqiten, seanca të vazhdojë.

Kërkesat procedurale të palëve, pavarësisht nga veçoritë e secilës prej tyre në funksion të natyrës së kërkesës dhe faktit se cilës palë i përket nga pikëpamja formale dhe ajo strukturore kanë disa elemente të përbashkëta dhe të domosdoshme, që formatojnë vullnetin e shprehur të paditësit/paditurit nëpërmjet kërkesës së paraqitur. Konkretisht, kërkesa drejtuar gjykatës në çdo rast

⁵⁰ Përcaktim i nenit 21, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 në lidhje me nenin 156/b të K.Pr.Civile.

⁵¹ Neni 223, paragrafi 1 përcakton: “Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj”.

⁵² Neni 25, pika 3 e LGJA parashikon: “Mosparaqitja e palëve në veprime përgatitore nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit të çështjes, edhe kur ata janë thirrur dhe njoftuar rregullisht, ashtu edhe në seancë gjyqësore. Neni 34, pika 2 e LGJA parashikon: “Mosparaqitja e palëve në seancë nuk shkakton shtyrjen apo pushimin e gjykimit.”

përmban datën dhe cilësinë e saktë të përpiluesit, i cili në rastin kur pala ka përfaqësim, deklarohet si i tillë.

Kur kërkesat parashtrihen nga organet publike, ato mbajnë në pjesën hyrëse të dhënat e institucionit nën stemën e Republikës, dhe përpilues mund të jetë titullari i institucionit, i cili nënshkruan kundrejt vulës dhe akti del me protokoll nga organi publik, apo përfaqësuesi i autorizuar i organit të cilit i është deleguar përfaqësimi i çështjes. Në rastin e fundit, nënshkrimi i tij është element i mjaftueshëm për legjitimitimin e subjektit kërkues.

Një kërkesë procedurale në çdo rast duhet të identifikojë saktë dy elemente të përmbajtjes së saj:

1. objektin e kërkesës nëpërmjet referimit të dispozitës procedurale që e parashikon atë, si dhe
2. shkakun që përlligj paraqitjen e kërkesës sipas referimit në ligj dhe në fakt.

SHEMBULL: Nëse nga paditësi kërkohet shtimi i ndërgjyqësisë, duhet të pasqyrohet saktë subjekti i paditur që kërkohet të thirret në gjykim, si dhe shkakun pse paditësi ka vlerësuar ta kërkojë në momentin procedural konkret, pra, ai detyrohet të justifikojë rrethanat e ndryshuara që imponojnë këtë rregullim të ndërgjyqësisë, në të kundërt kërkesa do të ishte abuzive.

Në parim, kur kërkesa e një natyre të caktuar trajtohet nga gjykata, ajo konsiderohet e shteruar, por asnjë përcaktim të shprehur nuk ka as tek LGJA, as tek K.Pr. Civile për “ndalimin” e subjektit ta përsërisë kërkesën. Disa kërkesa për nga natyra e tyre mund të jenë të përsëritshme për shkak të një gjendje vazhduese në ecuri të procesit, p.sh. kur paditësi kërkon avokatin apo ripërsërit kërkesën për thirrjen në gjykim të personit të tretë të cilin gjykata nuk e ka pranuar. Në të tilla raste, gjykata duhet të shprehet me vendim të ndërmjetëm, i cili pasqyrohet në procesverbalin e seancës dhe vendimi i gjykatës i përgjigjet aktualitetit të kërkesës sipas artikullimit të saj dhe jo në referim të argumentit sipas të cilit, përgjigja refuzuese e mëparshme justifikon qëndrimin e njëjtë edhe në rast përsëritje.

Vlerësimi i çdo kërkesë procedurale jepet nga gjykata, e cila si rregull shprehet menjëherë në seancë dhe në raste të veçanta, kur vlerësohet se ka nevojë për konsultim të ligjit dhe provave, gjykata mund të “përfitojë” një afat maksimal treditor në referim të nenit 183, paragrafi i parë të K.Pr.Civile. Ky i fundit, lidhur me kërkesat e përcaktuara në nenin 180 të tij, në raste të veçanta që paraqesin vështirësi gjykimi, lejon shtyrjen e deklarimit të vendimit deri në 3 ditë. LGJA nuk jep një mundësi të tillë të shprehur në dispozitën që trajton seancën gjyqësore⁵³, por dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e K.Pr.Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Në raportin midis “kohës së shpejtë të gjyimit të pandërprerë” dhe “procesit të rregullt ligjor mbi një hetim të plotë dhe të gjithanshëm”, duhet të prevalojë ky i fundit. Gjithsesi, raste të tilla janë të rralla dhe konsiderohen përjashtimore, nisur edhe nga fakti që një pjesë e mirë

e kërkesave depozitohen me shkrim dhe njihen nga gjykata përpara çastit procedural për relativimin dhe trajtimin e tyre. Kur gjykata shprehet me vendim për kërkesat procedurale të palëve, ajo duhet të shprehet edhe mbi të drejtën e ankimit dhe mënyrën e ushtrimit të tij.

Nëse listohen, kërkesat e mundshme që paraqiten nga palët ndërgjyqëse në gjykimin administrativ klasifikohen në dy grupe. Në grupin e parë përfshihen kërkesat e paditësit, ndërsa në grupin e dytë përfshihen kërkesat e palëve të tjera ndërgjyqëse. Është e pamundur të bëhet një listim shterues i këtyre kërkesave për shkak të specifikave që shfaq çdo rast i veçantë, megjithatë më poshtë listohen aktet më të përdorura në praktikën gjyqësore.

Kështu, paditësi ka të drejtë të paraqesë disa kërkesa në fazën paraprake, siç janë:

1. Kërkesa për ndryshim të objektit të padisë;
2. Kërkesa për rregullim të ndërgjyqësisë;
3. Kërkesa për përjashtim të gjyqtarit apo ekspertit;
4. Kërkesa për përcaktim të kompetencës tokësore.

Nga ana tjetër, paditësi ka të drejtë të paraqesë disa kërkesa në çdo fazë gjykimi, që janë:

1. Kërkesa për shtyrje të gjyimit;
2. Kërkesa për përfaqësim me avokat apo për zëvendësimin e tij;
3. Kërkesa për kalim procedural të palëve;
4. Kërkesa për përjashtim të gjyqtarit apo ekspertit;
5. Kërkesa për nxjerrje të çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor apo të deklarimit të moskompetencës lëndore;
6. Kërkesa për pezullim të gjyimit;
7. Kërkesa për tërheqje të padisë apo për heqje dorë nga e drejta e padisë; dhe
8. Kërkesa për sigurim të padisë.

Palët e tjera ndërgjyqëse, siç janë pala e paditur, personi i tretë dhe avokati i shtetit, kanë të drejtë të paraqesin disa kërkesa në fazën paraprake, siç janë:

1. Kërkesa për mospranimin e padisë;
2. Kërkesa për thirrjen e të tretit;
3. Kërkesa për disponimin mbi kompetencën tokësore të shqyrtimit të çështjes.

Ndërsa, në çdo fazë gjykimi, ato mund të paraqesin:

1. Kërkesa për shtyrje të gjyimit;
2. Kërkesa për përjashtim të gjyqtarit apo ekspertit;
3. Kërkesa për nxjerrje të çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor apo të deklarimit të moskompetencës lëndore;
4. Kërkesa për pezullimin e gjyimit dhe
5. Kërkesa për kalim procedural të palëve.

Në këtë Manual, këto kërkesa trajtohen në elementet kryesore të formës dhe përmbajtjes sipas tipologjisë së secilës prej tyre, pavarësisht se nga cila palë paraqiten, për t'i lehtësuar përdoruesit përpilimin e kërkesës që i nevojitet, në varësi të fazës së gjyqimit të çështjes dhe qëllimit që kërkesa synon të realizojë. Gjithashtu, për secilën prej tyre bëhet një trajtim sintetik i vendimit të gjykatës, e cila disponon për kërkesën në fjalë, për të theksuar argumentimin e ligjshmërisë së secilës prej kërkesave. Lidhur me kërkesat për kompetencat dhe përbërjen e gjykatës, vlejshëm shpjegimet e dhëna në kapitullin I të këtij Manuali "Aktet procedurale në të dyja shkallët e gjyqimit".

4.1 Kërkesa për ndryshimin e objektit të padisë

Kjo kërkesë është ekskluzive e paditësit, me referim të vetëm në ligjin e përgjithshëm procedural civil, nenin 183 të K.Pr.Civile, i cili përcakton shprehimisht në tre paragrafe të tij, si më poshtë:

“

"Paditësi gjatë hetimit gjyqësor ka të drejtë të ndryshojë shkakun ligjor të padisë. Ai pa e ndryshuar shkakun ligjor të saj, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e padisë.

Kur ndryshimet e mësipërme bëhen në mungesën e të paditurit ose të personave të tretë të thirrur në gjykim, duhet t'u komunikohen atyre me shkrim.

Nuk quhet shtesë e objektit të padisë, kërkimi i kamatës ose i të ardhurave të tjera të objektit".

”

Për shkak të specifikës së gjyqimit administrativ, i cili lejohet të zhvillohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, pra, pa i dhënë mundësi palëve të thirren në seancë dëgjimore, në fillim të zbatimit të LGJA me fillimin e veprimtarisë së gjykatave administrative, ka pasur një diskutim juridik mbi çështjen nëse objekti i padisë në gjykimin administrativ mund të ndryshojë. Kjo pasi gjykimi mbi aktet prezumon që paditësi ka qenë i qartë në gamën e kërkimeve që i parashtrohet për zgjidhje gjykatës, pa nevoja të mëtejshme ndryshimi. Praktika gjyqësore prej tashmë 2 vitesh e gjysmë ka konsoliduar qëndrimin se objekti i padisë mund të ndryshojë, duke e përfshirë nenin 185 të K.Pr.Civile ndër dispozitat e zbatueshme të gjyqimit administrativ.

Çështja me interes diskutimi është se në cilin moment paraqitet kërkesa për ndryshim të objektit të padisë. Në interpretim literal, por edhe sistematik të nenit 185 të K.Pr.Civile, është e qartë që në gjykimin e zakonshëm civil kjo kërkesë paraqitet në hetim gjyqësor, pra pasi çështja ka kaluar në gjykim dhe ka filluar seanca gjyqësore, sipas LGJA në veprimet e nenit 34 të tij. Këtë qëndrim ka mbajtur në përgjithësi Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ndaj mund të thuhet se kërkesa për ndryshimin e objektit të padisë, paraqitet si rregull në fazën e kërkesave paraprake, me qëllim saktësimin nga paditësi ndaj subjekteve të tjera në proces të kërkimeve përfundimtare të tij.

Nëse kërkesa për ndryshim të objektit të padisë paraqitet në veprime përgatitore, gjykata ka

detyrimin ta komunikojë atë tek palët në mungesë, të cilat duhet të vihen në dijeni për mundësinë e ndryshimeve në kërkimet e padisë, me qëllim përgatitjen lidhur me kërkimet e shtuara. Gjendja lehtësohet kur paditësi pakëson objektin e padisë fillestare, pasi në çdo rast puna e parapërgatitur nga palët e tjera në gjykim mbetet e vlefshme për pjesën e mbetur të objektit të padisë. Paraqitja e kërkesës për ndryshim të objektit të padisë në veprime përgatitore, kushtëzohet edhe nga një tjetër çështje më rëndësi siç është afati për paraqitjen e padisë. Nëse paditësi do të priste seancën gjyqësore, ai rrezikon të humbasë afatin si kusht formal të paraqitjes së padisë, e cila do t'i kushtonte shtrenjtë nga pikëpamja procedurale.

SHEMBULL: Nëse paditësi është subjekt tregtar tatimpagues pranë DRTTM dhe ndaj tij autoriteti tatimor ka nxjerrë një vlerë detyrimi me të cilin ai nuk është dakord, paditësi pas shterimit të ankimit administrativ ka të drejtën t'i drejtohet gjykatës. Nëse paditësit nuk i është komunikuar në afat vendimi i organit administrativ që shqyrton ankimin (Drejtoria e Apelimit Tatimor), paditësi i drejtohet gjykatës administrative të shkallës së parë me padi me objekt për shfuqizimin e aktit administrativ bazë që i ka vendosur detyrimin, njoftim-vlerësimi i nxjerrë nga DRTTM. Nëse më pas subjekti i komunikohet vendimi i DAT-së për lënien në fuqi të aktit administrativ objekt ankimi dhe të cilin ka logjikë ta kundërshtojë gjyqësisht, duke shtuar objektin e padisë fillestare. Kjo shtesë nuk është e pakufizuar në kohë, por paditësi duhet ta paraqesë në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për vendimin e DAT-së, sipas përcaktimit që jep ligji i posaçëm⁵⁴, që parashikon ankimin gjyqësor, qoftë edhe në fazën e veprimeve përgatitore.

Kërkesat për ndryshimin e objektit të padisë (shtimin ose pakësimin e tij) nëse pranohen nga gjykata, u komunikohen palëve në mungesë, si dhe Avokaturës së Shtetit, duke u bashkëngjitur një kopje të kërkesës së depozituar, për t'i njohur ata me objektin e padisë, me të cilin procedohet në vijim të gjyqimit. Në marrjen e vendimit të ndërmjetëm për disponimin ndaj kësaj kërkesë të paditësit, gjykata duhet të argumentojë pranimin ose jo të saj, duke mbajtur në konsideratë dy kërkesa të ligjit: (1) faktin që disponimi mbi padinë është diskrecion i paditësit, i cili përcakton kufijtë e kërkimit ligjor⁵⁵, si dhe (2) të arsyeve që nuk ndryshon njëkohësisht edhe shkakun ligjor i padisë, e cila do të passillte një padi të re, e në këtë rast nuk ka vend për pranimin e kërkesës. Vendimi i gjykatës për disponimin ndaj kërkesës për ndryshimin e objektit të padisë, është vendim i ndërmjetëm sipas kuptimit që jep neni 125 i K.Pr.Civile⁵⁶ dhe ndaj mospranimit të kërkesës, pala paditëse mund të bëjë ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Në rast pranimi të kërkesës, ankimi mund të bëhet nga palët e tjera në proces së bashku me vendimin përfundimtar.

Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës së paditësit për shtimin e objektit të padisë, pasi kjo e fundit haset më shpesh dhe është më e diskutueshme në praktikë.

⁵⁴ Ligji nr. 9920/2008, neni 109, pika 2: "Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e Drejtorisë së Apelimit Tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim...".

⁵⁵ Neni 5 i K.Pr.Civile: "...Objekti i mosmarrëveshjes mund të ndryshojë sipas kërkesave që lindin gjatë procesit, kur këto të fundit kanë lidhje të mjaftueshme me pretendimet e fillimit".

⁵⁶ Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjyqimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

4.2 Kërkesa për rregullim të ndërgjyqësisë

Kërkesa të tilla (zakonisht për shtim të ndërgjyqësisë), paraqiten në gjykim si nga paditësi ashtu edhe nga organi publik i paditur apo Avokatura e Shtetit, si në fazën e kërkesave paraprake edhe më pas, nëse nga rrethanat e rezultuara të çështjes kërkohet rregullimi i ndërgjyqësisë. Madje kërkesa për thirrjen e një subjekti si të paditur apo në cilësinë e personit të tretë, do të ishte mirë të identifikohet që në seancë përgatitore, për qëllime të ofrimit ndaj personit të tretë të garancive procedurale mbi njoftimin e padisë dhe akteve të saj shoqëruese, me qëllim paraqitjen e prapësimeve dhe provave para fillimit të seancës gjyqësore. Kërkesat procedurale për rregullimin e ndërgjyqësisë janë të natyrave të mëposhtme:

- » Kërkesa për thirrjen në gjykim të subjektit në cilësinë e të paditurit;
- » Kërkesa për thirrjen në gjykim të subjektit në cilësinë e personit të tretë;
- » Kërkesa për kalim procedural të palëve;
- » Kërkesa për daljen jashtë gjykimit të personit të paditur etj.

Paditësi kërkon shtimin e ndërgjyqësisë kur vlerëson se padia duhej t'i kundërdrejtohej edhe një/disë subjekteve të paditur/a, mundësi e cila i njihet nga neni 161/c i K.Pr.Civile, sipas të cilit nëse gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij të fundit, duke e thirrur si të paditur. Kjo kërkesë është e drejtë ekskluzive e palës paditëse, pasi cilësia e të paditurit në gjykim jepet vetëm nga paditësi. Padia e natyrës administrative prezumohet të ketë identifikuar që në fillim subjektet që mbartin cilësinë e të paditurit apo që kanë interes për gjykimin në cilësinë e të tretit, por nuk përjashtohet mundësia që ky saktësim mbi ndërgjyqësinë e duhur të bëhet pas paraqitjes së padisë. Për ilustrim, kur objekt i padisë është shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor dhe detyrimi është solidar⁵⁷, paditësi justifikohet të thërrasë organin tjetër publik, që gjithashtu rezulton solidar. Solidariteti është koncept i lindur nga bashkëpërgjegjësia. Rast tjetër është kur shtohet objekti i padisë me një kërkim të ri, që kundërshton vendimin e organit administrativ që ka shqyrtuar ankimin, ky i fundit pozicionohet në cilësinë e të paditurit nëpërmjet kërkesës për thirrjen e tij si i paditur, p.sh. nëse paditësi kërkon shfuqizimin e vendimit të nxjerrë nga Inspektorati Shtetëror Shëndetsor- Dega Rajonale Tiranë, i cili e ka gjobitur subjektin për lejim të konsumit të duhanit në mjedise të mbyllura në vendbiznesin e tij dhe më pas paditësi shton objektin e padisë me kërkimin për shfuqizim edhe të vendimit të Komisionit të Ankimit pranë ISHSH në Ministrinë e Mjedisit, ky i fundit duhet të thirret në cilësinë e të paditurit.

Rasti i rregullimit të ndërgjyqësisë është i pashmangshme kur diktohet nga rrethanat e lindura gjatë gjykimit, p.sh. nëse një prej palëve, person fizik gjatë gjykimit vdes, duhet të bëhet kalimi procedural tek trashëgimtarët e tij, duke u shtuar ndërgjyqësia (në më të shumtën e rasteve). Në

⁵⁷ Shih nenin 14 të ligjit nr. 8510, datë 15.7.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", i ndryshuar. Kur përgjegjës për shkaktimin e dëmit janë disa organe të administratës shtetërore, secili prej tyre mban përgjegjësi për të gjithë dëmin. Ata përgjigjen kundrejt të dëmtuarit si debitorë solidarë.

këtë rast, kalimi procedural është kërkesë e ligjit procedural sipas parashikimit të tij në nenin 199 të K.Pr.Civile⁵⁸. E njëjta dispozitë zbatohet nëse kalimi procedural prek personin juridik.

SHEMBULL: Nëse mosmarrëveshja administrative ka lindur midis paditësit dhe Komunës Z si e paditur, kjo e fundit ka pushuar së ekzistuari nën efektet e ligjit nr.115/2014 datë 31.7.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Përgjegjësitë e saj i ka trashëguar Bashkia B, pranë së cilës ajo vijon të veprojë si Njësi Administrative. Në këtë rast, kalimi procedural bëhet tek Bashkia B, e cila merr ligjërisht cilësinë e të paditurit dhe pozicionohet proceduralisht si e tillë.

Paraqet rëndësi thirrja e kërkesës së personit të tretë në gjykim, si nga paditësi, ashtu edhe nga pala e paditur organik publik, kur vlerësohet se ndodhemi në kushtet e nenit 192 të K.Pr.Civile. Kjo dispozitë, parashikon në dy paragrafët e parë të saj, si më poshtë:

“

"Secila palë mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes.

Personi i tretë thirret me kërkesë të shkruar që paraqitet në seancën përgatitore ose në sekretarinë gjyqësore kur ka filluar shqyrtimi i padisë. Kërkesa i njoftohet menjëherë gjyqtarit, i cili urdhëron që t'i njoftohet personit të tretë, mundësisht pa shtyrë seancën gjyqësore të caktuar".

”

Nëse në gjykimin administrativ nuk është kërkuar nga asnjë prej palëve thirrja e personit të tretë kur ka të tillë, gjykata ndërhyr kryesisht sipas nenit 193 të K.Pr.Civile⁵⁹ për të garantuar rregullimin e ndërgjyqësisë. Rëndësia e thirrjes së të tretit, evidentohet nga ligji në modalitetet që ai parashikon si: forma shkresore e kërkesës, garancitë procedurale të personit të tretë si palë në gjykim sipas nenit 195⁶⁰, paragrafi i parë K.Pr.Civile, njoftimi i palëve në mungesë duke shtyrë gjykimin, deri tek afati i veçantë i ankimit.

SHEMBULL: Në mosmarrëveshjen administrative të nisur nga operatori ekonomik 'X' sh.p.k., i cili kundërshton vendimin e KPP-së, që ka lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktor (organit publik që zhvillon procedurën e prokurimit publik) për skualifikimin e subjektit 'X' sh.p.k. dhe përzgjedhjen fitues të operatorit ekonomik 'Y' sh.p.k., nëse ky i fundit preket në interesat direkte të tij nga vendimi i gjykatës mbi vendimmarrjen e KPP-së, duhet të thirret në gjykim në cilësinë e personit të tretë, veprim, i cili nëse nuk kërkohet nga palët, realizohet nga gjykata.

⁵⁸ Kur njëra nga palët vdes, çështja vazhdon nga ose kundër trashëgimtarëve të saj. Kur pala që është person juridik mbaron, çështja vazhdon nga ose kundër personit juridik a fizik, të cilit i kanë kaluar të drejtat e detyrimit e personit juridik që ka mbaruar.

⁵⁹ Gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore.

⁶⁰ Personi i tretë ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet procedurale që u lejohen palëve përveç atyre që përbëjnë disponim të objektit të padisë.

Vendimet e gjykatës për kërkesat e rregullimit të ndërgjyqësisë, si rregull janë të natyrës së vendimeve të ndërmjetme, të cilat pasqyrohen në procesverbalin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Ato nuk kanë nevojë të arsyetohen veçmas për shkak se nuk kanë ankim të veçantë, ndaj tyre paraqitet ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Bën përjashtim vendimi që refuzon marrjen pjesë të personit të tretë, për të cilin neni 194, paragr. II i K.Pr.Civile, përcakton ankim të veçantë. Në këtë rast, vendimi arsyetohet me qëllim ushtrimin e ankimit ndaj tij nga palët e interesuara.

Në përfundim, mund të thuhet se vendimet e ndërmjetme të gjykatës për kërkesat mbi rregullimin e ndërgjyqësisë, jepen duke mbajtur në konsideratë dy kërkesa të ligjit: (i) gjendjen e faktit nëpërmjet provave që mbështesin kërkesën; (ii) referimin në dispozitën procedurale që justifikon kërkesën në fjalë.

Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës së paditësit për shtimin e ndërgjyqësisë me një subjekt të paditur.

4.3 Kërkesa për shtyrjen e gjykimit

LGJA nuk trajton në asnjë nga dispozitat e saj procedurale mundësinë e shtyrjes së gjykimit administrativ, kur kjo kërkohet prej palëve për pamundësi të pjesëmarrjes në seancë. Rregulli i vendosur nga LGJA sipas neneve 35, pika 3 dhe 34, pika 2 të tij, thotë se *mosparaqitja e palëve nuk shkakton shtyrjen apo pushimin e gjykimit*. Këto dispozita, nuk thonë asnjë fjalë mbi shkaqet e mosparaqitjes dhe si rrjedhojë as nuk e shtjellojnë situatën kur mosparaqitja e ka një shkak që e vendos subjektin në pozita të pamundësisë së marrjes pjesë në seancë.

K.Pr.Civile parashikon në nenin 179, paragrafi i parë të tij mbi pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve se: *'nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit'*. Nga sa më sipër, nëse një nga palët apo përfaqësuesi paraqet një shkak të justifikuar për mosparaqitjen, seanca mund të shtyhet.

Sipas nenit 1, pika 2 të LGJA, dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, përveçse kur bien ndesh me të. Gjykimi i posaçëm administrativ, për shkak të parimit se gjykohet mbi aktet është harmonizuar me një tërësi dispozitash, të cilat nuk e kanë 'planifikuar' shtyrjen e gjykimit nëse palët nuk paraqiten, qoftë edhe kur parashtrojnë shkakun justifikues me kërkesë me shkrim. Kërkesat e palëve për shtyrjen e gjykimit administrativ si rregull nuk duhet të pranohen dhe përgjithësisht nuk pranohen, pasi palët kanë detyrimin për t'i parashtruar gjykatës pretendimet me shkrim ku të pasqyrojnë çdo argument që do të relatohej me shpjegime me gojë, sikundër edhe të gjitha provat që i shërbejnë hetimit gjyqësor të çështjes.

Nga ana tjetër, kur gjykata shqyrton çështjen gojarisht në seancë gjyqësore me njoftimin dhe

praninë e palëve, këto të fundit kanë të drejtë të marrin pjesë në gjykim, duke ushtruar të drejtat procedurale në përmbushje të procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 6 të KEDNj dhe nenit 42, pika 2 të Kushtetutës⁶¹. Pikërisht në respektim të rregullsisë së procesit ligjor, gjykata duhet të tregojë vëmendje mbi zhvillimin apo jo të gjykimit në mungesë të palës paditëse, kur kjo e fundit kërkon shtyrjen e gjykimit.

Pavarësisht nga shumëllojshmëria e shkaqeve të servirura nga paditësi para gjykatës për shtyrje të seancës (mungesa e avokatit, mungesa e paraqitjes së provave nga organi publik i paditur, nevoja për të paraqitur kërkesa në funksion të gjykimit, nevoja për konsultim etj.), janë vetëm disa raste ato të cilat, për të garantuar një proces të rregullt, mund të tolerohen jo më shumë sesa një herë me shtyrjen e gjykimit për palën paditëse.

KONKRETISHT, paditësi sipas neneve 96/a dhe 97 të K.Pr.Civile ka të drejtën e përfaqësimit me avokat, dhe nëse paditësi paraqitet në seancë por avokati nuk e ka shoqëruar, kur gjykata krijon bindje se ai nuk është në gjendje të mbrojë vetë interesat e tij të ligjshme, vendimi për të shtyrë seancën për t'i dhënë mundësi të mbrohet nga avokati është i arsyeshëm, por gjykata në marrjen e këtij vendimi duhet të arsyetojë: (1) pamundësinë e paditësit për t'u mbrojtur vetë; (2) faktin që mosparaqitja e mbrojtësit nuk ka ndodhur për fajin e paditësit; (3) faktin që kjo mundësi në kohë nuk jepet e përsëritur, pasi paditësi ka mundësinë në vijim të sigurojë një tjetër avokat nëse ai i caktuar tashmë nuk i përgjigjet angazhimit në përfaqësim.

Në një tjetër shembull, nëse avokati me prokurë provon në seancë se akti i përfaqësimit i është lëshuar datën e seancës, ai provohet të jetë në pamundësi praktike për t'u njohur me çështjen në nivel të mbrojtjes së saj. Të tilla kërkesa në seancë mjaftohen të paraqiten edhe verbalisht dhe regjistrohen si të tilla në procesverbalin e seancës. Kur pala nuk është e pranishme kërkesa depozitohet me shkrim dhe gjykata disponon ndaj saj me vendim të ndërmjetëm, i ankimeshëm së bashku me vendimin përfundimtar.

Nëse kërkesa bëhet nga organi publik i paditur, mundësitë e pranimit të saj janë më të pakta për këto shkaqe: (1) në cilësinë e autoritetit publik dhe nivelit të organizimit, nëse përfaqësuesi i auorizuar mungon p.sh. se ka marrë lejen vjetore, mundësia e përfaqësimit është e realizueshme nëpërmjet një përfaqësuesi tjetër nga sektori juridik, apo sektori që mbulon fushën përkatëse ku ka lindur mosmarrëveshja; (2) pala e paditur ka pasur detyrimin për të paraqitur brenda 10 ditëve pas njoftimit me padinë dhe aktet, prapësimet me shkrim dhe provat mbi ligjshmërinë e veprimit/mosveprimit administrativ të kundërshtuar.

Në çdo rast të paraqitjes së saj nga palët, kërkesa për shtyrje të gjykimit, duhet të referojë shkakun pse kërkohet shtyrje dhe të bashkëngjisë patjetër *dokumentin provues* që justifikon shkakun. Në të kundërt, ajo mbetet në nivel pretendimi dhe gjykata disponon me mospranimin e saj. Kërkesa për

⁶¹ Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

shtyrje të gjykimit është parimisht e pranueshme si në seancë përgatitore, ashtu edhe në seancë gjyqësore, për sa nuk është mbyllur hetimi gjyqësor i çështjes.

Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës së paditësit për shtyrjen e seancës gjyqësore.

4.4 Kërkesa për përfaqësim me avokat apo për zëvendësimin e tij

Kërkesa për përfaqësim me avokat i përket paditësit (në raste të veçanta dhe jo të shpeshta organet publike kontraktjnë avokatë për përfaqësim në gjykim) dhe deklarohet para gjykatës, si rregull në seancën e parë të paraqitjes (përgatitore apo gjyqësore)⁶². Ajo iu referohet rasteve kur paditësi ka zgjedhur avokat, por nuk ka bërë prokurë para noterit për të pakësuar shpenzimet gjyqësore, ndaj tagrin e përfaqësimit ia jep me deklaram verbal para gjykatës. Kërkesa për avokat nuk shoqërohet me akt shkresor dhe bëhet edhe nëse avokati i deleguar në përgjegjësi përfaqësimi nuk është i pranishëm, si dhe pasqyrohet në procesverbalin e seancës, së bashku me vendimin e ndërmjetëm të gjykatës për pranimin e saj.

Paraqet rëndësi për këtë Manual, përcaktimi i saktë i tagrave të përfaqësimit që i jepen avokatit në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, arsye pse paditësi duhet të shprehet (verbalisht) dhe gjykata duhet të vendosë lejimin e përfaqësimit lidhur me:

1. përfaqësimin nga një apo më shumë avokatë dhe nëse janë disa të tillë, nëse autorizohen ta përfaqësojnë paditësin edhe veçmas;
2. përfaqësimin edhe në mungesë të vetë paditësit, apo gjithnjë në prani të tij;
3. përfaqësimin në proceset e të gjitha shkallëve të gjykimit;
4. përfaqësimin me të gjitha të drejtat procedurale që disponon vetë paditësi, edhe për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes apo nga e drejta e padisë.

Në të njëjtën mënyrë kur paditësi ndërpret raportet e përfaqësimit me avokatin e caktuar para gjykatës, ai mund të zgjedhë një avokat tjetër, paraprirë nga detyrimi për revokimin e prokurës verbale të bërë para gjykatës, me qëllim raportimin e saj në procesverbal.

Kur marrëdhënia e përfaqësimit ka përfunduar për shkak të heqjes dorë nga çështja të avokatit, gjykata mban në konsideratë përcaktimin e nenit 98 të K.Pr.Civile, sipas të cilit kur përfaqësuesi heq dorë nga prokura (veprim juridik i njëanshëm), efektet fillojnë me zëvendësimin e përfaqësuesit, me qëllim që i përfaqësuar (paditësi) të mos mbetet pa mbrojtje ligjore.

62 Neni 96, paragrafi i fundit i K.Pr.Civile parashikon: "Prokura mund të jetë e përgjithshme ose e posaçme. Ajo bëhet me shkrim sipas dispozitave të Kodit Civil si dhe me gojë përpara gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen".

4.5 Kërkesa për mospranimin e padisë

Sipas LGJA, padia që të pranohet për shqyrtim, duhet të plotësojë në mënyrë kumulative disa kushte formale të saj, mosrespektimi i të cilave passjell vendimin e gjykatës për mospranimin e padisë. Këto kushte parashikohen nga nenet 16 deri 18 të LGJA dhe kanë të bëjnë me respektimin e dispozitave mbi: (1) shterimin e ankimit administrativ; (2) objektin e padisë sipas kërtimeve të natyrës administrative të listuara në nenin 17 të LGJA; (3) respektimin e afatit të paraqitjes së padisë, sipas përcaktimeve të nenit 18 të LGJA.

Të gjitha kushtet e mësipërme ligjore, parashikohen në kreun IV të ligjit nr. 49/2012 dhe sipas nenit 39, pika 2 të ligjit, gjykata vendos mospranimin e padisë, kur padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Në kuptim të rëndësisë që prezanton secili prej tyre, është e qartë që mjafton të mos jetë respektuar një prej kushteve dhe disponimi i gjykatës për mospranim padie është pasojë direkte nga ligji.

Kërkesa për mospranimin e padisë paraqitet nga pala e paditur organ publik apo Avokatura e Shtetit, në fazën e veprimeve përgatitore, si dhe deri sa nuk është dhënë vendimi i ndërmjetëm për shqyrtimin e provave në seancë gjyqësore. Kërkesa depozitohet me shkrim dhe pala paditëse ka të drejtën e replikës ndaj saj, sikundër edhe të drejtën e paraqitjes së provave për të kundërtën e sa pretendohet. Mos shterimi i ankimit administrativ apo afati i vonuar i paraqitjes së padisë janë çështje fakti, por gjykata duhet të kryejë verifikimin e nevojshëm për të arritur në përfundimin se kushtet formale janë cenuar. Kjo ndodh duke kryer gjykata: (1) *analizë të ligjit të zbatueshëm*, p.sh. mundet që ligji specifik që prek mosmarrëveshjen të lejojë ankimin drejtpërdrejt në gjykatë, që përcaktohet nga neni 16, pika 2/b e LGJA; (3) *analizë të rrethanave të çështjes mbi baza provash*, psh nëse pala e paditur efektivisht ia ka komunikuar aktin objekt gjykimi paditësit me vonesë dhe llogaritja e afatit të ankimit në gjykatë fillon pikërisht nga koha e komunikimit të veprimit administrativ të kundërshtueshëm.

SHEMBULL: Ligji nr.108/2014 "Për policinë e Shtetit", parashikon në pikën 5 të tij, ndër të tjera, se punonjësi i policisë, i cili lirohet nga detyra, ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelit ose drejtpërdrejt në gjykatë. Në këtë rast, nëse punonjësi i policisë i drejtohet gjykatës pa u ankuar më parë në Komision, shterimi i ankimit administrativ nuk është kusht i cenuar, pasi vetë LGJA parashikon në nenin 16, pika 2/b të tij se rregulli mbi shterimin e ankimit administrativ nuk zbatohet kur ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë.

Vlen të theksohet se gjykata ka detyrimin të verifikojë edhe kryesisht kushtet e paraqitjes së padisë. Në përfundim, kur subjekti paditës nuk ka respektuar një nga kushtet formale të padisë, gjykata nuk merr çështjen në shqyrtim mbi themelin e saj, por disponon me mospranim të padisë, për shkak se vetë ligji autorizon situatën e privimit të subjektit për akses në gjykatë.

Mospranimi i padisë si formë disponimi gjyqësor është risi në gjykimin administrativ dhe përfshihet në vendimet e natyrës jopërfundimtar. Qëllimi i këtij parashikimi është të mos lejojë shqyrtimin në themel të atyre mosmarrëveshjeve për të cilat padia ka rënë në prekluzivitet, apo nuk është trajtuar më parë në rrugë administrative kur ligji e kërkon shprehimisht, si dhe është koncept i të drejtës procedurale, i pavarur nga e drejta materiale e pretenduar në padi.

Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës së palës së paditur për mospranimin e padisë, sipas elementeve të nevojshëm për t'u trajtuar në përmbajtje të tipologjisë së kërkesës.

4.6 Kërkesa për pezullimin e gjyimit

Pezullimi i gjyimit të mosmarrëveshjeve administrative nuk gjen asnjë parashikim në LGJA, fakt që në parim nuk i pengon palët ta kërkojnë atë, duke zbatuar dispozitat e K.Pr.Civile. Sipas nenit 297 të këtij Kodi, pezullimi i gjyimit i referohet një liste shteruese rrethanash që passjellin pezullimin e gjyimit, siç janë:

1. çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative;
2. kërkohet nga të dyja palët;
3. njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik;
4. njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t'i caktohet një përfaqësues ligjor;
5. parashikohet shprehimisht në ligj.

Kjo e fundit gjen trajtim në LGJA, i cili parashikon se gjykimi pezullohet në rastin kur kërkohet nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes dhe mbi vendimin e gjykatës për mospranimin e kërkesës, ushtrohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Lartë⁶³.

Në varësi të shkakut të pezullimit, kërkesa mund të paraqitet në çdo fazë gjykimi dhe nga të gjithë palët ndërgjyqëse. Kërkesa depozitohet me shkrim dhe duhet të shoqërohet nga akti provues për shkakun e pezullimit të gjyimit, vlerësimi i të cilit i takon gjykatës. Në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, paraqet rëndësi diskutimi i situatës së pezullimit të gjyimit sipas shkronjës "a" të nenit 297 të K.Pr.Civile. Gjykata administrative sipas nenit 37, pika 1 të LGJA shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ. Në këtë kuptim nëse rrethana që përbën shkak për pezullim ka lindur pas veprimit administrativ, kërkesa për pezullim gjendet e pabazuar.

SHEMBULL: Shtetasi X ka paditur DRSSH Tiranë me objekt të padisë së tij shfuqizimin e vendimit për refuzimin e lidhjes së pensionit, për shkak se nuk i është njohur një periudhë vjetërsie në punë pranë N.B. Maliq në vitet 1980 – 1987. Paditësi, me arsyetimin se pasi i është drejtuar gjykatës administrative, ka paraqitur një tjetër padi me objekt vërtetimi fakti juridik i të qenit të marrëdhënie pune pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, paraqet kërkesën për pezullimin e gjyimit, sipas situatës së nenit 297/a të K.Pr.Civile, se çështja administrative nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet çështja tjetër civile. Në këtë rast, gjykata nuk mund të pezullojë gjykimin, sa kohë ajo verifikon ligjshmërinë e vendimit të DRSSH-së në fakt dhe ligj, në kohën e nxjerrjes së tij, kohë kur vendimi për vërtetimin juridik të faktit nuk kish dalë dhe në pasojë organi publik i paditur, nuk kish se si ta merrte në konsideratë.

Vendimi për pezullimin e gjyimit nëse pranohet nga gjykata, arsyetohet dhe ka ankimi të veçantë pranë gjykatës administrative të apelit, por nëse lihet në fuqi apo ndaj tij nuk bëhet ankimi e pezullon gjykimin derisa të bjerë vetë shkak për pezullues. Vendimi i pezullimit të gjyimit nuk mund të rivlerësohet nga gjyqtari që e ka dhënë, përveçse kur shkak i pezullimit ka rënë, apo kur paditësi kërkon pushimin e gjyimit të padisë. Nëse kjo ndodh, kërkesa për pushim mbizotëron ndaj gjendjes së pezulluar.

Kur gjykimi është i pezulluar, gjykata nuk kryen veprime procedurale dhe nuk cakton seanca, por mund të njoftojë palët për tu informuar mbi pengesat që shkaktuan pezullimin. Palët ndërgjyqëse kanë detyrimin t'i bëjnë me dije gjykatës nëse shkak i pezullimit ka rënë.

Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës së palës paditëse për pezullimin e gjyimit, sipas elementeve të nevojshëm për t'u trajtuar në përmbajtje të natyrës së kërkesës.

4.7 Kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi apo nga e drejta e padisë

Paraqitja e aktit të padisë dhe ushtrimi i së drejtës së padisë janë tagra të paditësit, i cili ka të drejtë në çdo kohë të tërhiqet nga padia e ngritur në formën e: (1) heqjes dorë nga gjykimi i padisë me pasojë pushimin e gjyimit; dhe (2) heqjes dorë nga e drejta e padisë me pasojë rrëzimin e padisë.

Në kërkesa të kësaj natyre paditësi mjaftohet me shprehjen e kërkimit dhe nuk ka nevojë ta arsyetojë atë dhe as të japë shkaqe bindëse pse ka vendosur të heqë dorë.

Kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi i padisë parashikohet si në nenin 201 të K.Pr.Civile paragrafi i parë i të cilit, përcakton se paditësi në çdo fazë të gjyimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë, me pasojë disponimin nga gjykata për pushimin e gjyimit, ashtu edhe nga LGJA, i cili në nenin 39 të tij, ku trajton vendimet jopërfundimtare, pika 3, përcakton se gjykata vendos pushimin e gjyimit, kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë. Kjo dispozitë e fundit është në sinkron me nenin 201, paragrafi i parë dhe 299, shkronja "b" të K.Pr.Civile dhe në themel të saj qëndron vullneti i subjektit i shprehur i qartë para gjykatës që gjykimi të mos vazhdojë.

⁶³ Neni 9, pika 2, paragrafi i dytë i LGJA parashikon se: "Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin".

Kërkesa për heqje dorë nga e drejta e padisë nuk trajtohet nga LGJA, por referimi bëhet në nenin 201 të K.Pr.Civile, paragrafi i dytë i të cilit parashikon se: “Paditësi në çdo fazë të gjyqimit mund të heqë dorë krejtësisht ose pjesërisht nga e drejta e padisë. Në këtë rast padia rrëzohet dhe paditësi nuk ka të drejtë të ngrejë përsëri po këtë padi.”

Ndërsa kërkesa për pushimin e gjyqimit në parim nuk i heq subjektit mundësinë ta riparaqesë atë duke respektuar afatin ligjor, kërkesa për heqjen dorë nga e drejta e padisë i jep fund mosmarrëveshjes (mbi vullnetin e paditësit), pasi padia rrëzohet duke marrë efektet e *res judicata*.

Kërkesat e paditësit mbi heqjen dorë nga gjykimi i padisë apo e drejta e padisë, nuk shtrohen për objekt diskutimi nga palët e tjera, ato janë disponim vetëm i paditësit dhe kur ky i fundit çmon se nuk do të referojë shkaqet që kanë ndikuar në të, vendimi i gjykatës është deklarativ, pasi asnjë verifikim i ligjshmërisë së shkaqeve pas veprimit të heqjes dorë nuk kërkohet të bëhet. E vetmja situatë për të cilën gjykata duhet të tregojë vëmendje në të tilla raste është ajo kur paditësi ka lëshuar prokurë dhe kërkesat për heqjen dorë nga gjykimi i padisë /e drejta e padisë depozitohen nga përfaqësuesi. Ky i fundit nuk mund të kryejë akte që sjellin disponim të së drejtës, përveç rasteve kur ka fituar tagër në mënyrë të shprehur⁶⁴. Gjykata duhet të verifikojë nëse në aktin e përfaqësimit përfaqësuesit i është deleguar apo jo një e drejtë e tillë nga i përfaqësuari.

Kërkesat e paditësit mbi heqjen dorë nga gjykimi i padisë apo e drejta e padisë, mund të paraqiten në çdo fazë të gjyqimit, pra, edhe në seancën e parashtrimeve përfundimtare. Kërkesa për heqje dorë dokumentohet me shkrim kur pala zgjedh të mos paraqitet në gjykatë, por forma shkresore nuk është kusht për vlefshmërinë e kërkesës, e cila mund të deklarohet verbalisht dhe të pasqyrohet në procesverbal. Në këto raste është e rëndësishme që vullneti të shprehet i qartë dhe parashtrimi i kërkesës të jetë i qartë, pasi menjëherë pas saj gjykata merr vendim.

Në ecure të kësaj trajtese duhet të sqarohet se duke qenë deklarim vullneti kërkesa është e revokueshme, për sa kohë nuk është marrë në shqyrtim nga gjykata.

SHENBULL: Paditësi L.H. ka paditur në gjykatë DRSSH Tiranë, me objekt të padisë shfuqizimin e urdhrit të nxjerrë prej këtij organi për mbylljen e përfitimit të veçantë si minator nëntoke. Një ditë përpara seancës së komunikuar palëve, paditësi depoziton kërkesën me shkrim për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, e cila pasi protokollohet i kalon për veprime gjyqtarit. Në seancën e planifikuar paditësi është i pranishëm dhe pas relativitetit nga gjykata të kërkesës së tij për heqje dorë nga gjykimi i padisë, ai shprehet se heq dorë nga kërkesa e paraqitur. Në këtë rast, gjykata vijon me gjykimin e çështjes, pas marrjes së deklarimit të paditësit.

Kur pala paditëse heq dorë nga gjykimi i padisë apo e drejta e padisë, shpenzimet gjyqësore të kryera për llogari të gjyqimit të çështjes, i mbeten në ngarkim atij⁶⁵.

64 Neni 97 i K.Pr.Civile

65 Neni 106 i K.Pr.Civile

Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës së paditësit për heqje dorë nga gjykimi i padisë.

4.8 Kërkesa për sigurimin e padisë

Kërkesa për sigurimin e padisë i përket pa diskutim palës paditëse dhe është një nga kërkesat me të rëndësishme të natyrës procedurale. Qëllimi i sigurimit të padisë në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, të cilat lidhen me pretendime mbi paligjshmërinë e veprimit administrativ të kryer nga organi publik, është parandalimi i dëmit që mund t'i vijë paditësit nga ekzekutimi i veprimit administrativ.

Sipas rregullave të vendosura nga K.Pr.Administrative, ankimi administrativ ndaj aktit pezullon zbatimin e tij⁶⁶, ndërsa ankimi gjyqësor ndaj vendimit të organit që ka shqyrtuar ankimin administrativ nuk pezullon zbatimin e tij. Po kështu, ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 24, pika 1 e tij, parashikon se vendimi për kundërvajtjen administrative bëhet titull ekzekutiv në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga organi administrativ që ka kompetencën për shqyrtimin përfundimtar të kundërvajtjes në rrugë administrative. Për të mbrojtur interesat pasurore të subjekteve nga arbitrariteti i organeve të administratës publike nëpërmjet ekzekutimeve të akteve të nxjerra në kuadër të veprimtarisë së tyre, LGJA i njeh gjykatës administrative mundësinë e marrjes së masave të sigurimit të padisë, të cilat janë në dy lloje kryesore: (1) pezullimi i zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ; (2) marrja edhe të masave të tjera të përshtatshme, nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme⁶⁷.

Për justifikimin e kësaj kërkesë, paditësi duhet të tregojë se ekziston mundësia e një dëmi të rëndë e të riparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ përgjatë kohës që zhvillohet procesi gjyqësor. Ky rregull është zbatim i parimit *fumus boni juris*, që kërkon të prezumohet baza ligjore e mjaftueshme. Mbi paditësin rëndon detyrimi që të paraqesë disa të dhëna në gjykatë që veprimtaria administrative, që ai kundërshton mund të jetë e paligjshme sepse sigurimi i padisë nuk duhet të shndërrohet në një bllokues të veprimtarisë administrative.

Përpara hyrjes në fuqi të LGJA, pezullimi i zbatimit të aktit administrativ parashikohej në nenin 329 të K.Pr.Civile⁶⁸, dispozitë e cila me vendimin unifikues nr. 10, datë 24.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, u interpretua sikur nuk duhej konsideruar si një masë e përkohshme për sigurimin e padisë në kuptim të nenit 206, shkronja “b”, të K.Pr.Civile⁶⁹. Dispozitat e LGJA

66 Neni 133 i K.Pr.Administrative

67 Neni 30 i LGJA

68 Paditësi mund t'i kërkojë gjykatës edhe pezullimin e zbatimit të aktit administrativ. Gjykata mund të lejojë pezullimin kur ekziston rreziku i shkakimit të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për paditësin. Në të gjitha rastet gjykata duhet të arsyetojë vendimin e saj.

69 Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur: ...b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

treguan se pezullimi i zbatimit të aktit administrativ si një ndër veprimet administrative është masë tipike e sigurimit të padisë.

» **Kushtet ligjore për sigurimin e padisë**

Masa e sigurimit të padisë kërkon përmbushjen e disa kushteve ligjore, të cilat janë kumulative, pra duhet të përmbushen njëkohësisht për t'u pranuar sigurimi i padisë. Sipas nenit 29 të LGJA, sigurimi i padisë vendoset nëse: *a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin;* *b) nuk cenohet rëndë interesi publik.* Cenimi i interesit publik është kusht pengues për marrjen e masës së sigurimit të padisë, nën arsyetimin se interesi publik prevalon mbi atë privat, qoftë edhe nëse ky i fundit rrezikon të cenohet rëndë.

SHEMBULL: Nëse ndaj një shtetasi ka dalë vendim nga struktura përgjegjëse për prishjen e objektit i cili është përfshirë në procedurë shpronësimi për ndërtim rruge, kërkesa e këtij shtetasi për pezullimin e zbatimit të aktit të prishjes nuk mund të pranohet, pasi do të cenonte interesin publik nga investimi në infrastrukturë rrugore.

» **Tiparet e dëmit që dyshohet të shkaktohet nga ekzekutimi i veprimit administrativ**

Çdo akt administrativ që vendos detyrime apo dënime administrative, në parim shkakton dëm në pasurinë e subjektit të cilit i kundërdrejtohet, por sigurimi i padisë që kundërshton veprimin administrativ, nuk lejohet për çdo akt që nxirret nga organet publike.

Sipas nenit 29 të LGJA, padia sigurohet duke u pezulluar ekzekutimi i aktit administrativ, kur nga ky i fundit dëmi që dyshohet të shkaktohet do të jetë i *pakthyeshëm* (referuar natyrës së objektit material që preket) i *rëndë* (referuar efekteve financiare) dhe i *atëçastshëm* (referuar veprimeve të ngutshme të demonstruara nga organi publik për ekzekutimin e tij).

SHEMBULL: Pezullimi i zbatimit të aktit administrativ nuk pranohet nga gjykata kur: shtetasi Y.J. është dënuar me gjobë nga Agjencia e Prokurimit Publik në vlerën 1.000.000 lekë për shkelje të LPP⁷⁰ në procedurat e prokurimit të monitoruara, nëse nuk provohet se pala e paditur ka treguar me veprime konkrete vënien në ekzekutim të vendimit të dënimit me gjobë (mungesa e atëçastshmërisë së dëmit).

» **Koha e paraqitjes së kërkesës së sigurimit të padisë**

Kërkesa për sigurimin e padisë paraqitet si rregull së bashku me padinë në funksion të së cilës kërkohet, por për shkak të rrethanave të çështjes dhe ngutshmërisë së trajtimit të saj nga gjykata, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia. Si pjesë e aktit të padisë, ajo përcaktohet si një ndër kërkimet e paditësit në objektin e padisë, dhe trajtohet në një pjesë të veçantë të përmbajtjes së padisë. Si kërkesë e veçantë ajo përmban elementet e kërkesës

së thjeshtë, ku thirrja e organit publik nuk është e domosdoshme dhe në të cilën argumentohen faktet për mundësinë e shkakimit të dëmit, kushtet e ligjit për sigurimin e padisë dhe zbatimi i tyre mbi faktet konkrete.

» **Koha e shqyrtimit të kërkesës së sigurimit të padisë**

LGJA përcakton si rregull se kërkesa për sigurimin e padisë duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Afati është i prerë dhe lidhet me rëndësinë e pronocimit të gjykatës përpara sesa organi publik të kryejë veprime ekzekutuese. Në praktikë situata nuk prezantohet gjithnjë e lehtë, pasi kërkesa mund të depozitohet në gjykatë ditën e premte, dhe t'i kalojë gjyqtarit për veprim ditën e hënë, duke i lënë këtij të fundit si afat maksimal disponimi me vendim ditën e mërkurë, afat i cili nuk mjafton për njoftimin e palëve. Ky problem e ka zgjidhjen në ligj, pasi neni 28 i LGJA parashikon se kërkesa shqyrtohet në prani të palëve si rregull, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët. Nëse gjykata merr vendim që në veprimet e para përgatitore, pa njoftuar palët, vendimi është proceduralisht brenda standardit ligjor.

» **Vendimi gjyqësor për pranimin e sigurimit të padisë**

Me anë të këtij vendimi, gjykata mund të vendosë disa lloje masash për sigurimin e padisë (neni 30), ku masa më e zakonshme është pezullimi i zbatimit të aktit administrativ, i kontratës administrative apo i veprimit tjetër administrativ. Ligji ka lënë të hapur edhe marrjen e masave të tjera të përshtatshme nga gjykata në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme. Në këtë rast, gjykata cakton masën plotësuese, duke arsyetuar dy çështje në lidhje me të: (1) pse ajo është e përshtatshme në rastin konkret; dhe (2) pse vetëm pezullimi i zbatimit nuk ofron mbrojtjen e mjaftueshme.

Vendimi i sigurimit të padisë është i ekzekutueshëm menjëherë, por, si çdo vendim tjetër me natyrë procedurale nuk merr formë të prerë nga substanca e tij, pra nuk është përfundimtar. Ai nuk merr formë të prerë sepse lidhet ngushtësisht me rrethanat e çështjes, që mund të ndryshojnë. Për këtë shkak, ai mund të revokohet ose të ndryshojë me zhdukjen apo ndryshimin e rrethanave, në të cilat sigurimi i padisë u vendos⁷¹. Revokimi ose ndryshimi i sigurimit të padisë bëhet me kërkesë të palëve, por edhe kryesisht nga gjykata. Mund të ndodhë që gjykatës t'i paraqitet një kërkesë e tillë, por rrethanat nuk kanë ndryshuar. Gjithashtu, mund të ndodhë që gjykatës t'i paraqitet e njëjta kërkesë për të njëjtin shkak dhe bazuar në të njëjtat rrethana, për të cilën ajo ka vendosur refuzimin e saj. Në të dyja këto raste, jepet vendim për mospranimin e kërkesës.

Nga pikëpamja e formës, vendimi për sigurimin e padisë është i arsyetuar dhe ndaj tij ushtrohet ankimi i veçantë në gjykatën administrative të apelit. Ai është i ekzekutueshëm menjëherë dhe në drejtim të anës formale ka të gjithë elementet e një vendimi përfundimtar, por përmbajtja e tij referon në rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm dhe arsyetimin ligjor, vetëm mbi sa lidhet me kërkesën për sigurimin e padisë dhe jo me zgjidhjen e mosmarrëveshjes në kuadër të të cilës ajo kërkohet. Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit

gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Pranimi i sigurimit të padisë është vendim me përgjegjësi të madhe për shkak se: (1) përbën titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510 të K.Pr. Civile dhe efektet e tij janë të menjëhershme (2) efektet vazhdojnë edhe nëse vendimi revokohet dhe ndaj këtij të fundit bëhet ankim.

Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës së paditësit për sigurimin e padisë.

5. Aktet e gjykatës në seancë gjyqësore

5.1 Procesverbali gjyqësor

Procesverbali i seancës gjyqësore është një akt që dokumenton ecurinë e procesit gjyqësor, që mbahet nga sekretari gjyqësor, nën kujdesin e kryesuesit të seancës. Sekretari gjyqësor ka funksion ndihmës në këtë rast dhe për këtë shkak, neni 77 paragrafi 2 i K.Pr.Civile parashikon se sekretari merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal. Mungesa e procesverbalit gjyqësor⁷² apo mungesa e nënshkrimit të tij sipas ligjit është shkak për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim (neni 54 i LGJA).

LGJA nuk përmban rregulla të posaçme për procesverbalin e seancës gjyqësore në gjykimin administrative. Për pasojë, për këtë akt procedural vlejné rregullat e K.Pr.Civile konform pikës 2 të nenit 1 të LGJA.

Sipas nenit 118 të K.Pr.Civile, procesverbali i seancës gjyqësore mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore. Ky rregull detajohet nga Udhëzimi i Ministrisë të Drejtësisë nr. 353, datë 03.09.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio". Aktualisht, tek të gjitha gjykatat administrative në sallat e gjykimit janë të instaluar sistemet e regjistrimit audio të seancave gjyqësore⁷³, të cilat sigurojnë regjistrimin *verbatim* të të gjithë procesit gjyqësor, që zhvillohet në sallën e gjykimit. Regjistrimi audio fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore. Ai përmban të gjitha komunikimet verbale ndërmjet palëve, të gjitha vendimet verbale dhe urdhrat e gjykatës, si dhe të gjitha kërkesat, deklaratimet dhe pretendimet e palëve. Në përfundim të seancës gjyqësore, shënimet e printuara të nënshkruara nga sekretari gjyqësor, si dhe transkriptet e regjistrimeve (zbardhja), kur ka të tilla, i bashkohen dosjes gjyqësore dhe janë pjesë përbërëse e saj. Kur regjistrimi audio i seancës gjyqësore është i pamundur të realizohet, për shkak të defekteve në pajisje, procesverbali i seancës mbahet në një nga mënyrat e tjera, por në procesverbal shënohet shkak i mbajtjes së procesverbalit në mënyrën tjetër. Regjistrimi

⁷² LGJA në fakt i referohet vetëm mungesës së nënshkrimit të rregullt sipas ligjit të procesverbalit gjyqësor, por është e qartë që kur një procesverbal gjyqësor mungon tërësisht, ai barazohet me procesverbalin e panënshkruar sipas ligjit.

⁷³ Sistemi i regjistrimit audio është tërësia e pajisjeve digjitale dhe e proceseve që mundësojnë regjistrimin audio të seancave gjyqësore, që është i integruar në Sistemin e Menaxhimit të Regjistrimit të Çështjeve gjyqësore. *Shih* nenin 3 të Udhëzimit nr. 353/2013 të Ministrisë të Drejtësisë.

i plotë origjinal ruhet në serverin e gjykatës, deri në përfundim të gjykimit. Kur vendimi për një çështje gjyqësore merr formë të prerë, regjistrimet për çështjen përkatëse arkivohen në serverin qendror të Ministrisë së Drejtësisë. Regjistrimi shkatërrohet në momentin kur shkatërrohet edhe dosja e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.

Problematika aktuale në gjykatat shqiptare lidhet me faktin se jo të gjitha seancat gjyqësore zhvillohen në sallat e gjykimit për shkak të infrastrukturës ekzistuese në gjykata, ku raporti i sallave të gjykimit me gjyqtarët është 1 sallë gjykimi për 2 gjyqtarë, si dhe për shkak të volumit të lartë të çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat administrative. Në këto rrethana, ende ndodh që seancat gjyqësore të zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve. Për përdorimin efektiv të sallave të gjykimit, në gjykatat shqiptare sapo ka filluar të ndërtohen kalendarët elektronikë të planifikimit të gjykimeve në salla me urdhër të kryetarëve të gjykatave, të cilët lejojnë gjyqtarin të verifikojë dhe planifikojë paraprakisht mundësinë e zhvillimit të seancës gjyqësore në sallë gjykimi dhe rrjedhimisht, edhe mbajtjen e procesverbalit përmes sistemit të regjistrimit audio. Në këtë fazë, ende nuk ka rregulla të miratuara për kriteret që duhet të ndjekë një gjyqtar për planifikimin e një seance gjyqësore në sallë gjykimi, në varësi të kompleksitetit të çështjes (numri i palëve, numri i kërtimeve apo numri dhe lloji i provave që duhen marrë), që ka shkaktuar ndjekjen e standardeve jo uniforme prej gjyqtarëve për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio.

Sipas nenit 118 të K.Pr.Civile, nëse nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim. Në këtë rast, procesverbali duhet të tregojë:

1. vendin ku zhvillohet veprimi procedural gjyqësor;
2. kohën e zhvillimit të veprimit procedural gjyqësor;
3. përbërjen e trupit gjykues dhe emrin e sekretarit të gjykatës;
4. gjenealitetet e pjesëmarrësve në gjykim dhe
5. personat e thirrur, që nuk janë paraqitur, si dhe nëse dihet, arsyen e mungesës së tyre.

Procesverbali duhet të përshkruajë veprimet procedurale të kryera gjatë gjykimit dhe të pasqyrojë fjalë për fjalë:

1. të gjitha kërkimet dhe kundërshtimet e palëve dhe të personave të tretë;
2. përmbledhjen e saktë të çdo shpjegimi dhe pretendimi me shkrim të paraqitur nga pala;
3. pyetjet dhe thëniet e personave që marrin pjesë në gjykim, duke përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët;
4. provat e marra, duke përfshirë përmbajtjen e provave me shkresë që janë paraqitur, të shiritave të magnetofonit, diapozitivave e filmave;
5. të gjitha vendimet dhe urdhrat që ka dhënë gjykata gjatë gjykimit dhe
6. të gjitha pretendimet përfundimtare të palëve.

Gjithashtu, në procesverbalin gjyqësor, kur ai nuk mbahet me mjete audio shënohen edhe vërejtjet që palët mund të bëjnë ndaj veprimeve të kryetarit të seancës gjyqësore për drejtimin e seancës⁷⁴. Në këtë rast bëhet fjalë për ato lloj vërejtjesh, të cilat përmbajnë pretendime se palëve po iu kufizohen, ose u shkelen të drejtat e tyre.

Në rastin e regjistrimit audio të seancës gjyqësore, regjistrimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm, siç lexohet nga kryetari i seancës gjyqësore në fillim të seancës:

1. përbërjen e trupit gjykues dhe emrin e sekretarit gjyqësor;
2. gjeneralitetet e palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore;
3. kur është rasti, shkaqet e mungesës së palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore.

Në rast se procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim dhe një nga palët kërkon që pjesë nga thëniet e palës tjetër të përfshihen në procesverbal gjykata duhet ta marrë parasysh këtë kërkesë. Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës dhe përfshihet në dosjen gjyqësore. Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohë sa edhe vetë dosja.

Në vijim, neni 118/1 i K.Pr.Civile rregullon transkriptimin e procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive. Këto regjistrime mund të transkribohen kur kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues apo nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar. Transkriptimi mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta, ose për pjesë të shkëputura prej tyre, sipas kërkesës së personit që kërkon transkriptimin. Transkripti shoqërohet me një indeks, i cili tregon seancat gjyqësore për të cilat është bërë regjistrimi. Transkripti nënshkruhet nga sekretari gjyqësor dhe i bashkëngjitet dosjes gjyqësore pa cenuar vlefshmërinë e procesverbalit të mbajtur.

5.2 Vendimi përfundimtar

Vendimi gjyqësor është akti procedural me të cilin gjykata zgjidh mosmarrëveshjen, bazuar në faktet e gjetura sipas provave të vlefshme të shqyrtuara rregullisht dhe duke zbatuar kuadrin ligjor relevant. Me anë të vendimit, gjykata i jep përgjigje pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, por i jep zgjidhje gjithashtu edhe çështjeve ligjore, të cilat ajo detyrohet kryesisht t'i disponojë. Ky është akti procedural më i rëndësishëm i procesit gjyqësor dhe të gjitha aktet e tjera procedurale ekzistojnë dhe përmbushen në funksion të tij. Kjo lidhje që ekziston mes tyre tregon se përmbushja me të meta e akteve procedurale që paraprijnë vendimin gjyqësor, passjellin defekte të tij gjer në pavlefshmërinë e tij.

Në kohët moderne, në Evropë, krahas rëndësisë që i është dhënë tradicionalisht pavarësisë së gjyqtarit, ka një trysni në rritje për përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes, e cila diskutohet si cilësi e të gjithë sistemit gjyqësor. Arsyetimi i vendimit gjyqësor dhe shpallja publike e tij në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme vlerësohet se ndihmon në rritjen e përgjegjshmërisë dhe të besimit publik tek gjyqësori.

Në Raportin e vet të viteve 2015-2016 të titulluar “Pavarësia dhe Përgjegjshmëria e Gjyqësorit dhe e Prokurorisë”⁷⁵ ENCJ i kushton një pjesë të posaçme cilësisë së gjyqësorit dhe ndër të tjera shprehet:



“Gjykatat dhe gjyqtarët duhet të japin vendime gjyqësore me cilësinë më të lartë të mundshme. Ka tre standarde minimale që janë integrale për çdo vendim. I pari lidhet me atë që vendimi është (subjekt i përjashtimeve të përshtatshme dhe të kufizuara) publik. I dyti lidhet me atë që vendimi duhet të arsyetohet dhe i treti me atë që vendimi duhet të shkruhet në një gjuhë të kuptueshme. Këto standarde minimale reflektohen në faktorët e mëposhtëm, që janë elemente thelbësore të cilësisë së brendshme:

- (1) Të gjitha vendimet gjyqësore duhet të jenë të lehta për t'u kuptuar dhe të shpjeguara në mënyrë të duhur;
- (2) Të gjitha vendimet gjyqësore duhet të shkruhen në gjuhë të kuptueshme;
- (3) Të gjitha vendimet gjyqësore duhet të bazohen në një proces të përshtatshëm provues dhe të mbledhjes së provave;
- (4) Të gjitha vendimet gjyqësore duhet të jenë të identifikuar dhe me referenca të bëra në mënyrë të përshtatshme, me qëllim që palët, data, natyra e pretendimit (ose e akuzës në një çështje penale) dhe rezultati apo përfundimi të kuptohet qartësisht;
- (5) Të gjitha vendimet gjyqësore duhet të jenë arsyetuar në nivel të mjaftueshëm (me përjashtim të vendimit formal administrativ) dhe duhet të shpjegojnë arsyet pse argumentet e palës gjyqësore janë refuzuar;
- (6) Vendimet gjyqësore duhet të shpallin apo të bëjnë një referencë të qartë tek çdo ligj dhe praktikë gjyqësore ose rregull procedural, që ka shërbyer për dhënien e vendimit;
- (7) Gjykatat dhe gjyqtarët duhet të respektojnë kufijtë kohorë transparentë dhe publikë për dhënien e vendimit pasi çështja është paraqitur në gjykatë dhe/ose pas zhvillimit të seancës gjyqësore;
- (8) Të gjitha vendimet përgjithësisht duhet të jenë të disponueshme për publikun në një forum të përshtatshëm (dhe, në raste të përshtatshme, të anonimizuar).”



⁷⁵ Gjendet në http://www.ency.eu/images/stories/pdf/workinggroups/ency_report_ia_2015_2016_adapted_ga.pdf, faqet 9-10, [lexuar së fundmi në 30 korrik 2016]

LGJA përcakton se gjykata administrative jep dy kategori vendimesh:

1. vendime jopërfundimtare;
2. vendime përfundimtare.

Vendimet jopërfundimtare⁷⁶ përfshijnë vendimet e pushimit të gjyimit dhe vendimet e mospranimit të padisë, pra ato vendime me të cilat përfundon procedura e gjyimit të çështjes, por çështja nuk zgjidhet në themelin e saj. Këto vendime quhen ndryshe edhe vendime të karakterit procedural. Me dhënien e këtij vendimi, gjykata vendos edhe heqjen e sigurimit të padisë.

Gjykata administrative jep **vendim mospranimi** të padisë atëherë kur çmon se padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Kushtet formale të padisë përshkruhen në Kreun III të LGJA dhe kanë të bëjnë:

- » me të drejtën e ngritjes së padisë dhe legjitimitimin aktiv;
- » me shterimin e mjeteve të ankimit administrativ;
- » me afatin e ngritjes së padisë; dhe
- » me kushte të tjera specifike të vendosura në ligje të veçanta për raste të veçanta. Gjykata mund të japë vendim për mospranimin e padisë përgjatë veprimeve përgatitore ose në seancë gjyqësore, derisa nuk ka dhënë vendimin e ndërmjetëm për marrjen në shqyrtim të provave.

Gjykata administrative jep **vendim pushimi** të gjyimit atëherë kur paditësi tërheq padinë e paraqitur. Tërheqja e padisë tregon se paditësi nuk ka më interes për të vazhduar gjykimin, por në ndryshim nga mosparaqitja e tij në seancë këtë mungesë interesi ai e vërteton në mënyrë pozitive përpara gjykatës. Kjo është arsyeja, që LGJA e ka përcaktuar tërheqjen e padisë si një veprim formal, që duhet të kryhet domosdoshmërisht me akt të shkruar dhe të paraqitet në gjykatë derisa vendimi gjyqësor përfundimtar të mos ketë marrë formë të prerë. Tek rastet e pushimit të gjyimit, duhet rikujtuar që në gjykimin administrativ nuk vlen rregulli i pushimit të gjyimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit sepse neni 3 pika 4 shpall parimin “Gjykata administrative, sipas natyrës së çështjes, shqyrton çështjen gojarisht në seancë gjyqësore ose mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi. Mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjyimit”.

Vendimet përfundimtare⁷⁷ janë vendimet e dhëna në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me të cilin gjykata jep zgjidhjen e mosmarrëveshjes së palëve. Në varësi të disponimit të gjykatës këto vendime kategorizohen në vendime pranimit dhe vendime rrëzimi.

Në rast se gjykata jep një **vendim përfundimtar pranimit**, tërësor apo pjesor të padisë, atëherë ajo vendos edhe ligjërimin e sigurimit të padisë. Në vendimet e pranimit, ligji në nenin 40 pika 1 ka përcaktuar 10 hipoteza të vendimeve gjyqësore. Nëntë prej tyre lidhen me mosmarrëveshjet

administrative, ndërsa hipoteza e dhjetë tregon disponimin mbi mosmarrëveshjet e punës. Të 10 hipotezat e vendimeve të pranimit përkojnë saktësisht me kërkimet që mund t’i paraqiten gjykatës administrative (*shih* nenin 17 pika 1 të LGJA).

Gjykata administrative jep **vendim përfundimtar rrëzimi** në çdo rast kur çmon se veprimi administrativ (akti administrativ, kontrata administrative apo veprimi tjetër administrativ) është në përputhje me ligjin dhe i bazuar në faktet e provuara në gjykim. Gjithashtu, gjykata jep të njëjtin vendim edhe në rastin kur vëren shkelje procedurale në kryerjen e veprimit administrativ nga organi publik, por bindet se pavarësisht këtyre shkeljeve, pasojat do të ishin të njëjta. Në këtë mënyrë, përpara gjyqtarit administrativ shtrohet detyra e analizës së kujdeshme të kontekstit të fakteve përballë ligjit, duke përdorur metoda krahasuese për nxjerrjen e rezultateve në gjykim. Në çdo rast të vendimit përfundimtar të rrëzimit gjykata vendos edhe heqjen e sigurimit të padisë.

Neni 40, pika 3 parashikon që gjykata administrative jep vendim përfundimtar rrëzimi edhe atëherë kur vlerëson se akti nënligjor normativ është i ligjshëm. Ky formulim i shërben rasteve, kur shoqatat apo grupet e interesit pretendojnë cenimin e një interesi të ligjshëm publik dhe kundërshtojnë aktin nënligjor normativ me padi kryesore⁷⁸. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për përmbajtjen e nenit 43, pika 2 të ligjit, që parashikon se vendimi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, pasi ka marrë formë të prerë, me kërkesë të gjykatës, që ka dhënë vendimin publikohet i plotë, në të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit.

Ndërsa për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, ligji shprehet në nenin 40, pika 1, shkronja “g” për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike. Kjo është një normë referuese, që të dërgon tek Kodi i Punës. Edhe me anë të kësaj norme përforcohet përfundimi se mosmarrëveshjet e punës, të cilat kanë një masë ngjashmërie me mosmarrëveshjet administrative, i janë caktuar gjykatës administrative me këtë ligj thjesht për çështje volumi dhe jo për t’i çuar ato drejt barazisë së plotë në natyrë me mosmarrëveshjet administrative.

Vendimi përfundimtar, sipas nenit 41 të LGJA përmban tri pjesët tradicionale me të gjithë elementët e kërkuar nga neni 310 i K.Pr.Civile, por me dy elementë të shtuar shprehimisht: (1) hyrjen; (2) pjesën përshkruese-arsyetuese dhe (3) pjesën urdhëruese.

Në **hyrje** të vendimit përmenden gjykata që ka gjykuar çështjen, trupi gjykues dhe sekretari gjyqësor, koha dhe vendi i dhënies së vendimit, palët duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre, si dhe përfaqësuesit e tyre, objekti i padisë, kërkimet përfundimtare të palëve.

Në **pjesën përshkruese-arsyetuese** përmenden rrethanat e çështjes, ashtu siç i ka konstatuar gjykata gjatë gjyimit dhe përfundimet e gjykatës, provat dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi, dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi. Gjithashtu, në pjesën arsyetuese duhet të përcaktohen

⁷⁶ *Shih* nenin 39 të LGJA

⁷⁷ *Shih* nenin 40 të LGJA

⁷⁸ *Shih* nenin 15, shkronja “d” të LGJA

qartë çështjet që gjykata ka vlerësuar lidhur me ligjshmërinë e veprimit administrativ dhe lidhur me ligjshmërinë e zgjedhjes alternative ligjore nga organi publik (përputhshmëria e zgjedhjes me objektivin dhe qëllimin e ligjit, zgjedhja vetëm për qëllimin e ligjit dhe proporcionaliteti i zgjedhjes). Ky arsyetim është një element i shtuar i përmbajtjes tradicionale të vendimit gjyqësor⁷⁹ dhe synon të sigurojë zbatimin e saktë të rregullave mbi kufijtë e shqyrtimit të çështjes të parashikuara nga neni 37 i LGJA.

Aktualisht, ka një shqetësim në rritje për arsyetimin e vendimeve nga gjyqësori në Shqipëri në dy drejtime, të cilat kanë një lidhje të ngushtë edhe me cilësinë e transparencës dhe me besimin publik. I pari lidhet me situatën praktike, ku nuk mungojnë rastet që vendimi gjyqësor shpallet për palët vetëm në pjesën urdhëruese të tij dhe arsyetimi i vendimit hartohet më vonë nga gjyqtarët, në disa raste edhe me vonesa të konsiderueshme që pengojnë palët në proces qoftë për të ankimuar vendimin gjyqësor, qoftë për të vënë në ekzekutim vendimin gjyqësor. Një praktikë e tillë ka krijuar edhe probleme në cilësinë e hartimit të vendimeve gjyqësore, sepse nuk kanë munguar rastet, kur gjatë arsyetimit të vendimit, gjyqtari ka konstatuar çështje të reja mbi faktet dhe ligjin. I dyti, lidhet cilësinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, sidomos në drejtim të çështjeve të ligjit. Në këtë drejtim, nuk mungojnë rastet e arsyetimit kontradiktor, rastet kur gjykata nuk ka arsyetuar mbi të gjitha kërkimet e palëve apo rastet kur referencat ligjore apo në jurisprudencë janë të pasakta apo që nuk kanë lidhje me çështjen konkrete. Ky shqetësim i fundit lidhet edhe me faktin që në Shqipëri ende nuk ka një qendër zyrtare dokumentecioni, e cila të botojë rregullisht legjislacionin dhe jurisprudencën e përditësuar.

Kjo problematikë është përshkruar prej disa vitesh në Raportet Vjetore të Progresit për Shqipërinë të përgatitur nga Komisioni Evropian. Në Raportin e fundit, të vitit 2015, thuhet:

“Aksesi online tek jurisprudenca nuk garantohet plotësisht dhe nuk ka një bazë të dhënash, ku mund të kërkohet. Vendimet gjyqësore, edhe kur publikohen, shpesh kanë mungesa të arsyetimit të duhur dhe afatet nuk respektohen gjithnjë. Ka nevojë për përpjekje për të përmirësuar aftësitë e gjyqtarëve në hartimin e vendimeve. Botimi i vendimeve gjyqësore në mënyrë anonime ende nuk është i mundur”⁸⁰.

Arsyetimi i vendimit gjyqësor është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor ndaj individit dhe ai konsiderohet i lidhur ngushtë me parimin e administrimit të duhur të drejtësisë. GJEDNJ ka theksuar se gjykatat vendase duhet të sqarojnë qartësisht bazat mbi të cilat marrin vendimet e tyre. Është pikërisht ky fakt, *inter alia*, që i mundëson individit të ushtrojë të drejtën e

tij për apel⁸¹. Edhe Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese⁸².

Detyrimi për arsyetimin e vendimeve gjyqësore përmbush disa funksione. I pari ka të bëjë me respektimin e garancive dhe të drejtave themelore të subjekteve në raport me ushtrimin e pushtetit publik. Në këtë mënyrë, arsyetimi i vendimit gjyqësor shërben si garanci për një proces të rregullt ligjor dhe për t'u treguar palëve në gjykim se ato janë dëgjuar prej gjykatës.

Funksioni i dytë lidhet me kontrollin e brendshëm të vendimeve gjyqësore sipas normave procedurale sipas rregullave të ankimit gjyqësor. Në këtë kuptim, individit ushtron edhe një të drejtë tjetër kushtetuese, atë të ankimit në një gjykatë më të lartë⁸³. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në dhënien e vendimit. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor.

Funksioni i tretë ka të bëjë me pjesëmarrjen e publikut dhe transparencën e ushtrimit të pushtetit gjyqësor, që është një monitorim jashtë-procedural. Ky funksion, i cili i jep jetë dhe legjitimiton edhe rregullin e dhënies së vendimeve gjyqësore “Në emër të Republikës”, garanton respektimin e akteve të pushtetit gjyqësor, konsolidimin autoritetin e tij publik dhe forcon besimin publik tek pushteti gjyqësor. Në shërbim të këtij funksioni janë krijuar edhe mekanizmat inspektuese të pushtetit gjyqësor, ku një pjesë e rëndësishme e detyrave të tyre është verifikimi i ankesave të publikut.

Së fundmi, mbi arsyetimin e vendimeve gjyqësore duhet theksuar se rëndësia e tij është konfirmuar edhe nga ligjvënësi, i cili në çdo ligj procedural i ka dhënë normave për arsyetimin e vendimeve gjyqësore karakter të detyrueshëm për zbatim dhe nga ana tjetër, mungesën absolute të tij e ka lidhur me ndëshkimet. Shkelja e detyrimit për arsyetimin e vendimit gjyqësor përbën shkak për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 2, shkronja “e” e ligjit nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh”, i ndryshuar. Këto arsyeime janë vlerësuar edhe gjatë hartimit të ligjit, madje janë bërë objekt diskutimesh edhe në komisionet

79 Shih nenin 41 shkronja “a” të LGJA

80 Gjetet në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf, faqe 53, [lexuar së fundmi në 30 korrik 2016]

81 Shih Hadjianastassiou kundër Greqisë, Kërkesa nr. 12945/87, datë 16/12/1992

82 Shih vendimet nr.20, datë 13.04.2012 dhe nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese

83 Shih nenin 43 të Kushtetutës

parlamentare. Nën këtë frymë është hartuar neni 42 i LGJA për shpalljen dhe depozitimin e vendimit, i cili parashikon se vendimi në çdo rast duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar, se në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë dhe se dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar duhet të dorëzohet në sekretarinë gjyqësore brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit. Këto rregulla marrin përsipër të disiplinojnë edhe të drejtën për një gjykim pa vonesa të palëve, të drejtën për ekzekutimin pa vonesa të vendimit nëse ai nuk ankimohet nga palët, si dhe të drejtën e tyre për t'u mbrojtur nëpërmjet paraqitjes së një ankimi efektiv dhe në kohën e duhur.

Ndërsa në pjesën urdhëruese të vendimit përmenden çfarë vendosi gjykata, kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, e drejta për të bërë ankim dhe afati për paraqitjen e ankimit. Edhe kjo pjesë e vendimit ka një element të shtuar që synon të lehtësojë procesin e ekzekutimit⁸⁴. Ky element duhet të jetë pjesë përbërëse e çdo vendimi të dhënë nga gjykata administrative, nëse vendimmarrja e gjykatës përmban një detyrim konkret të palës së paditur. Në këtë rast, në pjesën urdhëruese, gjyqtari duhet të shënojë se vendimi është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor, afatin brenda të cilit duhet ekzekutuar vendimi dhe mënyrën e ekzekutimit të tij. Nëpërmjet vendosjes së rregullit për përcaktimin e afatit dhe mënyrës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor, të ndërthurur edhe me rregullat në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, LGJA bën përpjekje për të zhvilluar më tej standardin e procesit të rregullt, i cili tashmë është pranuar nga jurisprudenca që përfshin edhe ekzekutimin e shpejtë dhe efikas të vendimeve gjyqësore. Në caktimin e afatit, si rregull, gjyqtari duhet të mbajë parasysh se ai fillon me marrjen e vendimit formë të prerë, ndërsa mbarimi i tij lidhet me rrethanat konkrete të çështjes, cilësitë subjektive të të paditurit dhe me llojin e detyrimit. Këta tre faktorë të fundit mbahen në konsideratë edhe në përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Në vijim të rregullave për vendimin gjyqësor të gjykatës administrative, LGJA në nenin 43 parashikon detyrimin e publikimit në mënyrën dhe mjetet e përshtatshme. Ky detyrim përfshin si vendimet e gjykimit administrativ, ashtu edhe vendimet mbi mosmarrëveshjet e punës. Gjithashtu, duhet thënë se ky detyrim përfshin të gjitha llojet e vendimit: vendimet jopërfundimtare të mospranimit të padisë apo të pushimit të gjykimit, si dhe vendimet përfundimtare të pranimit (tërësor apo të pjesëshëm) të padisë apo të rrëzimit të padisë.

Në fakt, shkëmbimi i vrullshëm i informacionit dhe zhvillimi i teknologjive të reja informuese ka sjellë si nevojë botimin e vendimeve gjyqësore, të paktën në rrjet elektronik. Mirëpo kjo nevojë përballlet me dy çështje të ndjeshme:

1. me mbrojtjen e të dhënave personale të individit.

Lidhur me këtë çështje, ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, jep përkufizimin e të dhënave sensitive, me të cilat kuptohet çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën racore ose etnike, mendimet

politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale. Nga ana tjetër, ky ligj jep garancinë për mbrojtjen e këtyre të dhënave dhe procedurën e kontrollimit/përdorimit të tyre dhe

2. me faktin që legjislacioni shqiptar, si ai civil, ashtu edhe ai penal deri tasni e ka konsideruar publikimin e vendimeve gjyqësore si ndëshkim ndaj palës humbëse.

Në këto rrethana, ligji e ka lënë të hapur mundësinë për botimin e vendimeve gjyqësore të gjykatës administrative, duke i lënë terren praktikës gjyqësore për zhvillimin e përshtatshëm të saj.

84 Shih nenin 41, shkronja "b" të LGJA

3

AKTET PROCEDURALE NË GJYKIMIN NË APEL

Kreu VII (nenet 44-55) i LGJA përmbledh rregullat mbi mjetet e ankimit dhe gjykimin në apel. Nga analiza e këtyre normave vërehet se në këtë shkallë gjykimi shfaqen një sërë aktesh procedurale, ku disa prej tyre janë të ngjashme me ato të gjyimit në shkallë të parë, ndërsa disa të tjera janë tipike për gjykimin në apel. Në këtë kapitull të Manualit do të trajtohen vetëm aktet që i përkasin ekskluzivisht gjyimit në apel, ndërsa për aktet e tjera do të bëhen referenca tek akte procedurale të gjyimit administrativ në shkallë të parë.

1. Aktet e ankimit

1.1 Ankimi i zakonshëm

Fillimisht, në lidhje me ankimin ka rëndësi analiza krahasuese midis LGJA dhe K.Pr.Civile, e cila, në fakt, ka një shtrirje në pothuajse të gjitha institutet e gjyimit administrativ. Kjo veçori buron nga fakti se teknika legislative e përzgjedhur për hartimin e LGJA përcaktoi K.Pr.Civile si tekst ligjor plotësues dhe specifikues. Një zgjedhje e tillë u maturua duke marrë parasysh disa tregues. Së pari, ishte nevoja për të ruajtur traditën procedurale, sipas së cilës gjykimi administrativ ishte pjesë e K.Pr.Civile të miratuar në vitin 1995 dhe ndonëse ai përcaktohej si gjykim i posaçëm, ndryshimet e tij nga gjykimi i zakonshëm civil ishin të pakta. Për këtë shkak, doktrina dhe jurisprudenca e kohës kishte krijuar njëfarë lidhjeje organike midis këtyre dy gjykimeve. Zgjedhja e një teknike, sipas së cilës të përpilohej një ligj apo kod tërësisht i ri, pa asnjë referencë tek K.Pr.Civile, përveçse do të rezultonte në një sipërmarrje të vështirë, do të passillte edhe një lloj humbjeje të kujtesës jurisprudenciale dhe doktrinale, për ato pjesë që zbatoheshin me efekte pozitive. Kjo është arsyeja që një rregull i tillë është i parashikuar që në nenin 1, paragrafi 2 të LGJA, teksa janë saktësuar kufijtë ndarës, si dhe marrëdhënia ndërvepruese midis këtyre dy ligjeve bazë. LGJA përshkohet nga rregulli, sipas të cilit për çdo institut të gjyimit administrativ baza rregullatore gjendet dhe është e vlefshme në K.Pr.Civile, nëse vetë LGJA nuk parashikon ndryshe, që tregon edhe përparësinë e LGJA midis dy ligjeve në fjalë.

Rregulli i mësipërm është i përsëritur në disa nga dispozitat e LGJA, shenjë kjo e rëndësisë që i ka kushtuar legjislatori këtij rregulli. Për më tej, në nenin 44 të LGJA, teksa trajtohen në vija të përgjithshme ankimet, pohohet se për mjetet dhe afatet e ankimeve rregullat bazë do të jenë ato të parashikuara në K.Pr.Civile, përveç rasteve kur vetë LGJA përmban rregulla që parashikojnë një trajtim të ndryshëm. Në këtë kuptim, analiza krahasimore midis LGJA dhe K.Pr.Civile bëhet jo vetëm për mjetet dhe afatet e ankimeve, por edhe për të gjitha elementet e tjera të konceptit procedural të ankimit.

1.2 Koncepti i ankimit

LGJA përgjatë gjithë tekstit të tij përdor termin “ankim”. Duhet të saktësohet se termi “ankim” i referohet të drejtës subjektive (me natyrë procedurale), që gëzojnë subjektet e gjyimit administrativ (palët). Pra, në këtë kuptim bëhet fjalë për një të drejtë me natyrë materiale. Ky

koncept është i ndryshëm nga ai i “kërkesës ankimore”, që i referohet dokumentit me të gjitha ekstremitetet formale ligjore. Në punën e përditshme ndodh rëndom që praktikantët e së drejtës, kërkesës ankimore i referohen me termin ankim. Për qëllime të këtij Manuali është e rëndësishme të bëhet një dallim i tillë, jo vetëm për saktësi profesionale, por edhe për të lehtësuar kuptimin e shkeljeve të mundshme dhe pasojave që vijnë prej këtyre shkeljeve.

Doktrina e përkufizon ankimin brenda rrjedhës së procesit gjyqësor, ku ky i fundit konceptohet si një zinxhir i njëpasnjëshëm veprimesh procedurale, herë me impuls të palëve dhe herë me impuls të vetë gjykatës, të cilat ndërlidhen dhe nënrenditen me njëra-tjetrën sipas një mekanizmi logjik shkak-pasojë. Procesi gjyqësor merr shkas nga ushtrimi i të drejtës së padisë (e materializuar në aktin procedural të kërkesëpadisë) dhe përfundon me aktin më të fundit të procesit, që është shpallja e vendimit përfundimtar të gjykatës. Ankimi, i konceptuar si e drejtë subjektive me natyrë procedurale është një e drejtë që më së shumti shpreh vullnetin subjektiv të palëve në gjykim për ta transferuar fazën e gjykimit nga shkallë të parë në shkallën e dytë. Këtu duhet saktësuar se “ankimi” sipas nenit 44 të LGJA i referohet pikërisht aktit që përcjell procesin gjyqësor nga shkalla e parë e gjykimit në atë të shkallës së dytë (apel). Ky lloj ankimi është i ndryshëm nga akti që bën kalimin nga gjykimi në shkallë të dytë në gjykimin në Gjykatën e Lartë me anë të rekursit.

Kur ankimi konceptohet si e drejtë subjektive, ai nuk është gjë tjetër veçse një akt vullneti i brendshëm, titullar i të cilit janë vetëm subjektet e gjykimit. Ligji një të drejtë të tillë ua njeh vetëm palëve në gjykim. Në këtë pikëpamje, vlefshmëria e vullnetit të ushtrimit të të drejtës së ankimit duhet të analizohet sipas rregullave për vlefshmërinë e veprimeve juridike, që trajtohen në K.Civil. Trajtimi i elementeve formale, që duhet të respektojë ushtrimi i kësaj të drejte, i takon më pas regjimit juridik të kërkesës ankimore, që nuk është gjë tjetër veçse shfaqja e jashtme e vullnetit për të ushtruar ankimin.

1.3 Efektet e ankimit

Një nga instrumentet më të mira për të përkufizuar në mënyrë të plotë ankimin është identifikimi i efekteve juridike të tij. Ankimi, si e drejtë procedurale është një nga aktet më të rëndësishme shtytëse në dorë të palëve ndërgjyqëse për ta transferuar procesin gjyqësor nga një fazë tek tjetra, madje edhe nga njëra shkallë në tjetrën, ku këto shkallë gjykimi kanë dallime cilësore midis tyre. Në këtë pikëpamje ai paraqet ngjashmëri me të drejtën e padisë. Nuk është aspak e rastit, që e drejta e ankimit gjen trajtim në nivel kushtetues⁸⁵, madje edhe në KEDN⁸⁶. Ky arsyetim është i vlefshëm jo vetëm për ankimin i zakonshëm, por edhe për ankimin e veçantë. Në kushtet kur ushtrimi i të drejtës së ankimit vendos kufirin midis dy shkallëve të procesit gjyqësor, efektet e tij duhet të analizohen në dy drejtime: (1) efektet ndaj procesit gjyqësor në shkallë të parë dhe (2) efektet ndaj procesit gjyqësor në shkallë të dytë.

85 Neni 43 i Kushtetutës parashikon se “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në shkallë të parë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.

86 *Shih* nenin 13 të KEDNj

Lidhur me efektet ndaj procesit gjyqësor në shkallë të parë duhet theksuar se në nenin 45 të LGJA flitet për ndalimin e ankimit ndaj disa vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative të shkallës së parë. Ajo që duhet të mbahet parasysh në zbatimin korrekt të kësaj dispozite është saktësimi i pagës minimale në shkallë vendi, vlera e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave⁸⁷ dhe për këtë shkak është periodikisht e ndryshueshme. Pavarësisht kësaj vështirësie, ky sistem reference për vlerën e çështjes që ankimohet është menduar t’i shërbejë rezistencës në kohë të ligjit, duke shmangur ndryshimet e vazhdueshme të tij për shkak të zhvlerësimit në kohë të monedhës.

Në praktikë, ka një diskutim mbi përputhshmërinë e nenit 45 të LGJA me nenin 43 të Kushtetutës, kur vetë Kushtetuta nuk parashikon në mënyrë taksative përjashtime nga e drejta e ankimit. Megjithatë, përgjatë diskutimeve parlamentare të LGJA është përdorur si kontekst kushtetues që justifikon këtë ndalim ligjor të ankimit, neni 17 i Kushtetutës, sipas të cilit, kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj dhe për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, me kushtin që kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Përsa i përket efekteve ndaj procesit në shkallë të parë është e rëndësishme të dallohet se ankimi i ushtruar nga një palë, në përfundim të procesit në shkallë të parë, i referohet procesit gjyqësor në tërësi të zhvilluar në shkallë të parë dhe jo thjesht vendimit të dhënë në përfundim të këtij procesi. Konkretish, një palë gjyqësore ushtron të drejtën e ankimit pasi është e pakënaqur me zgjidhjen e dhënë nga vendimi përfundimtar. Po ashtu, është e vërtetë se kërkesa ankimore plotësohet si mjet kundërshtues ndaj vendimit të shkallës së parë, por mund të ndodhë që ankimi të godasë veprime procedurale të gjykimit, të cilat mund të mos pasqyrohen fare në vendimin përfundimtar, por kanë diktuar në mënyrë thelbësore dhënien e këtij vendimi. Të tilla mund të jenë një procedurë për kryerje ekspertimi, një procedurë për përjashtim gjyqtari apo një procedurë për marrjen e një prove. Rregulli, sipas të cilit për disa vendime të ndërmjetme mund të bëhet ankim i veçantë në mënyrë të menjëhershme, nuk duhet të krijojë idenë se për rastet e tjera, vendimet e ndërmjetme nuk ankimohen dhe që ankimi ndaj vendimit përfundimtar nuk përfshin çështje të procedurës së ndjekur për marrjen e vendimit. Me këtë analizë arrihet në përfundimin se ankimi është mjeti, i cili bën të mundur një kontroll të procedurës gjyqësore të realizuar nga gjykata e shkallës së parë nën optikën se sa kjo procedurë ka ndikuar në vendimin e dhënë.

Një efekt tjetër më i veçantë dhe më i dukshëm i ushtrimit të ankimit ndaj procesit gjyqësor në shkallë të parë lidhet me faktin se ushtrimi i ankimit në mënyrë të vlefshme (brenda afatit dhe në respekt të plotë të kërkesave formale të kërkesës ankimore) pengon që vendimi i gjykatës së shkallës së parë të marrë formë të prerë.

Ankimi jep efekte edhe ndaj procesit gjyqësor të ardhshëm, gjykimit në apel. Ushtrimi i ankimit

87 Në mbështetje të nenit 111 i K.Punës dhe të nenit 4 i ligjit 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shëprblimeve”, vlera e pagës minimale më e fundit është përcaktuar me VKM nr. 573, datë 03.07.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Sipas pikës 1 të kësaj VKM-je, paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, është 22 000 lekë.

i hap rrugën procesit gjyqësor të zhvillohet edhe njëherë nga e para. Mirëpo në këtë rast, kushtet nuk janë tërësisht të njëjta me efektin që jep ushtrimi i së drejtës së padisë (nëpërmjet kërkesëpadiës). Kjo për faktin se në kohën e ushtrimit të ankimit është realizuar një proces gjyqësor, ai i shkallës së parë. Palët tashmë kanë një pikë referimi më konkrete ndaj së cilës mund të drejtojnë pretendimet e tyre. Po kështu, edhe Gjykata e Apelit, ka një tërësi faktesh, mbi të cilin do të verifikojë bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të palëve, që nuk është gjë tjetër veçse procesi gjyqësor i zhvilluar në shkallë të parë.

Në këtë pikë ka rëndësi përcaktimi i masës së procesit gjyqësor që duhet të rishikohet nga Gjykata e Apelit dhe masa e procesit gjyqësor që duhet të ribëhet prej kësaj gjykate. Masa e rishikimit të procesit gjyqësor është më e gjerë sesa masa e procesit, që duhet të ribëhet. Në përcaktimin e masës së rishikimit të procesit gjyqësor, konkurrojnë dy instrumente: (1) kërkimet e palës nëpërmjet ankimit dhe (2) e drejta e gjykatës që kryesisht të shqyrtojë edhe çështje, të cilat nuk janë ngritur si pretendime në ankim. Nga analiza e ndërthurur e LGJA dhe e K.Pr.Civile, rezulton se e drejta e gjykatës për të shqyrtuar çështje të tjera jashtë gamës së pretendimeve të ngritura në ankim përfshin fillimisht të gjitha ato çështje, për të cilat ligji shprehet se shqyrtohen apo ngrihen “kryesisht” nga gjykata. Në vijim, e drejta e gjykatës përfshin edhe çështje të tjera, siç është rasti kur Gjykata e Apelit ka të drejtë të vendosë pushimi e gjykimin, me arsyetimin se “padija nuk mund të ngrihet ose gjykimi nuk mund të vazhdonte”⁸⁸. Në përfundim të këtij përfundimi është edhe fakti se LGJA hesht përse i përket motiveve, në bazë të të cilave mund të ngrihet ankim.

Sa i takon të drejtës së Gjykatës së Apelit për të bërë nga e para veprime procedurale, në nenin 47 të LGJA parashikohet e drejta e palëve dhe mundësia që gjykata krijon për të marrë prova të reja. Kjo mundësi është e kufizuar nga fakti i pamundësisë së palës për t’i paraqitur ato përgjatë gjykimin në shkallë të parë. Në plotësim të kësaj të drejtë është edhe parashikimi i nenit 51, pika 1 shkronja “a”, sipas të cilit gjykata vendos kalimin e procedurës nga “dhomë këshillimi” në “seancë gjyqësore” kur për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të LGJA. Këto parashikime janë të tilla që dëshmojnë në analizë të fundit konkluzionin se Gjykata e Apelit ka të drejtë të kontrollojë procesin gjyqësor të shkallës së parë në të gjithë perimetrin e tij. Ky është efekti thelbësor i ankimit ndaj procesit gjyqësor të ardhshëm (gjykimin në apel). Një qasje e tillë shkon në koherencë edhe me vetë pozicionin që i është dhënë gjykatës në procesin gjyqësor administrativ. Në ndryshim nga procesi gjyqësor civil, në procesin gjyqësor administrativ gjykatës i është dhënë një rol aktiv më energjik; gjykata ka kompetencë deri edhe të zëvendësojë vetë organin administrativ në shqyrtimin e veprimeve administrative.

1.4 Afatet e paraqitjes së ankimit

Afati i paraqitjes së ankimit në LGJA nuk ka një rregullim të ndryshëm nga ai i parashikuar në K.Pr.Civile. Afati 15 ditor (për ankimin e zakonshëm) dhe ai 5 ditor (për ankimin e veçantë) janë

rregulla të huazuara nga procesi gjyqësor civil, që zbatohen edhe në gjykimin administrativ. Ankimi paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, e cila ka dhënë vendimin ndaj të cilit ushtrohet ankim. Në këtë moment zë vend një procedurë e posaçme gjyqësore në shkallë të parë për saktësimin e përmbushjes së elementeve formale dhe materiale të ankimit. Kjo është një procedurë filtruese paraprake mbi kërkesën ankimore, synimi i së cilës është që defektet eventuale të kërkesës ankimore të mos mbarten në gjykimin në apel dhe rrjedhimisht, të përftohet shpejtësia në gjykim.

1.5 Subjektet që ushtrojnë ankimin

E drejta e ankimit i takon pikërisht palëve ndërgjyqëse, e cila është një e drejtë personale e tyre. Secila palë mund ta ushtrojë këtë të drejtë edhe nëpërmjet përfaqësuesit të saj dhe në këtë rast, kërkesa ankimore duhet të bashkëshoqërohet me aktin e përfaqësimit, në rast se një i tillë nuk ndodhet në dosjen e formësuar në procesin gjyqësor të zhvilluar në shkallë të parë. Është e kuptueshme që bëhet fjalë për raste të ndryshme nga ato kur pala ka zgjedhur përfaqësuesin e vet me prokurë noteriale që në shkallë të parë, apo me deklaram përpara gjykatës në shkallë të parë, duke i dhënë tagra përfaqësimi edhe për të drejtën e ankimit dhe gjykimin në apel. Në këto rast, mund të thuhet që akti i përfaqësimit gjendet në dosjen gjyqësore. Gjatë procesit të shqyrtimit të rregullshmërisë së depozitimit të ankimit, një nga çështjet, të cilat shqyrtohen në aspektin formal, është fakti nëse ankimi i paraqitur nga përfaqësuesi i ankuesit ka bashkëlidhur aktin e përfaqësimit.

2. Forma e kërkesës ankimore dhe elementët e saj

Vetë procesi gjyqësor administrativ priret të jetë më së shumti proces gjyqësor mbi dokumente sesa proces gjyqësor gojor. Gjithsesi, kërkesa ankimore në çdo rast përpilohet dhe paraqitet në formë të shkruar.

Nga analiza e nenit 46 të LGJA, identifikohen disa elemente të kërkesës ankimore. Kështu, përveç faktit se kërkesa ankimore duhet të jetë e shkruar, ajo duhet të depozitohet në aq kopje sa janë personat që marrin pjesë në gjykim. Në ndryshim me K.Pr.Civile, numri i kopjeve të ankimit kërkohet për numër të personave dhe jo për aq sa janë numri i palëve ndërgjyqëse. Kjo do të thotë se nëse një palë ndërgjyqëse përbëhet nga më shumë se një person, kërkohet që secili prej tyre të pajiset me kopje të kërkesës ankimore. Po kështu, kërkesa ankimore duhet të bashkëshoqërohet sipas rastit edhe nga akti i përfaqësimit.

Dispozita në fjalë pohon se ankimit mund t’i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera, por që nuk specifikohen se çfarë mund të jenë. Ky parashikim ka lidhje me një mundësi procedurale që trajtohet në pjesën e gjykimin në apel lidhur me mundësinë e paraqitjes së provave të reja, të cilat pala përkatëse nuk ka mundur jo për faj të saj t’i paraqesë në gjykimin në shkallë të parë. Bëhet fjalë kryesisht jo në vetvete me provat e reja që kërkohet të paraqesë në apel sipas nenit 47, por për dokumente me anë të të cilave duhet të provojë (në këtë fazë ai thjesht duhet të pohojë) faktin e pamundësisë për t’i paraqitur në gjykim dhe së dyti, faktin e mospasjes faj nga ana e tij për mosparaqitjen e tyre. Sigurisht që duhet të bashkëngjisë edhe vetë këto prova (nëse janë të

dokumentuara që në atë çast). Duhet theksuar edhe njëherë roli i gjyqtarit të vetëm në këtë fazë: ai nuk ka të drejtë të bëjë shqyrtim në themel lidhur me mundësinë apo pamundësinë e paraqitjes së këtyre provave, apo me pasjen e fajit ose jo nga pala kërkuese. Ajo çfarë gjyqtari duhet të sigurojë është që të gjitha pohimet që bën pala në ankim lidhur me pasjen e dokumenteve (provave) rreth pamundësisë apo mospasjes së fajit (ashtu dhe në atë masë sa i pretendon ankuesi) duhet t'ia bashkëlidhë ankimit. Shqyrtimi në themel nëse ekziston ose jo faji apo pamundësia dhe në ç'masë provohet janë në vlerësimin ekskluziv të Gjykatës së Apelit.

Përpos këtyre elementeve, kërkesa ankimore në tekstin e saj, duhet të përmbajë: (1) nënshkrimin e kërkesës nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij; (2) tregimin e palëve ndërgjyqëse; (3) tregimin e vendimit kundër të cilit bëhet ankim; (4) tregimin e asaj çfarë kërkohet me ankimin. Këto elementë të përmbajtjes së kërkesës ankimore janë lehtësisht të kuptueshëm e që rrallë ndodh të ngrenë dyshime. E vetmja pikë që kërkon sqarim është “tregimi i asaj çfarë kërkohet me ankimin”. Ky element kërkon që pala ankuese të saktësojë qartësisht pretendimin e saj mbi formulimin dhe përmbajtjen e dispozitivit të vendimit të shkallës së parë. Siç u shpjegua më lart, Gjykata e Apelit është e lirë të kontrollojë procesin gjyqësor të shkallës së parë dhe bashkë me të edhe aktin e fundëm të procesit që është vendimi gjyqësor, porse lidhur me dispozitivin e vendimit duhet saktësuar se gjykata është e detyruar të respektojë edhe kufijtë e pretendimit të ankuesit. Ky është një trajtim i cili i bindet parimit të disponimit e padisë, sipas të cilit gjykata shprehet për aq sa kërkon pala, lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes.

Një strukturim i tillë i kërkesës ankimore me këto elemente formale është në harmoni edhe me trajtimin në themel që i bëhet ankimit si një e drejtë, teksa ushtrimi i kësaj të drejtë nuk kushtëzohet nga parashtrimi i shprehur i motiveve apo arsyeve. Është për arsye të interesit të brendshëm të palës ankuese, që kjo e fundit parashtron më shumë apo më pak në mënyrë të hollësishme arsyet për të cilat ajo ngre pretendimet e veta ndaj vendimit përkatës që apelohe.

Nga pikëpamja strukturore, një kërkesë ankimore mund të hartohet në tre pjesë:

(1) pjesa hyrëse; (2) pjesa arsyetuese dhe (3) pjesa përmblylëse.

Në *pjesën hyrëse* përcaktohen ankuesi, duke treguar cilësinë e tij në gjykim dhe gjeneralitetet e tij), objekti i ankimit (vendimi që ankimohet, çfarë kërkohet me ankimin) dhe palët e tjera ndërgjyqëse.

Pjesa arsyetuese mund të ndahet në tre nënpjesë: (1) hyrja, e cila tregon në mënyrë sintetike se çfarë është vendosur me vendimin gjyqësor që ankimohet; (2) pjesa shpjeguese, ku jepet parashtrimi i qartë i pretendimeve kundër vendimit gjyqësor. Rekomandohet që pretendimet të ndahen në pretendime për procedurën e zbatuar në gjykimin në shkallë të parë dhe arsyet pse shkelja e pretenduar ka ndikuar në dhënien e vendimit dhe pretendime për themelin e vendimit, të cilat nënkategorizohen në pretendime për zbatimin e ligjit material dhe në pretendime mbi saktësinë e fakteve të pranuar nga gjykimi në shkallë të parë. Në parashtrimin e pretendimeve, sugjerohet që ato të listohen të numëruara, duke ndjekur rendin kronologjik. Në parashtrimin e pretendimeve, nëse ato lidhen me çështje fakti, tregohen edhe provat mbështetëse të tyre, duke

analizuar fuqinë provuese të tyre. Nëse pretendimet lidhen me çështje ligjore, sugjerohet që ato të shoqërohen edhe me pjesën përkatëse të jurisprudencës të gjykatave më të larta. Gjithashtu, në këtë pjesë, nëse është rasti, tregohen provat e reja që duhet të merren nga Gjykata e Apelit dhe shkaqet e sakta, për të cilat këto prova nuk janë kërkuar apo nuk janë marrë në gjykimin në shkallë të parë (dokumente, dëshmi, ekspertim, CD etj.).

Në *pjesën përmblylëse* të ankimit parashtrihen saktë kërkimet, për të cilat kërkohet të shprehet Gjykata e Apelit, në përputhje me objektin e ankimit. Në Shtojcën shoqëruese të këtij Manuali jepet një model i kërkesës ankimore.

3. Vendi i paraqitjes së ankimit

Kërkesa ankimore paraqitet në gjykatën, ku është dhënë vendimi gjyqësor që ankimohet. Me paraqitjen e tij fillon procedura e shqyrtimit të ankimit në shkallë të parë, që verifikon pararakisht elementet formale të kërkesës ankimore, duke synuar zhdërvjelltësimin e gjykimin në apel. Kjo procedurë zhvillohet nga gjykata e shkallës së parë për shkak se kjo gjykatë është më afër procesit gjyqësor dhe ka lehtësinë për të shqyrtuar objektivisht elementet formale të kërkesës ankimore. Në këtë lloj procedure, gjykata e shkallës së parë shqyrton përmbushjen ose jo të kërkesave formale të kërkesës ankimore dhe jo “bazueshmërinë” apo “motivimin” e saj. Kontrolli i këtij drejtimi të dytë është lëndë ekskluzive shqyrtimi e Gjykatës së Apelit.

Përsa i përket procedurës që ndjek gjyka e shkallë të parë, duhet theksuar se ky lloj gjykimi ka më shumë natyrë konsultuese/asistuese sesa vendimarrëse. Qëllimi i saj është të lehtësojë plotësimin e aspektit të dokumenteve të ankimit dhe pjekurisë së dosjes në këndvështrimin procedural në mënyrë që çështja të jetë e gatshme për t'u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit. Qëllimi i kësaj procedure nuk është vendosja e një filtri pengues ndaj paraqitjes së ankimit. Kjo është arsyeja, që gjykata kur gjen mangësi formale të kërkesës ankimore apo të dokumenteve shoqëruese, si p.sh. kopje të numrit të ankimeve në numër aq sa janë personat që marrin pjesë në gjykim, akti i përfaqësimit, nuk është nënshkruar, nuk tregohen palët ndërgjyqëse, apo vendimi kundër të cilit bëhet ankim ose se çfarë kërkohet me ankimin, gjyqtari i vetëm njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve⁸⁹.

Ky proces zhvillohet në dhomë këshillimi nga gjyqtari i vetëm, i cili teksa i lë një afat gjer në 5 ditë palës ankimore, identifikon edhe të metat që duhet të plotëson nga ankuesi. Afati 5 ditor është i përcaktuar nga ligji dhe nuk mund të zgjatet nga gjykata. Në këtë rast, gjyqtari i vetëm nxjerr *vendimin për ndreqjen e të metave të ankimit* sipas parashikimit të nenit 46, pika 2, i cili është vendim i ndërmjetëm. Në dispozitivin e këtij vendimi, gjyqtari urdhëron njoftimin e tij ankuesit. As LGJA dhe as K.Pr.Civile nuk japin një parashikim mbi formën apo elementet e tjera të përmbajtjes të këtij vendimi të ndërmjetëm. Meqë ky akt është një vendim i ndërmjetëm⁹⁰, atëherë ai trupëzohet në procesverbalin e seancës në dhomë këshillimi, por për shkak se i njoftohet palëve dhe ankimohet

89 Shih nenin 46 pikat 1 dhe 2 të LGJA

90 Shih nenin 125 të K.Pr.Civile

veçmas, hartohet edhe në një akt autonom. Elementet e tjera formale të këtij lloji vendimi të ndërmjetëm huazohen dhe përdoren *mutatis mutandis* nga elementet e vendimit përfundimtar. Një model i dispozitivit të vendimit gjyqësor të kësaj natyre jepet në Shtojcën e këtij Manuali.

Procedura e verifikimit të plotësimit apo ndreqjes së të metave të kërkesës ankimore ka dy alternativa të mundshme përfundimi. Në alternativën e parë, ankuesi brenda afatit të caktuar gjer në 5 ditë, plotëson të metat që i ka njoftuar gjyqtari i vetëm. Në këtë rast, dokumentet e sjella rishtas apo edhe kërkesa ankimore e riplotësuar, i bashkëngjiten kërkesës ankimore fillestare fizikisht dhe po kështu i përcillen sekretarisë gjyqësore për të kryer veprimet e tjera (përcjellja e ankimit me dokumentacionin tjetër në gjykatën e apelit). LGJA nuk kërkon në këtë rast ndonjë akt formal procedural; procesverbal apo vendim. Në rastin kur të metat e kërkesës ankimore plotësohen rregullisht dhe në afat nga pala, ankimi konsiderohet se është ushtruar që prej datës së paraqitjes së kërkesës ankimore fillestare edhe pse rezultoi me mangësi.

Alternativa e dytë është kur të metat e ankimit nuk plotësohen dhe në këtë rast, gjyqtari i vetëm merr një vendim tjetër jopërfundimtar; vendimin për kthimin e ankimit. Këtij vendimi i bashkëngjiten fizikisht kërkesa ankimore dhe të gjitha dokumentet përkatëse të paraqitura nga ankuesi. Mospërmbushja e të metave në afatin e caktuar, passjell efektin që ankimi konsiderohet se nuk është paraqitur. Efekti “konsiderohet se nuk është paraqitur” është vetëm juridik, sepse në praktikë një procedurë e tillë dokumentohet rregullisht në burimet arkivore në gjykatë, ku ruhet edhe një kopje e një vendimit gjyqësor të dhënë.

Elementet formale të këtij lloji vendimi të ndërmjetëm huazohen dhe përdoren *mutatis mutandis* nga elementët e vendimit përfundimtar. Një model i dispozitivit të vendimit gjyqësor të kësaj natyre jepet në Shtojcën e këtij Manuali. Ndaj një vendimi të tillë mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit.

Së fundi, për këtë çështje duhet saktësuar se regjimi juridik i procesit gjyqësor të shqyrtimit të përmbushjes së kërkesave formale të ankimit vlen vetëm për ankimin e zakonshëm dhe jo për ankimin e veçantë. Ky i fundit depozitohet në gjykatën e shkallës së parë dhe përcillet drejtpërdrejt në Gjykatën e Apelit, së bashku me dokumentacionin tjetër, pa ushtruar një filtër procedural pranë gjykatës së shkallës së parë. Duket që në këtë rast nevoja për shpejtësi ka epërsi, sepse rastet e ankimit të veçantë karakterizohen nga urgjenca, të cilat i japin shkak edhe afatit shumë të shkurtër 5 ditor të ankimit të veçantë. Nga ana tjetër, një proces i tillë filtrimi paraprak, i ankimeshëm në mënyrë të veçantë në procedurën e paraqitjes së ankimeve të veçanta do të krijonte një zinxhir të turbullt ankimesh të veçanta.

3.1 Kundërankimi në Gjykatën e Apelit

Kundërankimi në Gjykatën e Apelit, në ndryshim nga kundërrekursi⁹¹, nuk rregullohet në mënyrë të posaçme nga LGJA, ndonëse ekzistenca e tij pranohet nga neni 49, pika 2 nuk parashikon në

mënyrë të shprehur kundërankimin, sipas të cilit, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. Në këtë situatë, vepron sërish neni 1, pika 2 dhe neni 44 i LGJA, në zbatim të të cilave rregullat e zbatueshme për kundërankimin në Gjykatën e Apelit gjenden në nenin 456 të K.Pr.Civile. Kjo dispozitë, e emërtuar “Ankimi kundërshtues”, parashikon se “Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankimi, mund ta kundërshtojë atë me kundërankim brenda 5 ditëve nga dita që ka marrë njoftim për ankimin e palës tjetër. Ankimi kundërshtues duhet t’u njoftohet palëve të tjera në gjykim, sipas rregullave për njoftimin e ankimit”. Prej këtij parashikimi deduktohet konkluzioni se ankimi kundërshtues në Gjykatën e Apelit, i njohur edhe si kundërankim apo si apel kundërshtues, ka të njëjtin regjim juridik me apelin. Për pasojë, të gjitha udhëzimet për ankimin dhe aktet që i bashkëlidhen atij janë të vlefshme edhe për kundërankimin. Kundërankimi mund të cilësohet si akti i fundit procedural që i bashkëngjitet dosjes gjyqësore, pasi është shqyrtuar në elementet e tij formale nga gjyqtari i vetëm në shkallë të parë.

Një çështje që kërkon vëmendje është situata e plotësimit të kërkesave formale të kundërankimit në afate të shkurtra kohore, procedurë e cila kryhet nga gjyqtari i vetëm në shkallë të parë. Në kushtet kur apeli kundërshtues është i lidhur me apelin, afatet e veprimeve procedurale të gjyqarit të vetëm marrin karakter përshpejtues. Neni 48 pika 1 të LGJA, urdhëron që dosja gjyqësore së bashku me aktet e ankimit duhet të përcillet në Gjykatën e Apelit, brenda 15 ditëve nga paraqitja e ankimit. Kjo nënkupton, që në rastin e paraqitjes së kundërankimit, gjyqtari brenda 15 ditëve, duhet të shqyrtojë të metat e ankimit, t’i japë afat gjer në 5 ditë ankuesit për plotësimin e të metave të mundshme, të shqyrtojë të metat e kundërankimit dhe t’i japë afat edhe kundërankuesit për plotësimin e të metave të mundshme. Rrjedhimisht, gjyqtari i vetëm duhet të veprojë sa më shpejt, të përdorë efektivisht kohën dhe të urdhërojë njoftime të menjëhershme të ankimit.

3.2 Ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit

Ankimi i veçantë, në thelb, është një instrument procedural me natyrë të jashtëzakonshme në raport me konceptin e procesit gjyqësor administrativ si një seri hapash të njëpasnjëshme procedurale të renditura kronologjikisht dhe që shërbejnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë pikëpamje, e drejta kushtetuese e ankimit e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës dhe e përpunuar në legjislacionin procedural synon të garantojë një kontroll efektiv të procesit gjyqësor nga një shkallë më e lartë gjykimi. Duke iu referuar këtij koncepti duket sikur ankimi i veçantë është i padobishëm sepse ‘djeg’ para kohe etapat e shqyrtimit në një shkallë më të lartë të disa çështjeve procedurale. Mirëpo, qëllimi i ekzistencës së ankimit të veçantë është krijimi i një ekuilibri të përshtatshëm për individin në një proces gjyqësor në drejtim të urgjencës, të ekonomisë gjyqësore dhe të sigurisë juridike. Çështjet, për të cilat ligji lejon ankim të veçantë janë të përcaktuara shprehimisht dhe mbulojnë situata urgjente (juridiksioni, sigurimi i padisë etj), zgjidhja e të cilave jo vetëm dikton zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, por mundësia e gjykatës për të gabuar në këto raste duhet verifikuar aty për aty, për të shmangur dëmin nga vonesa gjer në përfundimin e çështjes. Nga ana tjetër, vendosja e ankimit të veçantë për një grup të përcaktuar çështjesh

91 Shih nenin 59 të LGJA, që parashikon në mënyrë të shprehur regjimin juridik të kundërrekursit.

procedurale, ekonomizon edhe procesin gjyqësor sepse thjeshton procesin gjyqësor në shkallët më të larta. Kjo sepse çështjet procedurale, për të cilat lejohet ankimi i veçantë, nuk janë pjesë e ankimit të zakonshëm dhe rrjedhimisht, nuk janë pjesë e procesit gjyqësor që bazohet në ankimin e zakonshëm. Së fundi, ankimi i veçantë i shërben edhe sigurisë juridike të palëve ndërgjyqëse, sepse verifikimi aty për aty i tyre nga gjykata më e lartë, iu heq palëve gjendjen e pasigurisë, që mund t'i mbajë ato përgjatë gjithë procesit.

Në procesin e paraqitjes dhe të shqyrtimit të ankimit të veçantë ka një kufi të brishtë të zgjidhjes së çështjes procedurale urgjente me zgjidhjen e fakteve që lidhen me themelin e mosmarrëveshjes, i cili nëse shkelet rrezikon paragjykimin e vendimarrjes përfundimtare në shkallë të parë. Teorikisht, duhet që pjesë e ankimit të veçantë dhe e procesit të shqyrtimit të tij në Gjykatën e Apelit të jetë vetëm një segment procedural, por në praktikë ndodh që ky proces vështirësohet pasi merren në analizë edhe fakte të mbledhura dhe veprime procedurale të kryera në shkallë të parë, që i kanë paraprirë çështjes procedurale, që i nënshtrohet ankimit të veçantë.

Rastet, që i nënshtrohen ankimit të veçantë, të përcaktuara shprehimisht në LGJA, janë vendimi për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe për dërgimin e akteve organit kompetent⁹², vendimi për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj⁹³, vendimi për pranimin apo refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, si dhe vendimet për ndryshimin e tij⁹⁴, vendimi për kthimin e apelit kur të metat nuk janë plotësuar apo ndrequr brenda afatit⁹⁵, vendimi për kthimin e rekursit kur të metat nuk janë plotësuar apo ndrequr brenda afatit⁹⁶. Këtu duhet pasur kujdes sepse këto raste plotësohen edhe me ato të përcaktuara nga K.Pr.Civile, nëse vetë LGJA nuk parashikon ndryshe.

Një veçori procedurale e ankimit të veçantë në raport me ankimin e veçantë lidhet me mungesën e filtrimit paraprak të tij prej gjyqtarit të vetëm në shkallë të parë. Ankimi i veçantë vërtet depozitohet në gjykatën e shkallës së parë, por ai nuk i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit paraprak të elementëve formalë. Ankimi i veçantë i përcillet Gjykatës së Apelit dhe i takon kësaj gjykate të shqyrtojë elementet formale, si dhe thelbin e vetë ankimit të veçantë. Arsytet e këtij rregullimi të ndryshëm procedural lidhet me urgjencën që ka çështja, për të cilën ushtrohet ankimi i veçantë, si dhe me ekonomizimin e procesit gjyqësor, për të shmangur zinxhirin e ankimeve të veçanta njëri pas tjetrit⁹⁷.

Elementeve formale të ankimit të veçantë dhe dokumenteve që i bashkëngjiten atij, nuk iu kushtohet ndonjë rregullim i veçantë në LGJA. Rrjedhimisht, rregullat e vlefshme për ankimin e zakonshëm

92 *Shih* nenin 15/2 të LGJA. Ky vendim ankimohet me rekurs të drejtpërdrejtë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

93 *Shih* nenin 25/1, shkronja "a" të LGJA

94 *Shih* nenin 32/1 të LGJA. Ky vendim mund të merret në shkallë të parë dhe në këtë rast, bëhet fjalë për apel të veçantë, por nëse ky vendim merret nga Gjykata e Apelit, atëherë ankimi i veçantë bëhet në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

95 *Shih* nenin 46/3 të LGJA

96 *Shih* nenin 57/3 të LGJA

97 Nëse ankimi i veçantë do të ndiqte procedurën e shqyrtimit formal në shkallë të parë, atëherë vendimi i gjyqtarit të vetëm për kthimin e tij do të hapte një proces tjetër ankimi të veçantë.

janë të zbatueshme edhe për ankimin e veçantë në këtë drejtim.

4. Aktet e gjyimit në Gjykatën Administrative të Apelit

Në nenin 48 të LGJA gjenden detyrime të qarta e të sakta të cilat duhet të respektohen kryesisht nga administrata gjyqësore dhe jo nga trupa gjyqësore. Neni 48 në pikën 1 përcakton detyrimin e administratës gjyqësore për plotësimin korrekt të akteve, që do t'i përcillen Gjykatës Administrative të Apelit. Konkretisht bëhet fjalë për dosjen e plotë të gjyimit në shkallë të parë, ankimi së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, duke u kujdesur që këtu të përfshihet jo vetëm dokumentacioni që ka sjellë vetë ankuesi, por edhe dokumentacioni mbi pranueshmërinë (vendimi i gjyqtarit të vetëm). Po kështu, asaj i bashkëlidhet dokumentacioni i plotë mbi njoftimin e ankimit. Afati që ka në dispozicion administrata gjyqësore për përcjelljen e dosjes ankimore pranë Gjykatës së Apelit Administrativ është vetëm 15 ditë.

Me paraqitjen e dosjes gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit bëhet regjistrimi i saj dhe caktimi i trupit gjykues për gjykimin e çështjes. Ndarja e çështjeve bëhet me short, që në praktikë identifikon kryesuesin e trupit gjykues⁹⁸, pasi trupa gjyqësore e një gjykate organizohet në trupa gjykues njëherë në dy vjet nga kryetari i gjykatës⁹⁹.

4.1 Urdhri për caktimin e seancës

Në respektim të parimit të përshejtimit të procedurës gjyqësore dhe zbatimit strikt të afatit ligjor, brenda të cilit duhet të realizohet gjykimi në shkallë të dytë, një nga veprimet e para që kryen kryesuesi i trupit gjykues është caktimi i datës dhe orës së shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi. Akti, me të cilin kryesuesi cakton datën dhe orën e seancës në dhomë këshillimi, formalisht duhet të jetë urdhër, por në praktikë ai shfaqet edhe si vendim¹⁰⁰. Ky akt i shërben administrimit të mbarëvajtjes së procesit gjyqësor dhe ka natyrë të ndërmjetme. Ai është një akt procedural i brendshëm, që nuk iu njoftohet palëve në mënyrë integrale, por vë në lëvizje administratën gjyqësore për përpilimin e akteve të njoftimit drejtuar palëve. Ky lloj akti dokumenton respektimin e afateve nga kryesuesi i trupit gjykues dhe shërben për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tij ose, nëse është rasti, për të mbështetur pretendimet për zvarritjen e gjyimit.

Njoftimi i palëve realizohet të paktën 15 ditë para seancës në dhomë këshillimi dhe rregullat e tij ndjekin regjimin juridik të njoftimit të gjyimit civil në Gjykatën e Lartë me shpallje publike. Ky njoftim ka vlerë për dy çështje thelbësore, përse kohë që gjykimi në shkallë të dytë fillon dhe mund të përfundojë në dhomë këshillimi. Së pari, ai iu vlen palëve të njihen me përbërjen e trupit gjykues me synimin dhënien mundësi atyre të kundërshtimit eventual të përbërjes së gjykatës. Së dyti, ky njoftim iu vlen palëve që ato të paraqesin parashtrimet e nevojshme me shkrim.

98 *Shih* vendimin e KLD-së nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 "Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore", i ndryshuar.

99 *Shih* nenin 18, pikat 1 dhe 3 shkronja "b" të ligjit nr. 9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh", i ndryshuar.

100 *Shih* nenin 49, pika 2 të LGJA

4.2 Parashtrimet me shkrim të palëve

Një risi tjetër që paraqet LGJA, duke ruajtur prirjen e gjykit mbi dokumente, është edhe mundësia e palëve që në një afat deri 5 ditë para seancës në dhomë këshillimi të mund të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me çështjet e ngritura në ankim dhe kundërankim. Kjo mundësi parashikohet në nenin 49, pika 2 të LGJA. Ky rregull ligjor i shërben efektivitetit në gjykim; shpejtësia në gjykim, thjeshtësimi i procedurës, qartësia dhe saktësimi i pretendimeve dhe eliminimi i mundësisë që palët të abuzojnë me të drejtat e shumta procedurale që ofron gjykimi në seancë. Nga ana tjetër, ky rregull synon t'i shërbejë kontradiktoritetit në gjykim, i cili siç është pohuar vijimësisht nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese është një veçori thelbësore e procesit të rregullt ligjor. Kjo merr rëndësi të veçantë në gjykimin administrativ, pasi zhvillimi i gjykit në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh zbeh intensitetin e kontradiktoritetin mes palëve, pasi nuk lejon përballjen verbale aty për aty dhe vijuese midis palëve ndërgjyqëse, lidhur me çdo çështje, qoftë të procedurës, qoftë të thelbit mbi faktin apo normën materiale. Për këtë shkak, është e nevojshme që palët të kenë mundësi të garantuara për të shkëmbyer argumente, pasi thjesht shkëmbimi i ankimit dhe i kundërankimit brenda afateve të ngushta kohore menjëherë pas dhënies së vendimit që apelohet, vlerësohet i pamjaftueshëm. Në këtë pikëpamje, duke pasur kohë më të gjatë në dispozicion për përgatitjen e parashtrimeve, argumentet e palëve përditësohen dhe i bëhen të ditura Gjykatës së Apelit gjer në momentin e dhënies së vendimit prej saj.

Parashtrimet janë akte procedurale që hartohen nga palët, jashtë seancës gjyqësore, të ngjashme me kërkesë padinë apo kërkesat ankimore. Megjithatë, në raport me këto dy lloj aktesh procedurale, LGJA, përveç detyrimit për paraqitjen e tyre me shkrim, nuk vendos rregulla të ngurta formale për përpilimin e tyre. Në këtë kontekst ligjor, palët janë të lira të improvizojnë mbi ekstremitetet formalë dhe strukturën e një akti të tillë. Pa dyshim, që palët në hartimin e parashtrimeve duhet të përdorin gjuhë të qartë teknike, për të realizuar atë që neni 115 i K.Pr.Civile e parashikon për aktet të tilla si “forma më të dobishme për arritjen e qëllimit”, që nuk është gjë tjetër veçse realizimi i një mbrojtje sa më të mirë. Gjithashtu, parashtrimet duhet të hartohen në gjuhën shqipe (neni 116 i K.Pr.Civile). Së fundi, duhet evidentuar se elemente të tillë si koha, nënshkrimi dhe qartësia në përmbajtje duhet të karakterizojnë një akt të tillë, pasi përbëjnë të dhëna të domosdoshme për arritjen e qëllimit të tij, pasi dokumentojnë kohën e paraqitjes së tyre, janë akte që i përkasin një pale dhe kanë qëllimin e tyre, ndaj edhe shkelja e tyre shkakton pavlefshmërinë e parashtrimeve sipas nenit 119 të K.Pr.Civile. Një element tjetër që mund të tregohet në këto parashtrime është edhe kërkesa për përjashtimin e ndonjë anëtarit të trupit gjykues, përderisa kjo është një ngjarje që ndodh në ndërkohën midis paraqitjes së ankimit dhe paraqitjes së parashtrimeve. Si përfundim, për strukturën e parashtrimeve, rekomandohet të përdoret struktura e akteve të tjera të ngjashme si kërkesëpadija dhe kërkesa ankimore.

Lidhur me raportin që ekziston midis kërkesës ankimore dhe parashtrimit, duhet saktësuar se sipas nenit 49 të LGJA, parashtrimet mund të trajtojnë gjithçka brenda kufijve të jashtëm të përmbajtjes së ankimit apo të kundërankimit. Kjo do të thotë se me anë të parashtrimeve nuk

mund të zgjerohen shkaqet e ankimit p.sh. nga ndryshimi i vendimit për shkak të vlerësimit të gabuar të masës së shpërblimit dëmit të paraqitur në ankim të kërkohet në parashtrime ndryshimi tërësisht i vendimit dhe rrëzimi i padisë me pretendimin se padia nuk ka shkak ligjor. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se tek parashtrimet mund të zvogëlohet gama e kërkimeve të ankimit, deri edhe tek tërheqja e ankimit. Nga ana tjetër, në parashtrime nuk mund të kërkohen prova të reja, pasi kjo mundësi ekziston vetëm në kohën e paraqitjes së ankimit sipas nenit 47 të LGJA. Për pasojë, aktit të parashtrimeve nuk i bashkangjiten prova të llojit dokument. Këtu bën përjashtim kërkimi për përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues, që duhet të shoqërohet me dokumentet që mbështet pretendimin.

4.3 Relacioni i kryesuesit të trupit gjykues

Risia kryesore e gjykit administrativ është prirja e shndërrimit të tij në një gjykim të zhvilluar mbi dokumente, të dallueshëm nga gjykimet e tjera me natyrë verbale. Për këtë shkak, në faza të caktuara të procesit gjyqësor, veprimet procedurale që sigurojnë debatin gjyqësor ndihmohen nga akte me shkrim. Një akt i tillë është edhe relacioni që kryesuesi i trupit gjykues përpilon sipas nenit 49, pika 2 të LGJA. Ky akt procedural është produkt i kryesuesit të gjykatës, por që administrativisht paraprihet nga projekt-relacioni i përgatitur nga ndihmësi ligjor.

Kryesuesi i trupit gjykues, ndërkohë që sekretaria gjyqësore realizon njoftimin e palëve dhe pavarësisht këtij veprimi, kryen veprimet e dyta që janë detyrim për të, pra, përgatit relacionin për çështjen. LGJA nuk përmban një parashikim që t'i kushtohet posaçërisht strukturës dhe elementeve të relacionit. Rrjedhimisht, elementet e përmbajtjes së këtij akti mund të gjenden nga zbatimi *mutatis mutandis* i nenit 61/3, të ligjit nr. 8588/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, sigurisht duke bërë diferencën midis gjykit administrativ në Gjykatën e Apelit dhe gjykit në Gjykatën e Lartë. Ky relacion duhet të japë informacion të mjaftueshëm për anëtarët e tjerë të trupit gjykues, për të lehtësuar bisedimin për marrjen e vendimit. Për këtë qëllim, gjyqtari kryesues duhet të tregohet i përpikët në pasqyrimin e plotë të lëndës që është për t'u diskutuar në dhomë këshillimi. Nevoja për zhvillim të gjykit në mënyrë efikase dhe të përshpejtuar është një motivim i fortë për kryesuesin për të mos iu shmangur këtij detyrimi të nënkuptuar. Duhet theksuar se hartimi i relacionit nga kryesuesi i trupit gjykues nuk përjashton të drejtën e anëtarëve të trupit gjykues të konsultojnë drejtpërdrejt fizikisht aktet e dosjes gjyqësore.

Në relacion duhet të saktësohen përmbajtja e vendimit gjyqësor të ankimit, arsyet në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë në dhënien e tij, kërkimet e palëve për themelin e çështjes, pasqyrimi i rregullshmërisë procedurale të zhvillimit të procesit në shkallë të parë, tregimi i provave të shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë, baza ligjore e përdorur, përmbajtja e ankimit/kundërankimit, nëse ka paraqiten raste apo shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 51 i LGJA që do të përcaktonin kalimin në seancë gjyqësore, si dhe elemente të tjera, vlerësimi i të cilave mund të ndikojë Gjykatën e Apelit në marrjen e vendimit. Relacioni i kryetarit të trupit gjykues nuk

duhet të përmbajë sugjerime për zgjidhjen e çështjes apo mendim të tij mbi zgjidhjen e çështjes, siç ndodh me rastin e relacionit që realizohet përgjatë gjyqimit në Gjykatën e Lartë. Ky ndryshim e gjen arsyen tek fakti se çasti procedural i diskutimit në themel të çështjes zhvillohet përgjatë realizimit të seancës në dhomë këshillimi. Nga ana tjetër, kjo rrethanë shmang edhe paragjykimin e mundshëm të çështjes prej kryesuesit të trupit gjykues.

Në mënyrë të përmbledhur, relacioni duhet të shtjellojë tre kategori çështjesh:

1. Një përmbledhje të gjendjes procedurale të gjyqimit të zhvilluar në shkallë të parë. Këtu përshkruhen në perspektivë faktike hapat dhe veprimet procedurale të kryera, duke ndjekur rendin kronologjik dhe pa dhënë vlerësime për ligjshmërinë e tyre. Po ashtu, në këtë pjesë paraqiten edhe të dhëna faktike mbi ankimin apo kundërankimin e paraqitur, që japin informacion nëse ato janë të pranueshme për shqyrtim, si dhe paraqiten pretendimet e palëve në aktet e ankimit apo kundërankimit mbi procedurën e ndjekur në shkallë të parë;
2. Një përmbledhje e kuadrit faktik të mosmarrëveshjes, duke treguar edhe provat që mbështesin këto fakte në raport me sintezën faktike të bërë nga gjykata e shkallës së parë. Po ashtu, në këtë pjesë paraqiten edhe pretendimet e palëve në aktet e ankimit apo kundërankimit për faktet e pranuar në vendimin gjyqësor që ato ankimojnë. Qëllimi i kësaj pjese të relacionit është njohja e anëtarëve të trupit gjykues me mospërputhjet e mundshme faktike të provave të administruara me ato të pranuar nga gjykata e shkallës së parë;
3. Një përmbledhje e kuadrit ligjor të zbatueshëm. Në këtë pjesë relacioni sqaron se cila është norma ligjore e zbatuar nga gjykata e shkallës së parë në zgjidhjen e çështjes konkrete dhe si është interpretuar ajo, për të informuar trupin gjykues mbi saktësinë e zbatimit të ligjit. Gjithashtu, në këtë pjesë paraqiten edhe pretendimet e palëve në aktet e ankimit apo të kundërankimit, mbi saktësinë e zbatimit të ligjit nga gjykata e shkallës së parë.

Në drejtim formal, relacioni përbën një akt procedural autonom, i formës së shkruar dhe i nënshkruar nga kryesuesi i trupit gjykues. Ai përmban kohën e hartimit, që dokumenton se është hartuar përpara zhvillimit të seancës në dhomë këshillimi dhe që iu mundëson anëtarëve të trupit gjykues ta konsultojnë brenda një afati të arsyeshëm përpara seancës në dhomë këshillimi. Relacioni bëhet pjesë e dosjes gjyqësore.

4.4 Procesverbali i dhomës së këshillimit

Në nenin 49 prashikohet një tjetër akt që përpilohet gjatë gjyqimit në shkallë të dytë. Bëhet fjalë për procesverbalin e dhomës së këshillimit. Ka një përshtypje të pasaktë në praktikë se në dhomën e këshillimit nuk mbahet procesverbal sepse ngatërrohet me mungesën e palëve në seancë. Kjo ndodh pasi terminologjia “dhomë këshillimi” përdoret edhe gjatë fazës së bisedimit të çështjes mes gjyqtarëve për marrjen e vendimit, që është fazë e vendimarrjes përfundimtare të gjykatës. Duhet saktësuar se në nenin 49 të LGJA nuk bëhet fjalë që seanca të zhvillohet vetëm me praninë e gjyqtarëve, pra, anëtarëve të trupit gjykues. Seanca zhvillohet edhe me praninë e sekretarisë

gjyqësore. Kjo procedurë e “dhomës së këshillimit” është fazë e gjyqimit dhe jo fazë e marrjes së vendimit. Neni 49, pika 3 i LGJA përcakton në mënyrë të shprehur detyrimin për mbajtjen e procesverbalit të seancës në dhomë këshillimi nga sekretari gjyqësor dhe qëllimi i tij është dokumentimi i menjëhershëm i veprimeve procedurale që kryen gjykata në zhvillimin e seancës në dhomë këshillimi.

Procesverbali i dhomës së këshillimit është i ngjashëm me procesverbalin e mbajtur në gjykimin në shkallë të parë, qoftë në veprimet përgatitore, qoftë në seancë gjyqësore. Për këtë arsye, informacioni i dhënë mbi elementet formale të procesverbalit në shkallë të parë janë të vlefshme edhe për këtë rast.

4.5 Vendimi në dhomë këshillimi

Gjykimi administrativ është ravijëzuar si një proces gjyqësor mbi dokumente, i cili për këtë arsye si rregull zhvillohet dhe përfundon me seancë në dhomën e këshillimit. Rrjedhimisht, vendimi gjyqësor që jepet nga Gjykata e Apelit, sipas kësaj procedure zë numrin më të lartë të rasteve të përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në shkallë të dytë.

Vendimi gjyqësor i dhënë në dhomë këshillimi, duhet të përmbajë të gjitha elementet formale të vendimit gjyqësor përfundimtar, siç përcaktohen nga neni 310 i K.Pr.Civile i kombinuar me nenin 41 të LGJA. Informacion më i plotë për elementët formalë të vendimit gjyqësor jepen tek vendimi i gjykatës administrative.

Lidhur me vendimin gjyqësor në dhomë këshillimi duhet theksuar se sipas neneve 50 dhe 51 të LGJA, ai mund të jetë: (1) vendim përfundimtar mbi themelin e mosmarrëveshjes; (2) vendim jo përfundimtar, që e përfundon procesin në shkallë të dytë por nuk jep zgjidhje të themelit të çështjes; ose (3) vendim i ndërmjetëm, me natyrë procedurale, që e transformon procedurën e gjyqimit nga ajo e dhomës së këshillimit në seancë gjyqësore publike, me pjesëmarrjen e palëve.

Në shkronjën “a” të nenit 50 të LGJA jepet alternativa e vendimit në dhomë këshillimi për *mospranimin e ankimit*. Çështja e parë që shqyrtohet nga Gjykata e Apelit nuk është analiza e vendimit gjyqësor apo analiza e procesit gjyqësor të shkallës së parë. Fillimisht, Gjykata e Apelit analizon vetë kërkesën ankimore. Në këtë fazë, Gjykata e Apelit kryen të njëjtën veprimtari me atë që ka kryer gjyqtari i vetëm i shkallës së parë, teksa ka analizuar pranueshmërinë e ankimit. Pra, LGJA ka krijuar edhe një mundësi të dytë, për të shqyrtuar pranueshmërinë e ankimit, edhe pse ky filter është ushtruar nga gjykata e shkallës së parë. Kur Gjykata e Apelit jep vendim mospranimi, gjykimi në shkallë të dytë përfundon.

Nëse ankimi është i pranueshëm për shqyrtim, Gjykata e Apelit vijon me vlerësimin e lamenteve procedurale të procesit gjyqësor të zhvilluar në shkallë të parë për të identifikuar nëse ka të meta të tilla që prekin vlefshmërinë e tij me pasojë pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor të ankimit.

Në varësi të këtyre të metave, Gjykata e Apelit, sipas nenit 50 shkronjave “ç” dhe “d” mund të vendosë *prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim ose prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit*. Në rastin e prishjes së vendimit dhe kthimit të çështjes për rigjykim duhet të identifikohet një shkelje procedurale e rëndë me pasojë pavlefshmërinë e vendimit të dhënë në shkallë të parë. Në rastin e prishjes së vendimit dhe pushimit të gjykimit bëhet fjalë për rrethana që nuk lejojnë ngritjen e padisë apo vazhdimin e gjykimit.

Një lloj tjetër vendimi që jep Gjykata e Apelit në dhomë këshillimi është *vendimi përfundimtar mbi themelin* e mosmarrëveshjes. Ky lloj vendimi merret kur kushtet e pranueshmërisë të ankimit janë plotësuar, si dhe kur procesi gjyqësor i zhvilluar në shkallë të parë nuk ka shkelje procedure që prekin vlefshmërinë e vendimit. Në këtë rast, Gjykata e Apelit vlerëson drejtësinë e vendimit të dhënë në shkallë të parë në pikëpamje të faktit dhe të ligjit material të zbatuar. Alternativat e vendimmarrjes së saj janë lënia në fuqi e vendimit të ankimit, ose ndryshimi i tij i plotë, apo i pjesshëm.

4.6 Aktet për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore

Vendimi i gjykatës në dhomë këshillimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore është vendim i ndërmjetëm. Procesi gjyqësor nuk përfundon, por ndryshon procedura e gjykimit nga dhoma e këshillimit në seancë publike me pjesëmarrjen e palëve. Rrjedhimisht, ky lloj vendimi përmban elementet formale të një vendimi të ndërmjetëm, ku caktohet data dhe ora e seancës gjyqësore. Data e seancës gjyqësore duhet të caktohet jo më shpejt se 10 ditë, pasi ky vendim iu njoftohet palëve përkatëse, të cilat duhet të kenë kohën e duhur për t’u përgatitur për pjesëmarrje në seancë gjyqësore publike.

Gjithashtu, në vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore duhet të arsyetohet shkaku i ligjor, duke treguar të dhënë faktike konkrete të tij. Shkaqet për marrjen e një vendimi të tillë listohen në pikën 1 të nenit 51 të LGJA. Ato lidhen me të meta procedurale (me përjashtim të atyre të metave të rënda që passjellin pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor), me marrjen e provave të reja që nuk janë shqyrtuar në shkallë të parë apo me vlerësimin e Gjykatës së Apelit se procesi gjyqësor duhet të përsëritet plotësisht, apo tërësisht.

Njoftimi i palëve për përmbajtjen e vendimit të kalimit të çështjes në seancë gjyqësore është veprim procedural, i cili realizohet prej administratës së gjykatës, pra, sekretarisë së saj. Kërkesat formale që duhet të përmbushë një veprim i tillë janë të njëjta si edhe për njoftimet e tjera. LGJA, për këtë lloj njoftimi përcakton tre elemente të domosdoshme: vendimi, data e seancës dhe ora e seancës.

5. Kërkesëpadia kundër aktit normativ

Një prej risive më reformatore që prezanton LGJA është pranimi pothuajse i plotë i kontrollit

gjyqësor ndaj akteve normative nënligjore. Rregullat mbi kontrollin gjyqësor të akteve nënligjore normative është dëshmia më e fortë e ridimensionimit jo vetëm të rolit të gjykatës administrative, por mbi të gjitha të marrëdhënies gjykatë-administratë publike dhe që shkon ende më tej në marrëdhënien midis pushtetit gjyqësor dhe pushtetit ekzekutiv, apo deri edhe me pushtetin legjislativ. Në këtë mënyrë, vetë parimi bazë kushtetues i ndarjes dhe i ekuilibrit të pushteteve¹⁰¹ merr një kuptim të ri.

Ligjvënësi, me miratimin e LGJA ka qenë i kujdesshëm në ndërfutjen e këtij instituti të ri. Së pari LGJA, e tashmë edhe Kodi i ri i Procedurave Administrative, në konceptin e “veprimit administrativ” kanë përfshirë edhe aktin nënligjor normativ. Së dyti, kontrolli gjyqësor i akteve normative i besohet një trupi gjykues me 5 anëtarë, që tregon se çështja ka nevojë për maturi dhe cilësi në vendimmarrje, pasi teksa kontrollohet një akt nënligjor normativ (i cili ka karakteristika të dallueshme nga akti administrativ individual) më tepër sesa gjykohet një shkelje konkrete e të drejtave të individit (këto në rastin e aktit normativ nënligjor, me gjasë nuk ndodhin aty për aty) gjykohet në fakt një vullnet politik, pasi gjykohet kompetenca rregullatore e organeve më të larta shtetërore. Këto janë arsytet pse kjo procedurë i është besuar Gjykatës së Apelit me një trup gjykues të përbërë me 5 gjyqtarë. Së fundmi, LGJA ka përcaktuar me kujdes edhe kufijtë e shqyrtimit të aktit normativ nënligjor dhe të llojit të vendimit eventual që jep gjykata.

Fillimisht duhet shpjeguar koncepti *i aktit nënligjor normativ*. Sipas LGJA¹⁰², përbërësi tjetër i “aktit administrativ” është ai që emërtohet si “akti nënligjor normativ”. Në ligj përkufizohet si vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij. Kjo nënkategori e aktit administrativ, dallon nga “akti administrativ individual” lidhur me dimensionin e shkakimit të pasojave dhe dimensionin e subjekteve të cilët preken nga efektet e tij. Përsa i përket shkakimit të efekteve, një akt i tillë, nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta e me ndikim të menjëhershëm ndaj rasteve juridike të individëve, por do duhet të nxirret më tej një akt administrativ individual në zbatim të tij, që këto pasoja të ndodhin realisht. Paralelisht me këtë natyrë të efekteve dhe për shkak të saj, numri i destinatarëve të cilëve iu kundrejtohet një akt i tillë, është i pacaktueshëm. Kjo për shkak edhe të karakterit që ka, si një akt që përcakton rregulla të përgjithshme sjelljeje.

Doktrina njih edhe një kategori të ndërmjetme aktesh midis atyre me natyrë administrative individuale dhe atyre normative nënligjore. Ato janë aktet administrative të përgjithshme, të cilat nuk kanë destinatarë individualisht të përcaktuar, që i bën të ngjashëm me aktet normative. Nga ana tjetër, këto akte dallojnë nga aktet normative sepse nuk përbëjnë burime të së drejtës. Për ilustrim, akte të tilla janë planet rregulluese urbanistike. Përmbajtja e “përgjithshme” ose “normative” e akteve nuk eliminon natyrën e tyre si veprime administrative. Këto akte nxirren në përfundim të një procedimi administrativ, ato mund të ankimohen para gjykatës administrative

101 Shih nenin 7 të Kushtetutës

102 Shih nenin 2 pikat 1 dhe 3 të LGJA

dhe mund edhe të shfuqizohen nga ajo, mund të mos zbatohen p.sh. nga gjyqtarët e zakonshëm në proceset civile, janë subjekt i shfuqizimit kryesisht ose revokimit e kështu me radhë. Në disa aspekte regjimi juridik i tyre dallon nga ai i veprimeve të tjera administrative. Për ilustrim, për shkak të parashikimeve të shprehura në ligj, për këto lloj aktesh nuk kërkohet arsyetim¹⁰³. Nga ana tjetër, pikërisht për shkak të përmbajtjes së tyre të përgjithshme, në më të shumtën e rasteve këto akte nuk goditen në mënyrë autonome para gjykatës administrative, sepse nuk cenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e personave privatë. Këtu bën përjashtim rasti i padisë kolektive, që ka si objekt të saj akte të këtij lloji, por edhe në këto raste kërkohet një arsyetim mbi interesin e ligjshëm. Zakonisht ato ankimohen në mënyrë të përbashkët me aktin që i vë në zbatim ato. Edhe pse aktet e përgjithshme dhe ato normative kanë destinatarë të papërcaktuar, përmbajtja e tyre është unitare dhe ky tipar i dallon ato nga aktet administrative të shumfishta. Për pasojë shfuqizimi i tyre përcakton edhe humbjen e efekteve të tyre ndaj të gjithë destinatarëve, duke përfshirë, në rastin e shfuqizimit gjyqësor edhe ata që nuk kanë marrë pjesë në procesin gjyqësor.

Në procesin e përkufizimit të aktit normativ nënligjor është e rëndësishme që diskutimi të mos shtrihet në nivel kushtetues, apo më saktë akoma tek burimet e së drejtës. Studimi i burimeve të së drejtës i takon së drejtës kushtetuese. Kjo merr shkas jo vetëm nga fakti se termi “akt normativ” përfshin konceptin akt normativ nënligjor, por më së shumti nga çështje që kanë të bëjnë me themelin dhe me kufijtë e pushteteve normative të administratës publike dhe nga tipologjitë e burimeve dytësore të së drejtës, pasi aktet nënligjore normative konsiderohen si burime të së drejtës prej Kushtetutës. Tek ky trajtim me sfond kushtetues duhet mbajtur parasysh nga njëra anë se Kushtetuta, teksa bën një parashikim të përgjithshëm të akteve normative, pra, të pushtetit rregullator apo normativ në Republikën e Shqipërisë, në nenin 116 bën një shpërndarje të këtij pushteti normativ midis pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, sepse iu njeh edhe organeve të qeverisjes vendore të nxjerrin akte rregullatore normative. Kufizimi i vetëm është vetëm ai territorial përse i përket fuqisë juridike të këtyre lloj akteve. Veç kësaj, një pushtet i tillë iu njihet edhe “institucioneve të tjera qendore”, kufizimi i vetëm i të cilave përse i përket fuqisë juridike të tyre është vetëm i karakterit “sektorial”, pra i “fushës” që ata mbulojnë. Akte të tilla kanë detyrimin e botimit të tyre në Fletoren Zyrtare, që lidhet me hyrjen në fuqi.

Një tjetër veçori e regjimit të akteve normative nënligjore rrjedh edhe për shkak të risive të ndërfutura në mënyrë të shprehur prej rregullimit ligjor të gjykimit administrativ. Konkretisht, LGJA¹⁰⁴ parashikon përjashtim të tyre nga kuadri ligjor i zbatueshëm, nëse vërehet nga gjykata dhe duhet arsyetuar se një akt i tillë normativ nënligjor është i paligjshëm, edhe nëse nuk është ankimuar nga kërkuesit në proces.

Tek *kontrolli gjyqësor i akteve normative nënligjore*, çështja e parë dhe më e brishtë që duhet sqaruar është ndarja e juridiksionit gjyqësor administrativ nga juridiksioni gjyqësor kushtetues.

¹⁰³ Këtu nuk bëhet fjalë për relacionin shpjegues të një akti të tillë, që i paraprin procesit të miratimit dhe që është një dokument që shpjegon qëllimin e aktit nënligjor normativ për të lehtësuar procesin e vendimmarrjes dhe si i tillë nuk e shoqëron me botim aktin nënligjor normativ.

¹⁰⁴ *Shih* nenin 38 të LGJA për gjykimin incidental

Vendosja e këtij kufiri është detyrim në zbatim të nenit 131, shkronja “c” të Kushtetutës, sipas të cilit “Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore apo vendore me Kushtetutën” dhe të nenit 8, shkronja “a” të LGJA, sipas të cilit “Gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese”. Këto dy parashikime janë në harmoni me njëri-tjetrin, por njëherazi flasin për nevojën e vendosjes së kufirit midis juridiksioneve.

Aktet nënligjore normative, sipas teorisë kushtetuese në pikëpamje hierarkike pozicionohen poshtë Kushtetutës dhe poshtë ligjit. Elementet kushtetuese që duhet të përmbushë akti nënligjor dhe që shkelja e tyre jep shkak për një gjykim kushtetues, gjenden në nenin 118 të Kushtetutës: (1) akti nënligjor, duhet të jetë i autorizuar nga Kushtetuta; (2) ligji duhet të përcaktojë llojin e aktit nënligjor; (3) ligji duhet të caktojë çështjet që duhen rregulluar me akt nënligjor; dhe (4) ligji duhet të caktojë parimet, bazuar tek të cilat nxirret akti nënligjor. Megjithatë, shkelja e kësaj dispozite Kushtetuese nuk është shkak i vetëm për goditjen e akteve nënligjore në Gjykatën Kushtetuese, raste të tilla mund të lidhen edhe me norma të tjera të shpërndara në Kushtetutë. Në një situatë të ndërlidhur për mosmarrëveshje juridiksionale, mund të ndodhë që një akt nënligjor normativ të mund të prezantojë paralelisht edhe mangësi të nivelit kushtetues, duke qenë në kundërshtim drejtpërdrejt me Kushtetutën dhe njëkohësisht edhe mangësi të nivelit ligjor, duke qenë në kundërshtim me ligjin. Në një rrethanë tjetër, mund të ndodhë që një akt nënligjor të paraqesë defekt kushtetues për shkak se ligji, në bazë të të cilit ai ka dalë është antikushtetues. Ndërsa në një rrethanë tjetër, akti nënligjor mund të jetë në përputhje me Kushtetutën, por përmban defekt ligjor. Elementet kryesore të paligjshmërisë të një akti nënligjor nxirren nga interpretimi i nenit 37, pikat 3 dhe 4 të LGJA, që janë: (1) akti nënligjor duhet të jetë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit; (2) akti nënligjor të vendosë rregulla vetëm për të arritur qëllimin e ligjit dhe (3) rregullat e vendosura nga akti nënligjor, nëse cenojnë interesa të ligjshme, të jenë në raport të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Neni 8 i LGJA synon të shmangë maksimalisht mosmarrëveshjen e juridiksioneve, pasi përcakton ndalimin e gjykatave administrative të shqyrtojnë “mosmarrëveshjet” për aktet nënligjore që janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë, kur me anë të një kërkesëpadie kërkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë antikushtetutshmëria e një akti nënligjor, duke u shprehur tërësisht nga “kërkimi i paligjshmërisë” së tij është fare e qartë se gjykata administrative nuk ka kompetencë për shqyrtimin e saj. Kjo do të thotë se në shkallë të parë është vetë pala kërkuese që ndan juridiksionin kushtetues nga juridiksioni i gjykatave administrative nga thelbi i kërkimit, me të cilin i drejtohet gjykatës. Si përfundim dhe në zbatim të neneve 8, shkronja “a” dhe 38, pikat 3 dhe 4 të LGJA, gjykatat administrative kanë juridiksion gjyqësor mbi aktet normative nënligjore vetëm për çështje të ligjshmërisë, që nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

Ky saktësim është i rëndësishëm edhe përse i përket përmbajtjes formale, edhe thelbit të kërkesëpadiës që paraqitet në Gjykatën Administrative të Apelit për kundërshtimin e një akti nënligjor normativ. Kështu, në *objektin e kërkesëpadiës* duhet të kërkohet vetëm paligjshmëria;

kundërshtia që akti nënligjor ka me ligjin, në bazë apo për zbatim të të cilit është nxjerrë.

Përsa i përket arsytimit të parashtruar në kërkesëpadi, duhet sqaruar se kërkesat në këtë rast nuk janë të njëjta me kërkesëpadinë ndaj aktit administrativ individual. Konkretisht, kushti që ka lidhje me *legjitimitimin aktiv* është i ndryshëm. Në kërkesëpadinë ndaj aktit administrativ individual kërkohet që paditësi të pohojë dhe të sjellë prova në gjykim, që ai është mbajtës (titullar) i një të drejtë subjektive. Në rastin e kërkesëpadi ndaj aktit nënligjor normativ nuk kërkohet vetëm pohimi i të drejtave subjektive të atyre që janë palë paditëse, pra, nënshkrues të kërkesëpadi apo pjesëtarë të shoqatës që është prezantuar si paditëse, por njëherazi duhet të provohet ekzistenca e një interesi publik siç parashikon neni 15, pika 1 shkronja “c” e LGJA. Me fjalë të tjera, në këtë rast duhet të pohohet se ligji, në bazë ose për zbatim të të cilit është nxjerrë akti nënligjor që kundërshtohet, iu jep të drejta subjektive një numri të pacaktuar individësh.

Interesi publik sipas një konceptimi parimor, nuk është gjë tjetër, veçse bashkësia e interesave individuale apo “pjesë” të këtyre interesave individuale që kanë një lidhje apo ngjashmëri mes tyre. Bashkimi i këtyre pjesëve në përmasa sasiore relevante e shndërron interesin individual në interes publik. Bëhet fjalë këtu pikërisht për ato të drejta apo ato liri, që ligji i merr në mbrojtje. Interesi publik është një nga konceptet doktrinare më të vështira. Ai nuk mund të identifikohet me interesin mesatar të kolektivit sepse një qasje e tillë mohon të drejtën individuale. Koncepti kushtetues i interesit publik është mjaft i gjerë. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese rastet e interesit publik ose të arsyes publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit konkret¹⁰⁵. Në këtë situatë, interesi publik identifikohet tek ligji që normon një sektor të caktuar, duke kufizuar të drejtat individuale. Parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe i mbrojtjes së të drejtave të personave privatë e kushtëzon gjyqtarin administrativ që në gjykimin administrativ të zbatojë parimin e ekuilibrit të të drejtave, që është një teknikë e përgjithshme për zgjidhjen e çështjeve ku rezulton një kundërshti midis të drejtave. Ekuilibrimi i saktë i interesit publik me të drejtat individuale nuk është gjë tjetër veçse procesi i vënies së kufirit të saktë midis të drejtës që garanton ligji për një individ me përjashtimet nga kjo e drejtë, të justifikuar nga interesi publik. Për këtë shkak, ai ka rëndësi kyçe në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykatat administrative. Nga njëra anë, ai vë në jetë efektivisht të drejtat që i jepen individit në një shtet demokratik, por nga ana tjetër mundëson të analizohet legjitimiteti i veprimit që ka ndërmarrë organi publik në zgjedhjen e tij. Kjo pjesë e fundit e procesit krijon vështirësi për gjyqtarin, duke e vënë në rrethana edhe të vështira të debatit publik, por që gjithësesi nevoja për paanshmëri në proces duhet të mbizotërojë.

Në kushtet kur interesi publik është i ndryshëm nga interesi individual, legjitimitimin procedural në ngritjen e padisë nuk e ka një individ i vetëm, por një grup individësh i strukturuar në formën e një shoqate apo i bashkuar në mënyrë episodike në një rast të vetëm. Është fjala këtu për “padinë kolektive” e njohur në doktrinë edhe si *actio popularis*.

Përsa i përket interesit të ligjshëm, kërkesë e domosdoshmë kjo për ushtrimin e padisë, ka përsëri një ndryshim. Në rastin e aktit administrativ individual kërkohet që në kërkesëpadi të pohohet se faktikisht ka ndodhur, pra, është verifikuar një cenim konkret i së drejtës subjektive të paditësit. Në rastin e padisë ndaj aktit nënligjor normativ kërkohet të provohet se akti nënligjor normativ teorikisht do të sjellë në të ardhmen cenim të interesave individuale sepse ardhja e efekteve individuale si rregull konkretizohet pasi një akt tjetër individual do të dalë në bazë të aktit nënligjor normativ të kundërshtuar. Thënë ndryshe, dëmi në rastin e padisë kundër aktit nënligjor normativ nuk është i përcaktuar, por është i përcaktueshëm.

Lidhur me elementet e tjera formale, një kërkesëpadi e tillë, duhet të prezantohet si paditësi një shoqatë ose në mënyrë individuale anëtarët e një grupi interesi, që në formën e vet më të thjeshtë është një bashkësi e paformalizuar individësh. Këta të fundit duhet të pohojnë dhe të vërtetojnë në gjykim që janë bartës të interesit publik të cenuar sipas tyre. Në rastin e *actio popularis*, pala që ngre padinë nuk është domosdoshmërisht titullare apo mbajtëse e të drejtës subjektive, që është cenuar apo pretendohet të jetë cenuar. Në këtë rast, titullar i të drejtës subjektive është publiku, i kuptuar si tërësia e subjekteve individuale. Ndërkohë që legjitimohet ta mbrojë këtë interes të ligjshëm para sistemit gjyqësor një pjesë e publikut, i organizuar në formën e një shoqate ose në formën e një grupi interesi. Shoqata¹⁰⁶ duhet të ketë në objektin e saj mbrojtjen apo zhvillimin e të drejtave, që lidhen me interesin që është cenuar. Pjesëmarrësit e grupit të interesit duhet të tregojnë se janë një bashkim individësh, që karakterizohen nga i njëjti interes i përbashkët përpara të njëjtës gjendje juridike. Veç kësaj dhe në harmoni me konceptin *actio popularis*, një cenim i interesit publik mund të verifikohet nga një akt rregullator i natyrës së përgjithshme, siç është një akt normativ apo edhe nga një akt administrativ i përgjithshëm siç është miratimi i një plani apo studimi urbanistik.

Për elementet e tjera të kërkesëpadi për aktin nënligjor normativ zbatohen *mutatis mutandis* rregullat për kërkesëpadinë që paraqitet në shkallë të parë në gjykatat administrative, të cilat janë shpjeguar në Kapitullin II të këtij Manuali.

105 Shih vendimin nr. 4/2011 të Gjykatës Kushtetuese

106 Sipas nenit 39 të K.Civil, shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj.

4 KËSHILLA PRAKTIKE MBI HARTIMIN E AKTEVE PROCEDURALE

Aktet procedurale të paraqitura nga palët në ecurinë e një procesi gjyqësor paraqesin rëndësi si në formë edhe në përmbajtje të tyre. Ndonëse përcaktuese në vlerën që akti prezanton përpara gjykatës është përmbajtja e tij, saktësia argumentuese e të cilit e bën ose jo të pranueshëm aktin para gjykatës, forma e hartimit të aktit mbart vlerat e saj që kapërcejnë kornizën estetike të një dokumenti zyrtar.

Ky parashtrim lidhet me nevojën për të përpiluar një kërkesë procedurale duke respektuar disa rregulla standarde drejtshkrimore, që e prezantojnë atë me dinjitet dhe i japin lehtësi administrimi në morinë e shumë dokumenteve të përditshme të punës së gjykatës. Në vijim jepen disa këshilla praktike mbi uniformitetin e stilit në të shkruarit e akteve procedurale.

Stili i shkrimit elektronik

Kur palët vlerësojnë t'i kërkojnë gjykatës të shprehet mbi një çështje të caktuar, dokumenti që depozitohet duhet të jetë i njehsuar në tërësinë e tij me të njëjtin lloj shkrimi, si p.sh. Times New Roman, në madhësi "12" dhe me hapësirë midis rreshtave midis vlerave 1 – 1.5. Paragrafet duhet të jenë të barazlanguara në të gjithë tekstin dhe po kështu faqet të jenë të barazlanguara nga skajet e fletës.

Në çdo rast ka rëndësi që shkrimi në formë elektronike të jetë i njëjtë në të gjithë përmbajtjen e dokumentit. Procedura civile nuk ndalon aktin procedural të sjellë nga palët me dorëshkrim, por kjo metodë nuk haset më në praktikën gjyqësore, as rekomandohet si e përshtatshme.

Së fundmi, sugjerohet të bëhet kujdes me theksimin e paragrafëve, fjalive dhe fjalëve, ku duhet të shmanget përdorimi i tepërt i tyre si p.sh. thonjëzat, nxirja e pjesëve të caktuara të tekstit, nënvizimit apo ndonjë metodë tjetër. Nëse zgjidhen paragrafë apo fjali të tëra për t'u theksuar humbet rëndësia e theksimit.

Gjuha e aktit të shkruar

Aktet procedurale hartohen në gjuhën shqipe¹⁰⁷, ndaj përdorimi i fjalëve të huazuara (barbarizmave) duhet të shmanget, me përjashtim të shprehjeve që mbartin rëndësi jurisprudenciale mbi një institut të së drejtës. Gjithashtu, në rastin e përdorimit të shprehjeve latine duhet bërë kujdes në dy drejtime. Së pari, shprehja duhet përdorur saktësisht sipas kuptimit të saj. Së dyti, sugjerohet që të shmanget përdorimi i tepruar i tyre sepse rrezikon të ngarkojë tekstin e aktit.

SHEMBULL: "*res judicata*" mbi parimin e gjësë së gjykuar apo "*restitutio in integrum*" mbi konceptin e kompensimit e plotë janë shprehje të përdorshme në tekstet e dokumenteve zyrtare, në literaturë juridike dhe si të tilla të pranueshme edhe në aktet procedurale.

107

Neni 116 i K.Pr.Civile, paragrafi i parë

Rregullat e shkrimit ligjor

Gjuha shqipe në aktet procedurale, duhet të jetë pikërisht gjuha e përdorur nga ligji, në dy aspekte të tij:

1. **Nga pikëpamja e rregullave drejtshkimore**, si e atyre të morfologjisë dhe sintaksës të cilat i përkasin gjuhës letrare dhe jo asaj mbi baza dialekti krahinor¹⁰⁸. Gabimet ortografike kur janë të shpeshta, ia ulin seriozitetin punës së bërë dhe teksti bëhet i paqartë gjatë të lexuarit. Po ashtu, në kushtet e zhvillimit të sotëm të teknologjisë së informacionit është e domosdoshme që në shkrimin e akteve të përdoren të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, pra, edhe shkronjat “ë” dhe “ç” të cilat rëndom zëvendësohen me “e” dhe “c”. Një çështje tjetër lidhet me shkurtimet e fjalëve, të cilat nuk duhet të zënë vend në një tekst ligjor sepse japin përshtypjen e dembelizmit të tepruar dhe të pasaktësisë së dokumentit, përveçse vështirësojnë edhe kuptimin e aktit.

SHEMBULL: akti adm. (kupto akti administrativ) apo përgj. civile (kupto përgjegjësia civile). Në rastin e përdorimit të akronimeve, duhet që në përdorimin e parë të shprehjes të jepet akronimi në kllapa dhe më pas në tekst mund të vijohet me akronimin.

2. **Nga pikëpamja e terminologjisë juridike të dhënë nga legjislacioni parësor dhe ai dytësor** pa ndryshuar kuptimin e koncepteve të së drejtës procedurale dhe materiale me fjalë me kuptim të afërt me to.

SHEMBULL: nëse ligji shprehet “padia e kërimit të sendit”, padia e rivendikimit¹⁰⁹ jep të njëjtin kuptim me të dhe gjen trajtim teorik në të drejtën civile, por do të ishte më mirë që në hartimin e një akti procedural të përdorej shprehja tekstuale e ligjit. Po kështu, në të drejtën procedurale, termi “shfuqizim i aktit administrativ” mbi paligjshmërinë relative të aktit është përdorur nga LGJA në përjasje të plotë me K.Pr.Administrative, duke nxjerrë nga fjalori i ligjit termin “anulim”, i përdorur më parë nga doktrina dhe K.Pr.Civile¹¹⁰.

Së fundi, por jo nga rëndësia, aktet procedurale duhet të kenë madhësi standarde dhe të pasqyrohen në format teksti elektronik A4, me përjashtim kur natyra e aktit kërkon një tjetër tipologji dokumenti, siç janë p.sh. tabelat analitike apo pamjet fotografike, të cilat mund të kërkojnë të paraqiten si dokumente të pëmasave të tjera.

¹⁰⁸ Shih për këtë botimin “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, 1973 i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë

¹⁰⁹ Neni 548 i Kodit Civil i referohet shprehimisht padisë së rivendikimit

¹¹⁰ Neni 331 i K.Pr.Civile (dispozitë e shfuqizuar), që përcaktonte: “Gjykata në vendimin e saj përfundimtar vendos:...- anulimin pjesërisht ose tërësisht të aktit administrativ...”

SHTOJCË MODELE TË AKTEVE PROCEDURALE

MODEL I NJË OPINIONI LIGJOR TË NDIHMËSIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË/E APELIT

OPINION LIGJOR

Drejtuar: Gjyqtarit (*emri, mbiemri*)

Përgatitur: Ndihmësi ligjor (*emri, mbiemri i ndihmësit ligjor*)

Lënda: Mbi konceptin _____

Data: _____ dita/muaji/viti

(*Shpjegimi i temës*). Me urdhrin e datës dd/mm/vvvv, më është kërkuar përgatitja e opinionit ligjor mbi konceptin _____, në funksion të gjyqimit të çështjes gjyqësore (*atributet e çështjes*). Në këtë çështje gjyqësore, në mënyrë të përmblodhur janë diskutuar faktet e mëposhtme (*përshkrimi i fakteve nën dritën e konceptit që kërkohet*).

Ky koncept përmendet nga neni ____, i ligjit _____, i cili nuk jep përkufizim ligjor të tij. Për identifikimin e përmbajtjes së këtij koncepti janë marrë në analizë (*burimet e konsultuara*). Një prej këtyre burimeve i referohet zhvillimit të legjislationit në Shqipëri, pas hyrjes në fuqi të ligjit, që përmban konceptin në fjalë. Tre burime të tjera i referohen zhvillimeve doktrinare të huaja, nga të cilat dy janë të përshtatshme pasi zbërthejnë një koncept ligjor të ngjashëm me atë shqiptar.

Konkretisht, sipas burimit 1, ky koncept përfshin _____. Duhet theksuar se përmbajtja e këtij koncepti në çështjen konkrete është e zbatueshme pasi (*argumentet pse është e përshtatshme*).

Edhe burimet 2 dhe 3 konfirmojnë të njëjtën përmbajtje dhe për të njëjtën analizë janë të përshtatshme në çështjen konkrete.

Nga burimi 4 i konsultuar ka një ndryshim të konceptit në drejtim të _____. Ky ndryshim shpjegohet me _____.

Përfundimisht, arrihet në mendimin se koncepti _____ në nivel doktrinar ka këtë zhvillim _____, i cili duket i përshtatshëm për t'u zbatuar në çështjen konkrete.

MODEL I KËRKESËS PËR KUNDËRSHTIMIN E KOMPETENCËS LËNDORE

Tiranë, më ___ / ___ / ___

KËRKESË

- KËRKUES:** Zyra e Përmbartimit____, përfaqësuar në gjykim nga juristi A.B. i pajisur me autorizim nr.____ datë____ të lëshuar nga kryetari i zyrës.
- OBJEKTI:** Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e akteve në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente në lëndë për shqyrtimin e çështjes.
- BAZA LIGJORE:** Neni 7, shkronjat “d” dhe “dh” si dhe neni 13, pika 1 e LGJA.

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë**TIRANË**

I nderuar z. gjyqtar,

(Parashtrimi i fakteve). Përpara jush është paraqitur për shqyrtim padia e shtetasit X.Y. me objekt “Deklarimin e shuarjes së titullit ekzekutiv vendimit nr.____ datë____ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor____, pasi detyrimi nuk ekziston”. Kjo padi i është kundërdrejtuar Zyrës së Përmbartimit ____ si organi që zbaton vendimin dhe dhe Prokurorisë së rrethit gjyqësor ____ ndaj të cilës pretendohet paligjshmëria e dënimit të kërkuar.

Ndaj shtetasit X.Y., Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ____ ka filluar procedimin penal për veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi 2 dhe 25 të K.Penal. Në përfundim të hetimeve dhe procesit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor ____ me vendimin nr.____ datë ____ ka vendosur:

“...3. Deklarimin fajtor të të pandehurit X.Y. për kryerjen e veprës penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafet 2 – 25 K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e dënon atë me ____ burgim dhe x (x mijë) lekë gjobë. Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale masës së mësipërme i zbritet 1/3 e saj dhe përfundimisht i pandehuri X.Y. dënohet me ____ burgim dhe x-y (x-y mijë) lekë gjobë, duke përcaktuar edhe mënyrën e pagesës së dënimit me gjobë.

Pas marrjes së vendimit formë të prerë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ____ i ka njoftuar Zyrës së Përmbartimit ____ , urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal nr.____ datë ____ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ____ , për të dënuarin X.Y.

Me shkresën nr.____ datë ____ “Lajmërim për ekzekutim vullnetar”, Zyra e Përmbartimit i është drejtuar debitorit, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit që rrjedh nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ____ , duke bërë lajmërimin e debitorit për të bërë pagimin e shumës x-y lekë gjobë në favor të shtetit, si dhe taksës përmbartimore në masën 2% të detyrimit.

Paditësi pasi është vënë në dijeni të procedurës përmbartimore të ekzekutimit të dënimit të gjobës, ka kërkuar deklarimin e shuarjes së titullit ekzekutiv vendimit nr.____ datë ____ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ____ , pasi detyrimi nuk ekziston. Paditësi argumenton se, me Ligjin nr.144/2013 është bërë ndryshimi i Kodit Penal i cili ka shfuqizuar dënimin me gjobë, trajtuar nga Gjykata Kushtetuese se bie ndesh me parimet kushtetuese. Ligji material, Kodi Penal i RSH, parashikon se në rast se ka një ndryshim në ligjin penal i cili favorizon personin e dënuar, ky ka ndikim të menjëhershëm në ekzekutimin e dënimit, duke çuar në pezullimin e tij, edhe në rast se ekzekutimi i dënimit ka filluar. Referuar sa më lart, paditësi pretendon se titulli ekzekutiv, vendimi gjyqësor i formës së prerë është shuar si rrjedhojë e ndryshimeve të bëra në Kodin Penal dhe në kuptim të nenit 3 të Kodit Penal, duke qenë se masa e gjobës është një dënim penal, ai duhet të mos ekzekutohet, por të deklarohet shuarja e tij.

(Ligji i zbatueshëm). Neni 7 shkronjat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, parashikojnë kompetencën lëndore të gjykatave administrative lidhur me heqjen e lirisë dhe gjobën si dënime administrative, në këto situata shprehimisht të përcaktuara:

- d) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin;
- dh) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.

Gjithashtu, sipas nenit 13, pika 1 e po këtij ligji, moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit. Ky përcaktim nuk pengon palët ndërgjyqëse ta sjellin në vemendje të gjykatës çështjen e kompetencës lëndore.

(Arsyetimi i kërkesës në referim të fakteve dhe ligjit). Në analizë të rrethanave shteruese mbi mosmarrëveshjet administrative në kompetencë lëndore të gjykatave administrative, detyrimi financiar që lind nga gjoba ka të bëjë me këtë të fundit si lloj dënimi administrativ në kuadër të shqyrtimit të një kundërvajtje administrative, ndërsa në rastin konkret, çështja e diskutueshme para jush lidhet me gjobën si dënim penal të dhënë nga gjykata. Gjykata administrative nuk ka në kompetencë të shqyrtimit të saj ligjshmërinë e dënimit me gjobë, kur kjo e fundit është zbatuar në kuadër të legjislacionit penal. Dy situatat e fundit të nenit 7 (shkronjat “d” dhe “dh”), i referohen një dënimi administrativ, edhe kur ky i fundit është me heqje lirie. Po kështu, neni 8 i ligjit nr.10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, pikat 1 dhe 2 të tij përcaktojnë se:

1. Kur organi administrativ, kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative, konstaton shkeljen e dispozitave, të cilat parashikojnë kundërvajtjen administrative, pas shqyrtimit, vendos dënimin me gjobë apo dënime të tjera administrative, në varësi nga parashikimi i ligjit të posaçëm.
2. Në rastet kur organi kompetent për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative është **gjykata**, mund të vendoset dënimi: **a) me gjobë; b) me heqje lirie deri në 30 ditë.**

Gjykata administrative është kompetente për dënimet administrative me gjobë/heqje lirie dhe jo për dënimet penale me gjobë/heqje lirie, në pasojë të së cilës, kjo padi nuk përfshihet në kompetencën lëndore të kësaj gjykate.

Nga sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të shpallet mungesa e kompetencës lëndore për shqyrtimin e padisë dhe dërgimi i saj pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, si gjykata që ka dhënë vendimin e formës së prerë.

Me respekt,

KËRKUES

Emri, Mbiemri, nënshkrimi i përfaqësuesit të organit publik

MODEL I KËRKESËS PËR PËRJASHTIM GJYQTARI

Tiranë, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

KËRKUES: **Emri, Mbiemri**, përfaqësuar nga avokat (**Emri Mbiemri i përfaqësuesit**), i pajisur me prokurë të posaçme nr.rep__ dhe nr.Kol__ hartuar në datë dd/mm/vvvv, në cilësinë e paditësit në gjykimin administrativ me palë të paditur Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

OBJEKTI: Përrjashtimin nga gjykimi i mosmarrëveshjes me palën e paditur MTI, të gjyqtarit të caktuar të çështjes (Emri, Mbiemri)

BAZA LIGJORE: Neni 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile në lidhje me nenin 1, pika 2 të LGJA

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

TIRANË

I nderuar z. gjyqtar,

(*Parashtrimi i fakteve*). Unë kërkuesi kam paraqitur pranë kësaj gjykate padinë ndaj subjektit punëdhënës Ministria e _____, pranë të cilës ushtroj detyrën _____, në Sektorin _____ dhe kam statusin e nëpunësit civil. Nga pala e paditur është dhënë ndaj meje masa disiplinore e mbajtjes në 1/3 e pagës së plotë për tre muaj, me vendimin e nxjerrë nga Komisioni Disiplinor nr.____ datë _____, të cilin unë e kam ankimuar pranë kësaj gjykate.

Nga komunikimi i njoftimit për t’u paraqitur në seancë më është bërë me dije se çështja i është caktuar me short të njëjtit gjyqtar, i cili ka gjykuar më parë, masën disiplinore “Vërejtje” dhënë ndaj meje nga eprori direkt (Drejtori i Drejtorisë pranë së cilës ushtroj detyrën). Vendimi për masën e parë disiplinore është gjykuar ndaj të njëjtave palë (ndaj meje si paditës dhe Ministrisë përkatëse si punëdhënës), mbi të njëjtat raporte pune, (vazhdoj të ushtroj të njëjtën detyrë) dhe është vlerësuar nga gjykata se shkelja disiplinore që justifikon masën e dhënë, është konsumuar prej meje.

(*Ligji i zbatueshëm*). Neni 72, pika 6 e K.Pr.Civile, parashikon se gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete, në çdo rast kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie. Nëse rasti provohet dhe gjyqtari nuk jep dorëheqjen, neni 74 i këtij Kodi parashikon se secila nga palët mund të kërkojë përjashtimin e tij. Sipas paragrafit 3 të nenit 74 të K.Pr.Civile, paraqitja e mëvonshme e kërkesës lejohet vetëm kur pala ka marrë dijeni më vonë për shkakun e përjashtimit ose kur gjatë ushtrimit të funksioneve, gjyqtari ka shfaqur mendim të njëanshëm e në mënyrë të papërshtatshme mbi faktet dhe rrethanat objekt gjykimi, por sidoqoftë jo më vonë se tri ditë nga marrja dijeni.

(*Arsyetimi i kërkesës në referim të fakteve dhe ligjit*). Meqenëse ky vendim është mbështetur në vlerësimin e sjelljes time profesionale kundrejt të njëjtit punëdhënës, i cili ka proceduar me një masë më të rëndë disiplinore, kërkoj që gjyqtari i çështjes të përjashtohet nga gjykimi i padisë time të dytë, pasi bindja e krijuar prej tij ndaj personit tim në çështjen e mëparshme, kam dyshime që do të ndikojë në shqyrtimin me paanësi dhe objektivitet të masës së dytë disiplinore dhënë ndaj meje.

Në kushtet kur gjyqtari nuk ka vlerësuar të japë dorëheqjen, unë paraqes këtë kërkesë brenda afatit 3-ditor nga marrja dijeni për faktin me fletëthirrjen për njoftimin e seancës përgatitore.

Bashkëngjitur kërkesës, paraqes një kopje të vendimit nr.____ datë _____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku gjen mbështetje kërkesa ime.

Me respekt,

KËRKUES

Emri, Mbiemri, nënshkrimi

MODEL I KËRKESËS SË TË PADITURIT PËR KOMPETENCËN TOKËSORE

Tiranë, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

KËRKUES: **Agjencia A**, përfaqësuar në gjykim nga juristi X.Y. i pajisur me autorizim nr.____ datë____ të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm

OBJEKTI: Shpalljen e moskompetencës tokësore të gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë dhe dërgimin e akteve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si gjykata kompetente në territor

BAZA LIGJORE: Neni 11, pika 3 dhe neni 13, pika 2 e LGJA

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë**TIRANË**

I nderuar z. gjyqtar,

(*Parashtrimi i fakteve*). Pala paditëse shoqëria '2X' shpk i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi të natyrës administrative, duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ - leje legalizimi nr.____ datë ____2014, nxjerrë nga Agjencia A dhe ka paditur këtë organ publik. Në rastin konkret, subjekti paditës kundërshton lejen e legalizimit të sipërcituar nxjerrë nga Agjencia A, për objektin godinë banimi 6 kate + 1 kat nëntokë, në favor të subjektit '2X' me investitor shtetasin _____. Rezulton sipas lejes në fjalë se objekti ndërtimor ndodhet në lagjen _____, qyteti_____.

(*Ligji i zbatueshëm*). Sipas ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, neni 11, pika 3: "*Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm, që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin në të cilin ndodhet sendi ose pjesa më e madhe e tij*". Gjithashtu, sipas nenit 13, pika 2 të po këtij ligji, *moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët, vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave*.

(*Arsyetimi i kërkesës në referim të fakteve dhe ligjit*). Sipas dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7818, datë 16.11.2012 "Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative", i ndryshuar, neni 5, pika 2, kompetencën tokësore sipas territorit ku ndodhet pasuria e paluajtshme, interesat e të cilës preken nga akti që kundërshtohet e ka gjykata administrative e shkallës së parë Durrës, e cila përfshin në veprimtarinë e saj rrethin e Durrësit. Në kushtet kur kërkesa është paraqitur nga ana jonë përpara sesa çështja të kalojë në gjykim, i kërkojmë gjykatës së shkallës së parë administrative Tiranë shpalljen e moskompetencës tokësore lidhur me këtë mosmarrëveshje, si dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Durrës, si gjykata kompetente në territor për shqyrtimin e saj.

Me respekt,

KËRKUES

Emri, Mbiemri, nënshkrimi i përfaqësuesit të organit publik

MODEL I NJË KËRKESËPADIE

Tiranë, më ____ / ____ / ____

KËRKESË PADI

PADITËS: **Emri Mbiemri**, atësia, datëlindja, vendlindja, adresa e saktë e njoftimit sipas vendbanimit/vendqëndrimit, përfaqësuar në gjykim nga avokati sipas prokurës së posaçme/përgjithshme me referencat përkatëse

I PADITUR: **Organi publik sipas emërtesës**, adresa e saktë e tij sipas selisë së regjistruar. (*Shembull: Inspektorati Shtetëror i Arsimit, me adresë në Tiranë, Rruga e Durrësit, nr.219*)

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ - vendimit nr.____ datë ____ "Për dënimin me gjobë" të nxjerrë nga pala e paditur.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.49/2012 datë 3.5.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, neni 17/a i tij.

Ligji i posaçëm që zgjidh mosmarrëveshjen sipas të drejtës materiale (*Shembull ligji nr.69/2012 "Për sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë"*)

Kodi i Procedurave Administrative (dispozitat e zbatueshme sipas llojit të paligjshmërisë së pretenduar).

**GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË
TIRANË**

I nderuar z. gjyqtar,

Në pjesën shpjeguese të padisë trajtohen:

- Parashtrimi i rrethanave të çështjes sipas ecurisë në kohë të fakteve të ndodhura, ku shtjellohen në mënyrë të qartë dhe të hollësishme veprimet apo mosveprimet e organit publik palë e paditur të kundërshtuara gjyqësisht.
- Bëhet referim në provat që mbështesin faktet e pretenduara (dokumente, dëshmi, ekspertim, CD etj.)
- Citoohen dispozitat ligjore ku referohet paligjshmëria e veprimtarisë së organit publik.

Në pjesën përmblylëse të padisë parashtrohen:

- kërkimet, për të cilat kërkohet të shprehet gjykata (ne përputhje me objektin e padisë);
- mënyra dhe afatet e pretenduara për ekzekutimin e vendimit;
- shpenzimet gjyqësore; sasia dhe kujt subjekti i ngarkohen.

Me respekt,

PADITËS

Emër, Mbiemër, nënshkrimi

MODEL I DEKLARATËS SË PRANIMIT TË NJOFTIMIT TË SHPEJTË

Tiranë, më ____ / ____ / ____

DEKLARATË

E PRANIMIT TË NJOFTIMIT ME TELEFON OSE NË MËNYRË ELEKTRONIKE

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

TIRANË

E nderuar znj. gjyqtare,

Sot, më datë _____, unë paditësi **Emër, Mbiemër**, në procesin gjyqësor me padinë e paraqitur prej meje kundër subjektit të paditur (**emri i organit publik**), me objekt (llojin e objektit sipas përcaktimit në padi), në zbatim të kërkesave të nenit 21, pika 1/b të ligjit nr.49/2012 datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

DEKLAROJ

se pranoj të njoftohem me telefon ose në mënyrë elektronike, sipas te dhënave të mëposhtme:

Telefon: +355 - 422...

Celular: +35569...

E - mail: adresa elektronike e paditësit

Me respekt,

PADITËS

Emër, Mbiemër, nënshkrimi

MODEL I PROCESVERBALITË NJOFTIMIT ME TELEFON

PROCESVERBAL

“Mbi njoftimin me telefon”

Në Tiranë, sot më datë _____, ora _____, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, unë sekretarja gjyqësore, _____, bazuar në parashikimet e nenit 22 të ligjit nr.49/2012, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, mbaj këtë procesverbal për njoftimin nëpërmjet telefonit të gjykatës.

U njoftua personi _____, me cilësinë e paditësit, në numrin e telefonit _____ për t’u paraqitur pranë kësaj gjykate, më datë _____, ora _____, si pjesëmarrës në gjykim.

Nëpunësi gjyqësor

Sekretare gjyqësore

MODEL I KËRKESËS PËR CAKTIM EKSPERTI

Tiranë, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

PËR THIRRJE TË EKSPERTIT DHE CAKTIMIN E DETYRAVE

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

TIRANË

E nderuar znj. gjyqtare,

Sot, më datë _____, unë paditësi **Emër, Mbiemër**, në procesin gjyqësor me padinë e paraqitur prej meje kundër subjektit të paditur (**emri i organit publik**), me objekt (llojin e objektit sipas përcaktimit në padi), në zbatim të nenit 21, pika 4 të ligjit nr.49/2012 datë 3.5.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

KËRKOJ

1. Të caktohet një ekspert në fushën e kontabilitetit, duke sugjeruar thirrjen nga lista e ekspertëve të gjykatës ekspertin kontabël të autorizuar **Emri, Mbiemri**, me adresë të ushtrimit të veprimtarisë në Tiranë, Rruga "X", Kutia postare nr.
2. Eksperti të thirret me qëllim zgjidhjen e detyrave që janë të nevojshme për thelbin e mosmarrëveshjes, që parashtrohen prej palës paditëse, si më poshtë:
 - i.
 - ii.
 - iii.

Me respekt,

PADITËS

Emër, Mbiemër, nënshkrimi

MODEL I KËRKESËS PËR THIRRJEN E DËSHMITARËVE

Durrës, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

PËR THIRRJE TË DËSHMITARËVE NË GJYKIM

Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

DURRËS

I nderuar z. gjyqtar,

Sot, më datë _____, unë paditësi **Emër, Mbiemër**, në procesin gjyqësor me padinë e paraqitur prej meje kundër subjektit të paditur (**emri i organit publik**), me objekt (llojin e objektit sipas përcaktimit në padi), në zbatim nenit 21, pika 4 të ligjit nr.49/2012 datë 3.5.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

KËRKOJ

Thirrjen në gjykim me cilësinë e dëshmitarit të shtetasve të mëposhtëm:

1. Dëshmitari nr. 1, **Emër, Mbiemër**, me adresë njoftimi në Tiranë, Njësia Administrative nr., Rruga "X", Pallati nr., Hyrja ____, Ap.
2. Dëshmitari nr. 2, **Emër, Mbiemër**, me adresë njoftimi në Tiranë, Bulevardi "A.B.", në vendin e ushtrimit të detyrës - **emri i subjektit punëdhënës**.
3. Dëshmitari nr. 3

Me respekt,

PADITËS

Emër, Mbiemër, nënshkrimi

MODEL I AKTIT TË NJOFTIMIT TË PADISË DHE TË AKTEVE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË ...**

Nr. akti _____

Datë: **dd/mm/vvvv**

PËR NJOFTIMIN E PADISË DHE AKTEVE

Njoftohet: **Emri i organit publik të paditur**
Adresa: **Tiranë, rruga "Z", ndërtesa nr. ____.**

Para kësaj gjykate, jeni thirrur si **palë e paditur** në çështjen me paditës "**X.Y.**" **sh.p.k.**, me objekt kryesor "**shfuqizim të aktit administrativ vendim nr. _ datë __ të dënimit me gjobë**".

Bashkëngjitur, ju komunikojmë **padinë së bashku me kopjen e të gjitha akteve shoqëruese të paraqitura**, duke caktuar **8 (tetë)** ditë kohë nga marrja e këtij njoftimi, për depozitimin në sekretari të **prapësimeve me shkrim**, të listës së personave me cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit dhe adresat e tyre, **si dhe të akteve të plota shkresore**, ku janë bazuar kryerja e veprimit administrativ dhe shqyrtimi i ankimit administrativ.

GJYQTAR
Emri, Mbiemri

Aktet u morën në dorëzim, më datë **dd/mm/vvvv**

DËSHMITARËT

MARRËSI

NËPUNËSI GJYQËSOR

MODEL I DISPOZITIVIT TË VENDIMIT PËR PLOTËSIMIN E TË METAVE TË PADISË

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në veprime përgatitore, duke u bazuar në nenet 25, pika 1/a të ligjit 49/2012, datë 3.5.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, si dhe bazuar në nenet 154 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I

1. Caktimin e afatit 5 (pesë) ditor ndaj palës paditëse, shoqërisë "Z" sh.p.k. për plotësimin e të metave të padisë nga data e marrjes dijeni për këtë vendim.
2. Në rast të mosplotësimit në kohë të tyre, padia do të kthehet së bashku me aktet shoqëruese.
3. Në kushtet e mungesës së palës paditëse, e cila mbart këtë detyrim, seanca do të caktohet menjëherë me konfirmimin e marrjes dijeni për vendimin e ndërmjetëm të kësaj pale.

U shpall në _____, sot më datë **dd/mm/vvvv.**

MODEL I DISPOZITIVIT TË VENDIMIT PËR KTHIMIN E PADISË DHE TË AKTEVE**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, referuar neneve 21 dhe 25, pika 1/a të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, si dhe neneve 154 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI

1. Kthimin e padisë dhe të akteve të saj shoqëruese palës paditëse shtetasit Y.Z.
2. Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë bërë¹¹¹.

Kundër vendimit lejohet ankim i *veçantë* në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

U shpall në _____, sot më datë dd/mm/vvvv.

¹¹¹ Në situatën kur nuk është paguar tarifa për gjykim dhe as vlera për shpenzimet e njoftimeve të palëve.

MODEL I DISPOZITIVIT TË VENDIMIT PËR KRYERJEN E EKSPERTIMIT**KONSTATOVA**

Se për zgjidhjen e çështjes, nisur nga natyra e mosmarrëveshjes së prezantuar ndërmjet palëve ka nevojë për njohuri të posaçme në fushën e kontabilitetit me qëllim kryerjen e llogaritjeve të nevojshme lidhur me përcaktimin e diferencës së papaguar të detyrimit kontraktor, si dhe masës së kamatave.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të neneve 14 dhe 25, pika 1, shkronja "c" të ligjit 49/2012 datë 3.5.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe të nenit 227 të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSA:

- I. Kryerjen e aktit të ekspertimit për këtë çështje administrative në fushën e kontabilitetit.
- II. Caktimin nga lista e gjykatës të ekspertës kontabël të regjistruar A.B., e cila është anëtare e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (I.E.K.A.)
- III. Caktimin e detyrave ndaj ekspertës si më poshtë:
 1. Bazuar në kontratën nr.____datë____ dhe shtesë kontratën datë ____ të përcaktohet nëse ka detyrime të papërbushura kontraktore nga pala e paditur, nëse ka të nxirren diferencat përkatëse.
 2. Të llogariten diferencat matematikore të efekteve të ndryshimit të pagës nga ligji nr.75/2014 'Për shërbimin privat të sigurisë fizike', nga data e hyrjes në fuqi të ligjit e deri në datën e mbarimit të afatit kontraktor.
 3. Për diferencën e vërejtur sipas detyrës nr.2, të llogariten kamatëvonesat sipas varianteve të mëposhtme:
 - a. Sipas nenit 7 të kontratës së lidhur midis palëve.
 - b. Sipas interesave të Bankës së Shqipërisë 'depozitë me afat një vjeçar' nga data e hyrjes në fuqi të ligjit 75/2014 e deri në datën e hartimit të aktit të ekspertimit.
- IV. Akti i ekspertimit do të kryhet për 15 ditë, brenda datës _____, duke i vënë ekspertës në dispozicion të gjitha aktet e dosjes gjyqësore. Shpenzimet për kryerjen e aktit të ekspertimit parapagohen nga pala paditëse.
- V. Ekspertes i komunikohet menjëherë një kopje e këtij vendimi, si dhe detyrimi që të plotësojë dhe të nënshkruajë një deklaratë personale për dijeninë e saj për përgjegjësinë penale në rast ekspertimi të rremë, duke e ftuar atë të bëjë betimin se do të kryejë mirë e me nder detyrat që i janë besuar, me të vetmin qëllim që t'ia bëjë të ditur gjykatës të vërtetën.
- VI. Një kopje e këtij vendimi u komunikohet palëve ndërgjyqëse të cilët kanë të drejtë të tërheqin një kopje të aktit të ekspertimit tri ditë përpara seancës së natyrës përgatitore e caktuar më datë _____.

Tiranë, më datë dd/mm/vvvv

MODELI I DEKLARATËS SË BETIMIT TË EKSPERTIT¹¹²

DEKLARATË

Unë i/e nënshkruari(a) _____ (emër, atësi, mbiemër), i/e pajisur me licensën nr. _____, datë _____, me profesion _____, i/e caktuar ekspert nga gjykata administrative e shkallës së parë (selia e gjykatës), me vendim nr. _____, datë _____, në mbështetje të nenit 226 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë deklaroj, me dijeninë time mbi përgjegjësinë ligjore se do të kryejë mirë e me nder detyrën që më është besuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me të vetmin qëllim që t'ia bëjë të ditur gjykatës të vërtetën.

(Vendi, Data) (Emër, Mbiemër).....
(nënshkrimi).....

112 Kjo deklaratë është në formë standarde e miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.685, datë 20.11.2013 "Për formën dhe përmbajtjen e deklaratës së ekspertit në procesin gjyqësor".

MODEL I KËRKESËS SË PADITËSIT PËR SHTIMIN E OBJEKTIT TË PADISË

Korçë, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

KËRKUES: **Emri, Mbiemri**, përfaqësuar nga avokat (**Emri Mbiemri i përfaqësuesit**), i pajisur me prokurë të posaçme nr.rep__ dhe nr.Kol__ hartuar në datë dd/mm/vvvv, në cilësinë e paditësit në gjykimin administrativ me palë të paditura autoritetet doganore.

OBJEKTI: Shtimin e objektit fillestar të padisë

BAZA LIGJORE: Neni 185, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë KORÇË

I nderuar z. gjyqtar,

Përpara jush është marrë në shqyrtim mosmarrëveshja administrative me padinë e paraqitur prej meje, e cila i kundër-drejtohet palëve të paditura Dega e Doganës (Kapshticë) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me objekt fillestar të saj si më poshtë:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. ____ datë ____ të nxjerrë nga Dega e Doganës Kapshticë;
2. Shfuqizimin e vendimit nr. prot. ____, datë ____ të Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave.

Vendimi bazë i cili ka përcaktuar detyrimin doganor nga rivlerësimi i deklaratës doganore mbi sasinë e mallit të importuar, ka vendosur edhe penalitetet me gjobë ndaj meje në masën e trefishit të detyrimit, lënë në fuqi nga DPD.

Për shkak të dëmit të ardhur nga ngarkimi me detyrime doganore që nuk qëndrojnë dhe parapagimit të një pjese të detyrimit për efekte të ankimit pranë DPD-së, kërkoj të shtohet objekti i padisë, me kërkimet e mëposhtme:

1. Kthimin e shumës së paguar si detyrim në shumën _____ lekë dhe gjobë në masën 40% të vlerës së detyrimit.
2. shpërblimin e dëmit nga bllokimi i shumës së parapaguar për efekte të shqyrtimit të ankimit në rrugë administrative.

Kërkimet e mësipërme iu shtohen dy kërkimeve në objektin e padisë së depozituar në gjykatë dhe nuk prekin shkakun ligjor të padisë, i cili lidhet me të drejtën materiale të paditësit për mospagimin e detyrimeve tëaktuara nga akti i paligjshëm i organit publik.

Me respekt,

KËRKUES

Emër, Mbiemër, nënshkrimi

MODEL I KËRKESËS SË PADITËSIT PËR SHTIMIN E NDËRGJYQËSISË

Tiranë, më ___ / ___ / ___

KËRKESË

- KËRKUES:** **Emri, Mbiemri**, përfaqësuar nga avokat (**Emri Mbiemri i përfaqësuesit**), i pajisur me prokurë të posaçme nr.rep__ dhe nr.Kol__ hartuar në datë dd/mm/vvvv, në cilësinë e paditësit në gjykimin administrativ me palë të paditur Ministrinë e _____¹¹³
- OBJEKTI:** Thirrjen në gjykim si të paditur të Departamentit të _____
- BAZA LIGJORE:** Neni 161, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë**TIRANË**

I nderuar z. gjyqtar,

Përpara jush është marrë në shqyrtim mosmarrëveshja administrative që ka lindur nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, me palë paditëse shtetasin (**Emri, Mbiemri**) dhe të paditur organin e administratës publike **Ministria e _____**.

Nëpërmjet kërkimeve në padi, kërkohet të konstatohet nga gjykata paligjshmëria e veprimit të palës së paditur si subjekt punëdhënës i aktit të lirit nga shërbimi civil dhe zgjidhja e pasojave të kësaj paligjshmërie nëpërmjet kthimit në detyrë të paditësit apo sistemimit të tij në një tjetër pozicion të së njëjtës kategori me atë të mbajtur.

Meqënëse ligji nr. 152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ i ndryshuar, parashikon në nenin 4, shkronja “f” të tij se Departamenti i _____ është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, pra, edhe për Ministrinë pranë të cilës kam ushtruar detyrën, kërkohet në bazë të nenit 161/c të K.Pr.Civile të thërras në gjykim në cilësinë e të paditurit edhe Departamentit të _____, për shkak të konfirmimit prej saj të aktit të liritim tim nga shërbimi civil, në kundërshtim me ligjin.

Bashkëngjitur kërkesës në disa kopje, ndodhen edhe kopje të padisë dhe akteve shoqëruese për t’ia komunikuar personit të tretë.

Me respekt,

KËRKUES

Emër, Mbiemër, nënshkrimi

MODEL I KËRKESËS SË PADITËSIT PËR SHTYRJEN E SEANCËS GJYQËSORE

Tiranë, më ___ / ___ / ___

KËRKESË

- KËRKUES:** **Subjekti Tregtar “X” sh.p.k.**, përfaqësuar nga administratori (**Emri, Mbiemri**) në cilësinë e paditësit në gjykimin administrativ me palë të paditur Y me objekt përmbushje detyrimi kontraktor.
- OBJEKTI:** Shtyrjen e seancës gjyqësore për pamundësi të pjesëmarrjes në gjykim.
- BAZA LIGJORE:** Neni 179 i K.Pr.Civile në lidhje me nenin 1, pika 2 të LGJA

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë**TIRANË**

I nderuar z. gjyqtar,

Në cilësinë e paditësit në këtë mosmarrëveshje të natyrës administrative me palë të paditur (**emri i organit publik**) dhe objekt ‘detyrimin e saj të përmbushë detyrimin kontraktor nga kontrata e prokurimit publik nr.____ datë dd/mm/vvvv, për ruajtjen e objektit me roje civile’, kërkohet të shtyhet seanca e datës _____, ora _____, sipas njoftimit me fletëthirrjen e gjykatës, për pamundësinë e pjesëmarrjes time në gjykim në këtë datë.

Kërkesën e mbështes në faktin se përfaqësimin e interesave të mia në këtë gjykim do ta realizoj vetë dhe për arsye të natyrës shëndetësore, jam i pamundur të paraqitem sot në gjykatë.

Bashkëngjitur kërkesës paraqes raportin e paaftësisë së përkohshme në punë me nr. regj.____ lëshuar në datë____ nga mjeku i familjes.

Me respekt,

KËRKUESEmri, Mbiemri i përfaqësuesit të subjektit
Firma dhe vula e shoqërisë

MODEL I KËRKESËS SË TË PADITURIT PËR MOSPRANIMIN E PADISË

Tiranë, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

- KËRKUES:** X, Njësia Vendore pranë Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar në gjykim nga juristja A.B. e pajisur me autorizim nr.____ datë____ të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm
- OBJEKTI:** Kërkesë për mospranimin e padisë së paraqitur nga paditësi shtetasi Y.Z. ndaj palës së paditur, për shkak se padia është depozituar në gjykatë jashtë afatit ligjor
- BAZA LIGJORE:** Neni 18, pika 1, shkronja “b” ne lidhje me nenin 39, pika 2 të LGJA

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë**TIRANË**

I nderuar z. gjyqtar,

(*Parashtrimi i fakteve*). Paditësi shtetasi Y.Z. i është drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë me padi me të cilën ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.____ datë ____ të nxjerrë nga pala e paditur X njësia vendore pranë Bashkisë Tiranë, dhe ka paditur këtë të fundit. Nga të dhënat e çështjes dhe aktet provuese, rezulton se paditësi është pronar mbi një njësi ndërtimore me sip.____m², ndodhur në Rruga e _____, pasuri me nr.____, regjistruar në vol.____, faqe __, ne zonën kadastrale nr.____, fakt që provohet nga çertifikata e vërtetimit të pronësisë lëshuar në datë ____ nga ZVRPP Tiranë. Në këtë objekt, paditësi ka kryer punime me alikobond për veshjen e fasadës njësi tregtare (dyqan) pa pasur për këtë leje, konstatuar nga inspektorët e palës së paditur, me procesverbalin nr.____ serie, datë _____. Me vendim nr.____ datë ____, pala e paditur ka vendosur të gjobisë subjektin paditës në shumën x mijë lekë, për shkeljen e pasqyruara më sipër dhe akti administrativ i është njoftuar paditësit më datë _____, i cili ka ushtruar më parë ankim administrativ dhe gjykatës i është drejtuar në datë _____.

(*Ligji i zbatueshëm*). Me ndryshimet ligjore të bëra me ligjin nr.183/2014, neni 17 i ligjit ndryshues i cili ka ndryshuar nenin 14 të ligjit nr.9780 datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, ka këtë formulim: “Kundër vendimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit”. Sipas nenit 18, pika 1 të LGJA, padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda afatit ligjor. Sipas shkronjës “b” të kësaj dispozite, ky afat fillon sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë.

(*Arsyetimi i kërkesës në referim të fakteve dhe ligjit*). Në kohën e marrjes dijeni të subjektit paditës për aktin administrativ ndaj të cilit i njihet e drejta e ankimit, në datë____, kishin hyrë në fuqi ndryshimet ligjore me ligjin nr.183/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, sipas të cilit, ankimi ndaj vendimit të njësisë vendore të X bëhet drejtpërdrejt në gjykatë në kuptim të nenit 16, pika 2, shkronja “b” të LGJA.

Pala paditëse e ka depozituar padinë në gjykatë në datë _____, kur ka pasur detyrimin ta paraqiste brenda 10 diteve nga data e njoftimit _____, pra jashtë afatit ligjor për paraqitjen e saj në gjykatë.

Në kushtet kur subjekti paditës nuk ka respektuar afatin e paraqitjes së padisë, kërkojmë nga gjykata të vendosë mospranimin e padisë.

Me respekt,

KËRKUES

Emri, Mbiemri, nënshkrimi i përfaqësuesit të organit publik

MODEL I KËRKESËS SË PALËS PADITËSE PËR PEZULLIMIN E GJYKIMIT

Tiranë, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

- KËRKUES:** Prefekti i Qarkut Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga juristi A.B. i pajisur me autorizim nr.____ datë____ të lëshuar nga Prefekti
- OBJEKTI:** Kërkesë për pezullimin e gjykimit
- BAZA LIGJORE:** Neni 297, shkronja "c" në lidhje me nenin 1, pika 2 të LGJA

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë**TIRANË**

I nderuar z. gjyqtar,

(*Parashtrimi i fakteve*). Pala paditëse Prefekti i Qarkut Tiranë i është drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë duke paditur anëtarët e familjes bujqësore me kryefamiljar shtetasin X.Y., gjithsej tre të paditur C.Y., D.Y. dhe E.Y. Objekti i padisë rezulton shfuqizim i pjesshëm të Aktit të Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi datë _____, me sipërfaqe 5.000 m², në emër të familjes bujqësore të përfaqësuar nga X.Y., si dhe kthimin në pronësi shtet të sipërfaqes për të cilën shfuqzohet akti.

Pas paraqitjes së padisë, një nga shtetasit e paditur D.Y. ka ndërruar jetë, fakt i cili provohet me certifikatën e vdekjes nr.serie __ datë __ të lëshuar nga ZGJC pranë Njesisë Administrative nr.____ Tiranë.

(*Ligji i zbatueshëm*). Sipas nenit 297/c të K.Pr.Civile gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur një nga palët vdes dhe sipas nenit 298 të këtij Kodi, pezullimi i gjyqimit vazhdon gjersa të paraqitet për të marrë pjesë në çështje personi që hyn në të drejtat e të ndjerit. Sipas nenit 199 të K.Pr.Civile, kur njëra nga palët vdes, çështja vazhdon nga ose kundër trashëgimtarëve të saj.

(*Arsyetimi i kërkesës në referim të fakteve dhe ligjit*). Në kushtet ku shtetasi i paditur D.Y. ka ndërruar jetë gjatë gjyqimit të çështjes, me qëllim përcaktimin e trashëgimtarëve të tij ligjorë dhe kalimin procedural ndaj tyre të cilësisë së të paditurit, kërkojmë pezullimin e gjyqimit të kësaj mosmarrëveshjeje administrative.

Me respekt,

KËRKUES

Emri, Mbiemri, nënshkrimi i përfaqësuesit të organit publik

MODEL I KËRKESËS SË PADITËSIT PËR HEQJE DORË NGA GJYKIMI I PADISË

Shkodër, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

- KËRKUES:** Shoqëria tregtare "X" sh.p.k., me adresë të saj____, regjistruar pranë regjistrat tregtar me NIPT____, përfaqësuar nga administratori (**Emri Mbiemri**) në cilësinë e paditësit në gjykimin administrativ me palë të paditur Agjencinë A me objekt përmbushje detyrimi kontraktor.
- OBJEKTI:** Heqjen dorë nga gjyqimi i padisë
- BAZA LIGJORE:** Neni 201/1 i K.Pr.Civile në lidhje me nenin 39, pika 3 të LGJA

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë**SHKODËR**I nderuar z. kryetar i trupit gjykues,
Të nderuar gjyqtarë,

Nga ana e shoqërisë që unë përfaqësoj është depozituar dhe po shqyrtohet pranë kësaj gjykate, padia me palë të paditur Agjencia A dhe me objekt të saj detyrimin e palës së paditur të përmbushje detyrimin kontraktor nga kontrata e furnizimit me mjete kancelarie dhe tonera, lidhur midis nesh në datë _____, në finalizim të kontratës së prokurimit publik.

Për shkak se mosmarrëveshja është zgjidhur jashtëgjyqësisht me palën e paditur, i deklaroj gjykatës se heq dorë nga gjyqimi i padisë sipas nenit 201 të K.Pr.Civile dhe kërkoj pushimin e gjyqimit të saj në bazë të nenit 39, pika 3 të LGJA.

Me respekt,

KËRKUESEmri, Mbiemri i përfaqësuesit të subjektit
nënshkrimi dhe vula e shoqërisë

MODEL I KËRKESËS SË PADITËSIT PËR SIGURIMIN E PADISË

Tiranë, më ____ / ____ / ____

KËRKESË

KËRKUES: Shoqëria tregtare "X" sh.p.k., me adresë të saj_____, regjistruar pranë regjistrimit tregtar me NIPT_____, përfaqësuar nga administratori (**Emri Mbiemri**)

OBJEKTI: Sigurimin e padisë nëpërmjet pezullimit të zbatimit të aktit administrativ vendim nr.____ datë ____ për prishje të objektit, nxjerrë nga IKMT

BAZA LIGJORE: Nenet 28 - 30 të LGJA

Përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

TIRANË

I nderuar z. gjyqtar,

(*Parashtrimi i fakteve*). Shoqëria kërkuese ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit dhe në kuadër të veprimtarisë së saj është pajisur me leje ndërtimi për godinë katërkatëshe në pronën e vet me vendim nr.____ datë ____ të Këshillit të Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë _____.

Më datë ____nga tre inspektorë pranë IKMT është mbajtur procesverbal i konstatimit me nr.serie ____ në objektin e ngritur nga shoqëria në të cilin është përshkruar se në objekt konstatohen shtesë në sipërfaqe dhe krijim volumi jashtë lejes së ndërtimit.

Në vijim me vendim për prishjen e objektit nr.____ datë _____, IKMT ka vendosur: "*Dënimin për prishjen e objektit shtesë sipërfaqe dhe krijim volumi jashtë lejes së ndërtimit*".

(*Ligji i zbatueshëm*). Sipas nenit 30 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", pika 1/a, pezullimi i zbatimit të aktit administrativ është një ndër masat e sigurimit të padisë, i lejuar nga neni 28 i këtij ligji. Kushtet ligjore kryesore për sigurimin e padisë sipas nenit 29 të LGJA janë:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin;
- nuk cenohet rëndë interesi publik.

(*Arsyetimi i kërkesës në referim të fakteve dhe ligjit*). Në paraqitjen e pretendimit tonë për pezullim të zbatimit të aktit administrativ, justifikohemi të paraqesim kërkesën përpara depozitimit të padisë, sipas përcaktimit të nenit 28, pika 2, të ligjit 49/2012, i cili thotë: "*Kërkesa për sigurimin e padisë, për shkak të rrethanave të çështjes, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia*".

Në rastin konkret, akti administrativ objekt i kërkesës, i cili jep dënimin me prishje objekti plotëson kushtet e nenit 29 të LGJA, pasi:

- do të dëmtonte rëndë kërkuesin nisur nga lloji i objektit që preket nga vendimi, i cili është për qëllime banimi dhe do ta dëmtonte atë në mënyrë të pakthyeshme, pasi akti disponon për prishjen e pjesës së objektit të konsideruar jashtë përcaktimeve të lejes së ndërtimit, duke cenuar funksionalitetin e ndërtesës;
- dëmi konsiderohet i atëçastshëm, pasi është i zbatueshëm në çdo kohë, dhe nuk ka asnjë akt provues të sjellë në gjykim për mungesën e interesit të zbatimit të tij nga organi administrativ;
- duke qenë se objekti është ngritur për qëllime banimi dhe pretendohet paligjshmëria e pjeshme e ndërtimit, nuk provohet që të cenohet rëndë interesi publik nga pezullimi i zbatimit të aktit.

Në të tilla rrethana kërkohet nga gjykata që të pranojë kërkesën për marrjen e masë së sigurimit të padisë, nëpërmjet pezullimit të zbatimit të aktit administrativ vendim nr.____ datë ____ për prishje të objektit, nxjerrë nga IKMT.

Me respekt,

KËRKUES

Emri, Mbiemri i përfaqësuesit të subjektit
nënshkrimi dhe vula e shoqërisë

MODEL I NJË KËRKESË ANKIMORE

Tiranë, më ___ / ___ / ___

KËRKESË ANKIMORE

- ANKUES:** Paditësi Emri, Mbiemri, atësia, datëlindja, vendlindja, adresa e saktë e njoftimit sipas vendbanimit/vendqëndrimit, përfaqësuar në gjykim nga avokati ___ sipas prokurës së posaçme/përgjithshme me referencat përkatëse.
- KUNDËR:** Vendimit gjyqësor nr. ___, datë___ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
- OBJEKTI:** Ndryshimi i vendimit gjyqësor për masën e shpërblimit të dëmit nga x mijë lekë në y mijë lekë, bazuar në nenet 44 e vijues të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar
- PALËT E TJERA:** I paditur organi publik _____, adresa e saktë e tij sipas selisë së regjistruar. (Shembull: Inspektorati Shtetëror i Arsimit, me adresë në Tiranë, Rruga e Durrësit, nr.219)

**GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT
TIRANË**

I nderuar z. kryetar,
Të nderuar z. gjyqtarë,

Hyrje

Një hyrje e shkurtër me të cilën tregohet në mënyrë të përmbledhur se çfarë është vendosur me vendimin gjyqësor që ankimohet.

Në pjesën shpjeguese të ankimit jepet parashtrimi i qartë i kërkesave kundër vendimit gjyqësor, duke bërë një ndarje të tyre në (1) kërkesa për procedurën e zbatuar në gjykimin në shkallë të parë dhe arsytet pse shkelja e pretenduar ka ndikuar në dhënien e vendimit dhe (2) kërkesa për themelin e vendimit, të cilat nënkategorizohen në kërkesa për zbatimin e ligjit material dhe në kërkesa mbi saktësinë e fakteve të pranuar nga gjykimi në shkallë të parë. Në parashtrimin e kërkesave sugjerohet që ato të listohen të numërtuara, duke ndjekur rendin kronologjik. Në parashtrimin e pretendimeve, nëse ato lidhen me çështje fakti, tregohen edhe provat mbështetëse të tyre, duke analizuar fuqinë provuese të tyre. Nëse pretendimet lidhen me çështje ligjore, sugjerohet që ato të shoqërohen edhe me pjesë përkatëse të jurisprudencës së gjykatave më të larta.

Nëse është rasti, tregohen provat e reja që duhet të merren nga Gjykata e Apelit dhe shkaqet e sakta, për të cilat këto prova nuk janë kërkuar apo nuk janë marrë në gjykimin në shkallë të parë (dokumente, dëshmi, ekspertim, CD etj.)

Në pjesën përmblylëse të ankimit parashtrohen saktë kërkimet, për të cilat kërkohet të shprehet Gjykata e Apelit (në përputhje me objektin e ankimit).

Me respekt,

ANKUES

Paditësi Emër, Mbiemër, nënshkrimi

MODEL I DISPOZITIVIT TË VENDIMIT PËR NDRQJEN E TË METAVE TË ANKIMIT

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në dhomë këshillimi, duke u bazuar në nenin 46, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

VENDOSI

1. Caktimin e afatit 3 (tre) ditor ndaj palës paditëse, shoqërisë “X” sh.p.k., për ndreqjen e të metave të ankimit datë _____, të paraqitur prej saj ndaj vendimit gjyqësor nr. __, datë __ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si më poshtë:
 - a) të paraqitet akti i përfaqësimit të avokatit të zgjedhur, pas përfundimit të gjykimin në shkallë të parë;
 - b) të paraqiten edhe 3 (tri) kopje ankimi, për t’ia njoftuar atë të gjithë personave në gjykim.
2. Nëse të metat e ankimit nuk ndreqen brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e njoftimit të këtij vendimi, ankimi do të kthehet së bashku me aktet shoqëruese.
3. Urdhërohet njoftimi i këtij vendimi brenda ditës palës paditëse.
4. Seanca e radhës për shqyrtimin e këtij ankimi në dhomë këshillimi shtyhet për në datën _____, ora _____.

U shpall në _____, sot më datë dd/mm/vvvv.

MODEL I DISPOZITIVIT TË VENDIMIT PËR KTHIMIN E ANKIMIT

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 46, pika 3 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

VENDOSI

1. Kthimin e ankimit datë ____ ndaj vendimit gjyqësor nr. __, datë __ dhe të akteve të tij shoqëruese paditësit A.B., për shkak të të metave që nuk u ndreqën prej tij.
2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohet paditësit ankues A.B.

Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në gjykatën administrative të apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

U shpall në _____, sot më datë dd/mm/vvvv.

MANUAL I AKTEVE PROCEDURALE PËR GJYKIMET ADMINISTRATIVE

Me 57 Shtete pjesëmarrëse në Amerikën e Veriut, Evropë dhe Azi, OSBE-ja është organizata më e madhe rajonale e sigurisë në botë. OSBE-ja punon për stabilitet, paqe dhe demokraci, për më shumë se një miliard njerëz, përmes dialogut politik rreth vlerave të përbashkëta dhe përmes punës praktike, që sjell një ndryshim jetëgjatë.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri
Sheraton Tirana Hotel, Kati I
Sheshi "Italia"
1010 Tiranë, Shqipëri
www.osce.org/albania